



CRPA

QENDRA PËR HULUMTIME TË ADMINISTRAËS PUBLIKE
ИСТРАЖУВАЧКИ ЦЕНТАР ЗА ЈАВНА АДМИНИСТРАЦИЈА
CENTER FOR RESEARCH OF PUBLIC ADMINISTRATION

**“PERSPEKTIVAT EURO-ATLANTIKE TË RM-SË: PROBLEMET,
SFIDAT DHE REALITETI POLITIK PAS DËSHTIMIT NË SAMITIN E
NATO-S NË BUKURESHTIT 2008”**

(HULUMTIM MBI POLITIKËN AKTUALE DHE OPINIONIN E
QYTETARËVE)

-Referate të prezentuara në Konferencën shkencore të mbajtur në
UEJL më datë 2 Maj 2009-

Projekt i finansuar nga UEJL dhe i mbështetur nga Komiteti Akademik
për hulumtime

Tetovë, Qershor 2009

<i>Data e botimit:</i>	Qershor 2009
<i>Botues:</i>	Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, R. e Maqedonisë
<i>Përkthimi:</i>	Afrim Jashari
<i>Radhitja dhe Ballina:</i>	Kushtrim Arifi
<i>Shtypi:</i>	Arberia Design-Tetovë
<i>Tirazhi:</i>	500 kopje

CIP - Каталогизација во публикација
 Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", - Скопје
 341.171.072.5114-672ЕУ: 497.71(0821)
 327.51.071.51(10-622НАТО: 497.71(082)
 PERSPEKTIVAT euro-atlantike të RM-së: problemet; sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në samitin e
 Bukureshtit 2008/Renata Treneska-Deskoska ... (и др.); përkthyes Afrim Jashari. Tetovë : Universiteti i
 EЈL, 2009 - 310 стр. : илустр. ; 24 cm
 Превод на делото: Еуро-атланските перспективи на РМ: проблемите, предизвиците новитичката
 реалност на самитот во Букурешт 2008. - Автори: Renata Treneska-Deskoska, Brikend Aziri, Jeton
 Mazllami, Ali Musliu, Fejzulla Shabani, Vasko Naumovski, Makedonka Vilarova, Albulena Halili, Fatmir
 Arifi, Mimoza Qamili, Arta Azizi-Ziberi, Bekim Nuhija, Vullnet Zenki, Lulzim Farizi, Abdulla Azizi.
 ISBN 978-608-5-4503-22-4
 1) Treneska-Deskoska, Renata (avtor)
 а) Македонија - Зачленување - Европска Унија - Зборници
 б) Македонија - Зачленување - НАТО - Зборници
 COBISS.MK-ID 78249738

***Ndalohe*т копјими, shumëзіми ose shfrytëзіми në çdo formë mekanike, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të cilës do pjesë të këtij libri.**

Të nderuar lexues,

Në suaza të Qendrës për Hulumtime pranë Fakultetit të Administrimit Publik dhe shkencave politike në UEJL, është realizuar projektit *“Perspektivat euro-atlantike të RM-së: problemet, sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në samitin e NATO-s në Bukureshtit 2008”* (Hulumtim mbi politikën aktuale dhe opinionin e qytetarëve).

Pas hulumtimeve të bëra në teren mbi opinionin e qytetarëve (Janar-Prill 2009), u organizua Konferenca shkencore (2 Maj 2009, UEJL) ku pjesëmarrësit në punimet e tyre shkencore kanë trajtuar tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me perspektivat euro-atlantike të vendit. Në këtë Konferencë janë këmbyer mendime të shumta rreth çështjes për të cilën është bërë hulumtimi, janë komentuar rezultatet dhe është zhvilluar një diskutim i frytshëm nga ku është konstatuar se:

- rezultatet e anketës janë brengosëse: ekzistojnë dallime të mëdha në qëndrimet midis komunitetit shqiptar dhe atij maqedonas rreth çështjes së emrit dhe proceseve euro-integruese në kushte kur ndajmë një ardhmëri të përbashkët;

- është e nevojshme pjesëmarrja dhe kyçja më aktive e hulumtuesve dhe ekspertëve të rinj në proceset aktuale të vendit: profilizimi i kuadrove brenda partive politike;

- vërehet mungesë e vullnetit të mirëfillte për zgjidhjen e problemeve aktuale dhe anëtarësimit në strukturat euro-atlantike nga ana e subjekteve politike, dhe mungesa e një mase kritike të popullatës dhe të qëndrueshme në realizimin e përcaktimeve strategjike dhe interesave të vendit;

- subjektet politike shqiptare janë indiferente rreth kontestit të emrit me Greqinë dhe duhet të kyçen në mënyrë më aktive në zgjidhjen e kësaj çështje, pasi që kjo i tangon njësoj të gjithë qytetarët.

Projekti hulumtues në fjalë trajton një problematikë gjithëpërfshirëse të politikës së jashtme të Maqedonisë dhe problemet e brendshme me të cilat ballafaqohet shteti. Nevoja për një hulumtim të gjithanshëm të kësaj problematike ishte shfaqur nga rrethanat aktuale. Në këtë projekt janë shtruar çështje serioze për shtetin maqedonas, sfidat dhe problemet aktuale në proceset euro-integruese.

Nga hulumtimet në teren, anketat me qytetarët dhe hulumtimet shkencore të pjesëmarrësve në projekt dhe ekspertëve të angazhuar, janë sugjeruar drejtimit e ardhshme të Maqedonisë drejt procesit të anëtarësimit në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Qëllimi kryesor është

që të zbulohen mangësitë e veprimit të autoriteve shtetërore dhe të sugjerohen hapat e mëtejme të veprimit.

Objektivat e projektit dhe qëllimi i Konferencës shkencore në këtë temë janë me sa vijon: të ndikon në ngritjen e vetëdijes së qeverisë për një qasje më serioze drejt zgjidhjes së problemeve reale me të cilat ballafaqohet Maqedonia dhe qytetarët e saj si në aspektin e brendshëm poashtu edhe në relacionet ndërkombëtare; të kontribon për një angazhim më të madh të faktorëve politik shqiptar në proceset aktuale politike në vend; të mundëson qytetarët të shprehen lirshëm për problemet reale me të cilat ballafaqohen dhe të shprehin brengosjen e tyre për ushtrimin e një politike e cila nuk është në favorin e tyre; ti sugjeron faktorët politik në respektimin e vlerave dhe interesave të përbashkëta të qytetarëve e jo në interesat e ngushta partiake; të paralajmëron në rreziqet potenciale në rast të mosrealizimit në kohë të interesave strategjike euro-atlantike të vendit.

Drejtor i CRPA
Doc.D-r Abdulla AZIZI

PËRMBAJTJA

Rezultatet e Anketës së realizuar: Opinioni publik i komunitetit shqiptar në Maqedoni për NATO.....	1
METODOLOGJIA E SHFRYTËZUAR.....	1
KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE TË ANKETËS SË REALIZUAR.....	1
REZULTATET.....	2
Prof. Dr. Fejzulla Shabani	11
Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe ndryshimet Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë.....	11
Abstrakt.....	11
1. Aspekti kushtetues-juridik i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit	11
2. Përmbajtja e ndryshimeve Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë.....	13
3. Implementimi i ndryshimeve Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë	14
4. Në vend të përfundimit.....	15
Prof. d-r Renata Treneska-Deskoska.....	17
KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE PAVARËSIA E GJYQËSISË.....	17
Hyrje	17
1. Historia: arsyet për reformim të Këshillit gjyqësor republikan.....	18
2. Normativa e sotme: Këshilli gjyqësor në RM.....	20
3. Ndërprerja e mandatit të anëtarëve të Këshillit gjyqësor.....	22
4. Kompetencat e Këshillit gjyqësor të RM-së	23
Përfundim	25
JUDICIAL COUNCIL OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA AND THE INDEPENDENCE OF THE JUDICIARY	27
Doc. D-r Vasko Naumovski	29
Maqedonia ndërmjet integriteteve dhe veto-s.....	29
(Abstrakt).....	29
Doc.D-r Abdulla Azizi.....	39
Realiteti dhe sfidat e Republikës së Maqedonisë në fushën e politikës sociale	39
Hyrje	39
1. Politika e punësimit	40
2. Trajtimi i barabartë dhe jodiskriminimi	41
3. Dialogu social	43
4. Sigurimi social dhe mbrojtja sociale.....	44
5. Të drejtat e punëtorëve	46

6. Mbrojtja gjatë punës.....	49
Rezyme.....	52
Dr. sc. Ali MUSLIU	53
Harmonizimi i sistemit të të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë me standardet ndërkombëtare (Procesi i integrimi euroatlantike).....	53
Abstrakt.....	53
1. Harmonizimi i legjislacionit në Republikën e Maqedonisë – sfidat dhe problemet.....	54
2. Të drejtat e njeriut dhe integrimi euroatlantik i Republikës së Maqedonisë.....	57
3. Në vend të përfundimit.....	61
Mr.sc. Jeton Mazllami &	63
Mr.sc. Brikend Aziri	63
ANALIZA KRAHASIMORE E KRITERIUMEVE EKONOMIKE PER ANETARËSIM TË R.MAQEDONISE NË BE.....	63
Abstrakt.....	63
RRUGËTIMI I R. MAQEDONISË DREJTË EVROPËS.....	64
1. PËRMBUSHJA E KRITEREVE EKONOMIKE TË MASTRIHTIT KRITERIUMET PËR KONVERGJENCË TË MASTRIHTIT	64
STABILITETI I ÇMIMEVE.....	65
NORMAT E KAMATAVE.....	66
STABILITETI I KURSIT TË KËMBIMIT	67
STABILITETI FISKAL.....	67
2. PËRMBUSHJA E KRITEREVE EKONOMIKE TË KOPENHAGËS (Bazuar në raportin e përparimit të RM nga Komisioni Evropian për vitin 2008)	71
a.) EKZISTIMI FUNKSIONAL I EKONOMISË SE TREGUT.....	71
b.) KAPACITETI PËR BALLAFAQIM ME PRESIONET KONKURUESE TË TREGJEVE	77
KONKLUZIONET	79
Traktati i Kopenhagës për integrim në BE.....	80
Mr.sc Bekim Nuhija.....	81
Integrimi i Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian	81
Hyrje	81
1. Proçesi i zgjerimit të Unionit Evropian dhe relacionet mes Maqedonisë dhe Unionit Evropian	82
2. Nënshkrimi i Marrëveshjes për Stabilizim Asocim me Maqedoninë.....	83
3. Marrëveshja e Përkohshme.....	85
4. Hyrja në fuqi e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim.....	85
Përfundim	87
Mr.sc. Vullnet ZENKI	89

STANDARDET EVROPIANE MBI MJEDISIN JETËSOR DHE TË ARRITURAT E R. MAQEDONISË	89
Hyrje	89
1. Rreziqet ambientale për Evropën	90
2. Strategjitë e ardhshme për mbrojtjen e ambientit jetësor	92
Rekomandime dhe konkluzat	94
Makedonka Vilarova.....	97
Procesi i anëtarësimit në BE dhe orvatjet e RM-së	97
Hyrje	97
1. Kriteriumet për anëtarësim në BE	98
2. Interesi strategjik i RM-së për anëtarësim në BE	99
3. Kushtet të cilat BE-ja ia parashtron RM-së për anëtarësim	100
4. Orvatjet e RM-së për anëtarësim në BE	101
5. Argumentet “kundër” dhe “pro” anëtarësimit në BE	103
Përfundim	104
Lulzim Farizi	105
1. Procesi i anëtarësimit të RM-së në BE dhe realiteti politik pas samitit të Bukureshtit.....	105
2. Procesi i integrimit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian.....	106
3. Plotësimi i kriterëve si kusht për integrimin e Maqedonisë në UE.....	109
4. Zgjidhja e kontestit me emrin e RM-së, domosdoshmëri për vazhdimin e proceseve integruese në BE	112
Mimoza Qamili &.....	115
Arta Azizi-Ziberi.....	115
Kontesti rreth emrit të Republikës së Maqedonisë, vështruar nga prizma e ndikimit në marrëdhëniet ndërkombëtare	115
Përfundim	118
Arta Azizi-Ziberi.....	119
Rëndësia e zgjidhjes së kontestit rreth emrit të Republikës së Maqedonisë.....	119
Albulena Halili &.....	131
Fatmir Arifi.....	131
Maqedonia mes integrimit në strukturat euro-atlantike dhe gjeopolitikës ballkanike.....	131
Abstrakt	131
1. NATO dhe gjeopolitika ballkanike.....	132
2. Samiti i Bukureshtit dhe mospranimi i Maqedonisë në NATO.....	136
2.1. Shkaqet për mospranim.....	137
2.2. Pasojat e mundshme nga mospranimi i Maqedonisë në NATO.....	144
3. Përfundime dhe rekomandime	147

Rezultatet e Anketës së realizuar: Opinioni publik i komunitetit shqiptar në Maqedoni për NATO

Qendra për hulumtime të Administratës Publike, pranë Universitetit të Evropës Jug-Lindore në Tetovë në periudhën janar – prill 2009, në suaza të Projektit: *Perspektivat euro-atlantike të R. së Maqedonisë: Problemet, sfidat dhe realiteti politik pas dështimit në Samitin e NATO-s në Bukuresht-2008* realizoi anketë për hulumtimin e opinionit të komunitetit shqiptarë në Republikën e Maqedonisë dhe perceptcionet e tyre për NATO aleancën, si dhe për disa çështje lidhur me proceset evro-integruese të vendit.

METODOLOGJIA E SHFRYTËZUAR

Hulumtimi është realizuar në pyetësor të standardizuar, në të cilin janë respektuar specifikat demografike të popullatës (struktura gjinore, grupëmoshat, niveli i arsimit, statusi i punësimit), ndërsa ishte bërë edhe ndarje e posaçme e të anketuarëve sipas vendit të jetesës (mjedis urban apo rural), si dhe janë përfaqësuar të gjitha rajonet ku jetojnë shqiptarë në Maqedoni.

KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE TË ANKETËS SË REALIZUAR

Në anketë janë përfshirë 511 të anketuar, nga të cilët 311 burra, ndërsa 200 gra përkatësisht 61% burra dhe 39% gra.

Për sa i përket grupëmoshave nga të anketuarit janë përfshirë: 281 (55%) të rinj deri në moshën 29 vjeç, 64 (14%) në moshë midis 30-39 vjeç, 74 (13%) në moshë midis 40-49 vjeç, 58 (11%), në moshë 50-59 vjeç, ndërsa 34 (7%) në moshë mbi 60 vjeç.

Sipas nivelit të arsimit 60 (12%) e të anketuarëve kanë mbaruar arsimin fillor, 125 (24%) kanë mbaruar arsimin e mesëm, ndërsa 326 (64%) kanë mbaruar së paku fakultet.

Sipas statusit të punësimit, 299 (59%) nga të anketuarit janë të papunë, 184 (36%) janë të punësuar, ndërsa 28 (5%) janë pensionistë.

Sipas vendit të jetesës, 260 (51%) e të anketuarëve jetojnë në fshat, ndërsa 251 (49%) jetojnë në qytet.


REZULTATET

Anketa përbëhej nga dhjetë pyetje, lidhur me të cilat të anketuarit i kanë dhënë përgjigjet me sa vijon:

Pyetja e parë në anketë ishte: **Si do të kishte ndikuar pranimi i RM-së në NATO mbi stabilitetin e vendit, zhvillimin ekonomik dhe investimet e huaja ?**

Të anketuarit kanë dhënë përgjigjet e tyre me sa vijon:


- a) Pozitivisht kanë dhënë përgjigjen 469 (92%) e të anketuarëve,
- b) Negativisht kanë dhënë përgjigjen 12 (2%) e të anketuarëve, ndërsa
- c) 30 (6%) janë përgjigjur se një gjë e tillë nuk do të kishte ndikim.



Në pyetjen e dytë: **Refuzimi i RM-së në Samitin e Bukureshtit për pranim në NATO ishte rrezultat i politikës së dështimit të diplomacisë maqedonase ?**

Të anketuarit kanë dhënë përgjigjet e tyre me sa vijon:


- a) Me PO janë përgjigjur 401 (78%) e të anketuarëve,
- b) JO kanë dhënë përgjigjen 39 (8%) e të anketuarëve, ndërsa
- c) Nuk kanë përgjigje 71 (14%) e të anketuarëve.



Pyetja e tretë ishte me sa vijon: **A ka ndryshuar qëndrimi i juaj për NATO-n pas Samitit në Bukuresht ?**

Të anketuarit kanë dhënë përgjigjet e tyre me sa vijon:


- a) 74 (15%) e të anketuarëve janë përgjigjur me PO,
- b) 338 (66%) janë përgjigjur me JO, ndërsa
- c) 98 (19%) s'kanë përgjigje ose janë neutral.



Pyetja e katert: **A jeni dakord me ndërimin e emrit të shtetit të RM-së në negociatat me Greqinë për anëtarësim në NATO dhe BE ?**

Të anketuarit kanë dhënë përgjigjet e tyre me sa vijon:


- a) PO janë deklaruar 426 (83%),
- b) JO janë deklaruar 40 (8%), ndërsa
- c) 45 (9 %) s'kanë përgjigje.



Pyetja e pesë: **Zgjidhja e kontestit rreth emrit me Greqinë është çështje e cila duhet zgjedhur ...?**

Të anketuarit kanë dhënë përgjigjet e tyre me sa vijon:


- a) Sa më parë dhe pa humbur kohë përmes ndërmjetësuesit të OKB-së janë përgjegjur 392 (77%) e të anketuarëve,
- b) Të pritët vendimi i Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë janë deklaruar 38 (7%) e të anketuarëve,
- c) Të mbahet referendum janë deklaruar 16% e të anketuarëve.



Pyetja e gjashtë: **Si do të kishit votuar në rast të referendumit për hyrje në NATO dhe ndryshimit të emrit të RM-së ?**

Të anketuarit kanë dhënë përgjigjet e tyre me sa vijon:


- a) 438 (86%) janë deklaruar se do të kishin votuar PRO,
- b) 35 (7%) janë deklaruar se do të kishin votuar kundër, ndërsa
- c) 38 (7%) se do të abstenojnë



Pyetja e shtatë: Sa participojnë subjektet politike shqiptare në formimin e politikës së jashtme të shtetit ?

Të anketuarit kanë dhënë përgjigjet e tyre me sa vijon:


- a) 268 (52%) mendojnë se aspak,
- b) 210 (41%) mendojnë fare pak, ndërsa
- c) 33 (7%) në mënyrë të barabartë me subjektet politike maqedonase



Pyetja e tetë: Për ç'arsye subjektet politike shqiptare nuk angazhohen që të marrin pjesë në negociatat rreth emrit të RM-së me Greqinë ?

Të anketuarit kanë dhënë përgjigjet e tyre me sa vijon:


- a) 439 (85.6%) janë përcaktuar "Për shkak të partitë politike maqedonase e llogaritin këtë si problematikë që i tangon vetëm maqedonasit",
- b) 70 (14%) janë përcaktuar "Për shkak të mosinteresimit të subjekteve politike shqiptare për integrimet euro-atlantike, ndërsa
- c) arsyet nuk i dijnë vetëm 2 të anketuar ose 0.4%



Pyetja e nëntë: **A llogaritni se çështja e emrit të RM-së i prek edhe intersat e shqiptarëve dhe a duhet të merren parasysh edhe qëndrimet dhe opinionet e tyre ?**

Të anketuarit kanë dhënë përgjigjet e tyre me sa vijon:


- a) 427 (84%) janë përgjigjur me PO,
- b) 41 (8%) janë përgjigjur me JO,
- c) ndërsa 43 (8%) nuk ka ndikim.



Pyetja e dhjetë: **A mendoni se R. e Maqedonisë në plan afatgjat do të ketë pasoja rreth sigurisë për shtetin për shkak të mosanëtarësimit në NATO dhe moszgjidhjes së kontestit rreth emrit me Greqinë ?**

Të anketuarit kanë dhënë përgjigjet e tyre me sa vijon:

- a) 444 (87%) e të anketuarëve kanë dhënë përgjigjen PO,
- b) 27 (5%) kanë dhënë përgjigjen JO, ndërsa
- c) 40 (8%) se nuk do të ketë ndikim.



Analiza rreth çështjes së **votimit në rast të referendumit duke përfshirë grupëmoshat e ndryshme** është me sa vijon:


Për grupëmoshat deri në 29 vjeç: PRO janë deklaruar 82%, kundër 9% ndërsa janë deklaruar se do të abstenojnë 9% e të anketuarëve.

Për grupëmoshat 30-39 vjeç: PRO janë deklaruar 89%, kundër 5%, ndërsa 6% e të anketuarëve janë deklaruar se do të abstenojnë.

Për grupëmoshat 40-49 vjeç: PRO janë deklaruar 86%, kundër 7%, ndërsa 7% e të anketuarëve janë deklaruar se do të abstenojnë.

Për grupëmoshat 50-59 vjeç: PRO janë deklaruar 95%, kundër 3%, ndërsa 2% e të anketuarëve janë deklaruar se do të abstenojnë.

Për grupëmoshat mbi 60 vjeç: PRO janë deklaruar 91%, kundër 3%, ndërsa 6% e të anketuarëve janë deklaruar se do të abstenojnë.



Qendra për hulumtime të Administratës Publike edhe mëtej do të ndjek situatën rreth proceseve euro-integruese të RM-së, do të vazhdon të realizon hulumtime dhe do të përpunon të dhënat rreth opinionit të qytetarëve mbi çështjet aktuale që i tangojnë nevojat dhe interesat e tyre të përditshme.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe ndryshimet Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë

Abstrakt

Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe zbatimi i saj është një nga prioritetet kryesore të Republikës së Maqedonisë për procesin e demokratizimit, ndërtimin e besimit në institucione dhe integrimin e vendit në Unionin Evropian. Marrëveshja Kornizë e nënshkruar më 13.08.2001 i dha fund konfliktit të mbrendshëm në Republikën e Maqedonisë, dhe qëllimi kryesor i saj ishte promovimi i një shoqërie paqësore dhe harmonike, si dhe zhvillimi i shoqërisë qytetare, duke respektuar identitetin etnik dhe interesat e të gjithë qytetarëve në Republikën e Maqedonisë. Në bazë të kësaj Marrëveshje dolën një numër i konsiderueshëm i ndryshimeve Kushtetuese dhe reforma ligjore të cilat duhet të zbatohen nga ana e institucioneve të Republikës së Maqedonisë në sferën e decentralizimit, përfaqësimit të drejtë, procedurave speciale parlamentare për mbrojtjen e etniteteve që nuk janë shumicë, arsimimin, përdorimin e gjuhës, simbolet, shprehja e identitetit kultoror dhe etnik si dhe masat për zbatim.

1. Aspekti kushtetues-juridik i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit

Nga pikëpamja kushtetuese-juridike, Marrëveshja e Ohrit paraqet një kompromis të pashmangshëm lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë. Marrëveshja Kornizë vendos qytetarin në qendër të sistemit kushtetues dhe politik, duke përmbushur të gjitha vullnetet e çdo individit veç e veç dhe të kolektivitete të tyre bashkarisht për arritjen e paqës, demokracisë, progresit dhe harmonisë së përgjithshme. Në vetë tekstin e Marrëveshjes Kornizë theksohet se “Kjo Marrëveshje Kornizë do ta promovojë zhvillimin e qetë dhe harmonik të shoqërisë qytetare, duke respektuar

¹ Ligjërues pranë Fakultetit Juridik në USHT

njëkohësisht identitetin etnik dhe interesat e të gjithë qytetarëve të Maqedonisë”.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit përmban:

1. Parimet themelore, të cilat ndër të tjera përfshinë: hedhjen poshtë të përdorimit të dhunës për arritjen e qëllimeve politike, ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit teritorial si dhe karakterin unitar të Maqedonisë, ruajtjen e karakterit shumë etnik të shoqërisë maqedonase në jetën publike etj.

2. Ndërpjerjen e armiqësive, që ka të bëj me: ndërpjerjen e tërësishme të armiqësive, çarmatimin e tërësishëm vullnetar të grupeve të armatosura dhe shpërndarjen e tyre vullnetare.

3. Zhvillimin e pushtetit të decentralizuar, që do të arrihet nëpërmjet: nxjerrjes së ligjit të rishikuar mbi pushtin vendor që do të shtojë autorizimet dhe kompetencat e këtij pushteti, rishikimit të kufijve komunalë, zgjedhjes së kryeshefave lokalë të policisë nga ana e Këshillave Komunale nga lista e kandidatëve të propozuara nga Ministria e Punëve të Brendshme.

4. Mosdiskriminimin dhe përfaqësimin e drejtë. Ky parim vjen në shprehje në: trajtimin e barabartë të të gjithë personave para ligjit, në punësimet adekuate në administratë, në zgjedhjen e 1/3 të gjykatësve të Gjykatën Kushtetuese nga Kuvendi me shumicën e numrit të përgjithshëm të deputetëve që do të përmbajnë shumicën e numrit të përgjithshëm të deputetëve nga ana e bashkësive në Maqedoni, procedurë e cila do të zbatohet edhe për zgjedhjen e Avokatit të Popullit (Ombudsmanit), dhe tre anëtarëve të Këshillit Gjyqësorë.

5. Procedurat e posaçme Kuvendore që nënkuptojnë se për nxjerrjen e ligjeve që drejtëpërsëdrejti kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhës, arsimin, dokumentet personale dhe përdorimin e simboleve, si dhe të Ligjit për finansim lokal, zgjedhjet vendore, për Qytetin e Shkupit dhe për kufijtë komunalë do të duhet të ekzistojnë shumica e votave, në kuadër të së cilës duhet të jetë shumica e votave të deputetëve të cilët pohojnë se u takojnë bashkësive që nuk janë popullatë shumicë në Maqedoni.

6. Arsimin dhe përdorimin e gjuhëve, që ka të bëjë me: sigurimin e finansimit të arësimit sipëror nga ana e shtetit në gjuhët në të cilët flasin të paktën 20% e popullsisë, në bazë të marrëveshjeve të posaçme. Në tërë teritorin e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase, ndërsa më poshtë parasheh se “cila do gjuhë tjetër në të cilën flasin 20% e popullatës është poashtu gjuhë zyrtare.....”;

7. Shprehja e identitetit nënkupton se pranë simbolit të Republikës së Maqedonisë, autoritetet vendore do ta kenë lirinë që në anën e parë të objekteve publike vendore të vendosin simbolet me të cilat shënohet identiteti i bashkësisë e cila është shumicë në komunë.

8. Implementimi, që përfshinë periudhën kohore të miratimit të ndryshimeve kushtetuese si dhe të ndryshimeve në legjislacion dhe i bëhet thirrje faktorit ndërkombëtar që të thirrë konferencën donatore makrofinansiare për nevojat e implementimit të kësaj Marrëveshjeje.

9. Anekset, që, si pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje, kanë të bëjnë me

A: ndryshimet kushtetuese,

B: Ndryshimet në legjislacion;

C: Implementimin dhe masat e ndërtimit të besimit.

2. Përmbajtja e ndryshimeve Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë

Duke pranuar Kushtetutën e ndryshuar si burim të vetëm, unik dhe të plotë, përjashtohet çdo mundësi kundërshtimi në midis normave të saj dhe normave të ligjeve që duhet nxjerrë, prandaj referimet në Marrëveshjen Kornizë se “Kuvendi do të ligjësoj të gjitha dispozitat ligjore që mund të jenë të domosdoshme për t'i dhënë efektë të plotë Marrëveshjes Kornizë”, së paku nga ana juridike nuk duhet të lënë dilemë se cilës normë i përket prioriteti, pra cila prej tyre do të konsiderohej në fuqi. Sipas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, u arrit pëlqimi që të ndryshohet preambula e Kushtetutës së Maqedonisë, e cila nuk ishte në përputhje me qëllimet dhe aspiratat e shqiptarëve për barazi të plotë

konstitucionale, dhe ajo u riformulua duke u mështetur në konceptin e paqart qytetar dhe qytetrues të Republikën e Maqedonisë.

Ndryshimet kushtetuese në tekstin normativ të Kushtetutës së Maqedonisë përfshinë 15 nenet saj, të cilat, për nga përmbajtja janë të ndryshme. Pra, bëhet fjalë për ndryshimin e atyre dispozitave kushtetuese që rregullojnë çështjen e përdorimit zyrtar të gjuhëve, vlerat themelore të rregullit kushtetues të RM-së, bashkësitë fetare, mbrojtjen, përparimim dhe begatimim e thesarit historik dhe artistik në Maqedoni dhe të të gjitha bashkësive që jetojnë në të, procedurën e nxjerrjes së ligjeve që cenojnë drejtëpërsëdrejti të drejtat dhe interesat e bashkësive, zgjedhjen dhe kompetencat e Ombudsmanit, transformimin e Këshillit për marrëdhënie ndërnacionale në Komitet për marrëdhënie midis bashkësive, emërimin e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit, emërimin e disa anëtarëve të Këshillit Gjyqësor Republikan dhe të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë nga radhët e bashkësive, ndërimin e emrit dhe kompetencat e pushtetit lokal, si dhe nëdrimin e procedurës për ndryshimin e preambulës si dhe të dispozitave të caktuara kushtetuese që kanë të bëjnë me të drejtat e shqipëtarëve në Maqedoni. Të gjitha këto ndryshime kushtetuese të tekstit normativ duhet të jenë në funksion të forcimit të karakterit qytetar të shtetit, që njëherësh nënkuptojnë edhe forcimin e elementit qytetrues me avancimin e pozitës juridiko-kushtetuese të bashkësive në RM në një shkallë më të lartë.

3. Implementimi i ndryshimeve Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë

Edhe përkundër ndryshimeve Kushtetuese, kemi një disbalans në mes përcaktimit dhe implementimit të këtyre ndryshimeve Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë. Marrëveshja e Ohrit është një modus i mirë për ndërtim të një shoqërie stabile, por problem paraqet zhagitja e implementimit të këtij akti kurse rrezik më i madh, mbetja e tij vetëm shkronja të hudhura në letër. Përvoja historike tregon se ekzsitenca e një dokumenti të rëndësishëm nuk është e mjaftueshme nëse nuk shoqërohet me aksion zbatues. Në këtë kontekst domethënëse janë fjalët e Montesqieu-së: "Kur shkoj në ndonjë vend s'pyes fare nëse ka ligje të mira në të, por pyes se sa ato zbatohen..."

Ligji mbi pushtetin lokal, që u nxor në bazë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, rriti dukshëm disa kompetenca që tashmë mund t'i ushtrojë pushtetin lokal, por ende nuk mund të flasim për një decentralizim të plotë të pushtetit në nivel lokal, sepse ngec sidomos procesi i implementimit të tij. Poashtu rasti është edhe me Ligjit për ndarjen territoriale, me të cilin bashkimi i komunës së Kërçovës shtyhet për katër vite. Në ligjin aktual parashikohej që në fillim të vitit 2009, komuna e Zajazit dhe Osllolomesë t'i bashkohen qendrës urbane. Ligji për gjuhët që u miratua nga ana e Parlamentit me 2008, nuk rregullon çështjen e përdorimit të gjuhës shqipe në institucionet tjera të pushtetit qendror, konform Marrëveshjes Kornizë së Ohrit dhe ndryshimeve Kushtetuese.

Ndryshimet kushtetuese në sferën e arsimit paraqesin vërejtjen më serioze dhe konfuze, ngase keto ndryshimet nuk garantojnë të drejtën e plotë të shqipëtarëve në arsimin e lart. Edhe përkundër përcaktimit në Marrëveshjen e Ohrit se "Finansimi nga shteti do të sigurohet për arsimin sipëror në gjuhën në të cilën flasin të paktën 20% e popullatës në Maqedoni...", realiteti është krejtësisht ndryshe. Sot kemi një shpërndarje joproporcionale të mjeteve financiare të universiteteve shtetërore në Republikën e Maqedonisë.

4. Në vend të përfundimit

Rruga e zhvillimit demokratik në Maqedoni duhet të jetë e hapur nga kushtet dhe faktorët që e determinojnë atë dhe do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e përgjithshëm të saj. Maqedonia duhet të përcaktohet në aspektin politik dhe kushtetues që të ndjekë rrugën e zhvillimit demokratik të shteteve perendimore demokratike, për shkakë se vetëm integrimi në sturkturat euroatlantike mund të siguroj ardhmëri të sigurt për Maqedonin. Prandaj Republik e Maqedonisë tetëmbëdhjetë vite të procesit të tranzicionit, gjendet para sfidave historike të arritjes së kohezionit të shoqërisë në baza të principeve demokraite dhe standardeve evropiane për të gjithë qytetarët e saj, pa marrë parasysh racën, besimin, përkatësisë nacionale ose përkatësisë tjetër, që respektivisht do të integroj Republikën e Maqedonisë në Unionin Evropian, dhe rrumbullaksimin e procesit historik të evropeizimit të Maqedonisë në aspektin politik, juridik, ekonomik dhe kulturor.

KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE PAVARËSIA E GJYQËSISË

Hyrje

Një nga detyrat kryesore të cilat i janë dhënë Republikës së Maqedonisë në procesin e intergimeve euro-atlantike është përforsimi i pavarësisë gjyqësore.

Opinion publik në Maqedoni lidhur me pavarësinë e gjykatësve është kryesisht negativ. Vetë gjykatësit nuk kanë bërë shumë për të fituar pushtet të vërtetë. Pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ poashtu nuk bënë shumë për të dhënë një shans të tillë gjykatësve. “Memorja kolektive e sistemit socialist” dhe roli i gjyqësisë në atë kohë akoma është prezente. Pasojat e kësaj periudhe, kur drejtësia ishte nënshtruar politikës, akoma janë prezente, veçanërisht në administratë dhe gjyqësi, roli i të cilëve në rendin juridik dhe shoqëri akoma nënçmohet.

Në Republikën e Maqedonisë janë bërë shumë ndryshime kushtetuese në mënyrën e emërimit dhe shkarkimit të gjykatësve dhe në përbërjen e Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, me qëllim që të krijohen garanca strukturore për pavarësinë e gjyqësisë. Mirëpo, nga njëra anë parashtrrohet pyetja sa këto ndryshime kushtetuese janë hap i vërtetë drejt realizimit të pavarësisë gjyqësore. Nga ana tjetër imponohet sentimentimi se realizimi i reformave gjyqësore të cilat kanë të bëjnë me garancat institucionale të pavarësisë gjyqësore janë hapi i parë por i pamjaftueshëm për arritjen e pavarësisë gjyqësore. Ndërtimi i shtetit juridik dhe vënia e sistemit të sundimit të së drejtës është shumë më me rëndësi për realizimin e pavarësisë gjyqësore, ndërsa për realizimin e këtij objektivi është i rëndësishëm kontributi i pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv, mirëpo edhe i pushtetit gjyqësor.

¹ Ligjëruese pranë Fakultetit Juridik “Justinian Prima” Shkup

1. Historia: arsyet për reformim të Këshillit gjyqësor republikan

Amandamentet kushtetuese të vitit 2005 ishin hapi më i madh i reformave në gjyqësi në Republikën e Maqedonisë. Ndryshimi më i madh kushtetues ishte ndryshimi i mënyrës se zgjidhjes se gjykatësve.

Sipas tekstit kushtetues të vitit 1991, gjykatësit zgjidheshin nga Parlamenti në propozim të Këshillit gjyqësor republikan (KGjR). Qëllimi i themelimit të KGjR-së si organ në Republikën e Maqedonisë ishte që të kufizohet ndikimi partiak në procedurën për zgjidhje, kontroll dhe shkarkim të gjykatësve. Megjithatë, përbërja dhe mënyra e zgjidhjes së KGjR-së ishin nën ndikim të plotë politik, ashtu që me të drejtë parashtrohej pyetja: Quis custodiet ipsos custodes? (Kush i mbron rojtarët?). Në vend të rojtarit të pavarësisë gjyqësore, KGjR për nga strukturimi kushtetues më tepër ishte servis i pushtetit ligjvënës dhe atij ekzekutiv sesa gjyqësor. E para, zgjedhja e KGjR-së ishte vetëm në kompetencë të Kuvendit. KGjR-ja përbëhej nga shtatë anëtarë², të cilët zgjidheshin nga Kuvendi “nga radhët e juristëve të dëshmuar”. Dy nga të cilët i propozonte Kryetari i shtetit, ndërsa të tjerët propozoheshin nga vetë Kuvendi. Kushti që duhej plotësuar për tu zgjedhur në KGjR (jurist i dëshmuar) ishte shumë subjektiv. Kushtetuta nuk përmbante dispozita se KGjR duhet të përbëhet nga numër i caktuar i gjykatësve. Ligji për KGjR³ përmbante dispozitë se 4 nga anëtarët duhet të zgjidhen nga radhët e gjykatësve, ndërsa 3 të tjerët nga institucionet tjera dhe veprimtaritë, mirëpo Gjykata kushtetuese e shfuqizoi këtë dispozitë të Ligjit si jokushtetuese, pasi që Kushtetuta nuk e specifikonte bekgraundin e anëtarëve të KGjR-së (Vendimi i Gjykatës kushtetuese, Nr.26/93). Lehtë mund të ndodhte që asnjë nga anëtarët e KGjR-së të mos rrjedh nga radhët e gjykatësve.

² Kushtetuta e RM-së përcaktoi mandatin 6 vjeçar për anëtarët e KGjR-së me të drejtë të një rizgjedhje. As Kushtetuta, as Ligji për KGjR (Gazeta zyrtare e RM-së Nr. 80/1992) nuk parashih situatë në të cilën mandati i ndonjë anëtarit të KGjR-së nuk fillon në të njëjtën kohë me mandatin e anëtarëve tjerë. Kur njërit nga anëtarët e KGjR-së iu ndërpre mandati për shkak të vdekjes, ishte zgjedhur anëtar i ri i cili e zëvendësoi të mëparshmin. Mandati i anëtarëve tjerë të KGjR-së mbaroi në vitin 2000. Në procedurën për zgjidhje të anëtarëve të rinj të KGjR-së, neni 104 ishte interpretuar drejtë se parashih mandate prej 6 vite për anëtarët e KGjR-së, e jo për KGjR si organ. Për shkak të kësaj, mandati i anëtarit të KGjR-së i cili ishte zgjedhur më parë vazhdoi dhe ishin zgjedhur vetëm 5 anëtarë tjerë të KGjR.

³ Ligji për Këshillin gjyqësor, Gazeta zyrtare e RM-së Nr. 80/92.

Zgjidhja e anëtarëve të KGjR ishte në varshmëri të plotë të partive qeverisëse në Kuvend dhe pushteti gjyqësor nuk kishte asnjëfarë ndikimi në zgjidhjen e anëtarëve të saj, edhe përpos asaj se ky organ duheshte të jetë më së afërmi i lidhur me të.

Poashtu, zgjidhja e anëtarëve të KGjR-së, si dhe të kryetarëve të gjykatave ishte bazuar në parimin “garë me një kalë”, që nënkupton se propozohen aq kandidatë sa emërohen.

Kuriozitet tjetër i sistemit kushtetues në RM ishte se anëtarët e KGjR-së zgjidheshin me shumicë relative e jo absolute. Kushtetuta e RM-së me amandamentin X proklamon se Kuvendi mund të vendos nëse në seancë janë prezent shumica nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Kuvendi vendos me shumicë votash nga deputetët prezent, ndërsa së paku me 1/3 nga numri i deputetëve, nëse me Kushtetutë nuk parashihet shumicë e posaçme. Për sa i përket shumicës së duhur me të cilën miratohen vendimet e njëjta ishte edhe dispozita e nenit 69 e cila ishte zëvendësuar me Amandamentin X.

Kushtetuta e vitit 2001 nuk parashihte shumicë të posaçme për zgjidhje të KGjR-së, si dhe për zgjidhje të gjykatësve, kështu që zbatoheshin neni 69 që nënkupton se anëtarët e këtij organi zgjidheshin me 40 (nga 120) votat në Kuvend. Me amandamentet kushtetuese të vitit 2001 (Amandamenti XIV) është futur dispozitë e re, sipas së cilës tre nga anëtarët e KGjR-së zgjidhen me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët i takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në RM. Shkalla e partizimit të KGjR-së ndikoi në partizimin e procesit të zgjidhjes së gjykatësve.

Si rezultat i kësaj, opinioni publik në Maqedoni lidhur me pavarësinë e gjykatësve ishte kryesisht negativ. Vetë gjykatësit nuk bënë shumë për të marrë pushtet të vërtetë. Pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ poashtu nuk punuan në drejtim që tu japin një shans të tillë gjykatësve. “Memorja kolektive e sistemit scialist” dhe roli i gjyqësisë së asaj kohe akoma është prezente. Pasojat e asaj periudhe, kur drejtësia ishte nënshtruar politikës akoma është prezente, veçanërisht në administratë dhe gjyqësi, roli i të cilave në rendin juridik dhe shoqëri akoma është i nënçmuar.

Nga njëra anë të përditshme ishin shembujt ku KGjR-ja propozonte kandidatë për gjykatës, ndërsa ato ishin të refuzuar nga Kuvendi i RM-së.

Nga ana tjetër janë të njohura dhe të hapura rastet e shtypjes ndaj gjykatësve nga ana e pushtetit ekzekutiv.⁴

Nga ana tjetër, gjykatat në RM nuk u dëshmuar si kontrollues efikas të ligjshmërisë në ushtrimin e pushtetit nga ana e organeve ekzekutive. Kjo rezultoi në përhapjen e mosbesimit në sistemin juridik. Mirëpo, duhet potencuar se mosbesimi në gjykatat jo çdoherë bazohet në dyshimet në pavarësinë e tyre, por arsye për opinionin e këtyllë publik është poashtu edhe joefikasiteti gjyqësor në mbrojtjen e të drejtave.

Për shkak të kësaj ishte e nevojshme që të fillohet me proces të reformave në sferën e gjyqësisë, më të cilat do të kontribohet për garantimin e pavarësisë dhe efikasitetit të gjyqësisë.

2. Normativa e sotme: Këshilli gjyqësor në RM

a. *Përbërja e Këshillit gjyqësor të RM-së*

Amandamentet kushtetuese të vitit 2005, ndër të tjerat e ndëruan edhe mënyrën e zgjidhjes së gjykatësve dhe përbërjen e Këshillit Gjyqësor. Këshilli gjyqësor i RM-së sipas Amandamentit XXVIII përbëhet prej 15 anëtarëve. Tetë anëtarë të Këshillit i zgjedhin gjykatësit nga radhët e veta, nga të cilët tre janë të përkatësisë së komuniteteve pakicë në RM. Pesë anëtarë të Këshillit gjyqësor zgjidhen nga Kuvendi, me shumicë të ndryshme. Nga ato, tre anëtarë të Këshillit i zgjedh Kuvendi i RM-së me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, gjatë së cilës patjetër duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i votave të deputetëve të cilët i takojnë komuniteteve pakicë. Dy anëtarë i propozon Kryetari i shtetit, nga të cilët një përfaqësues është i komuniteteve pakicë. Për këto dy anëtarë të Këshillit gjyqësor kërkohet shumicë e posaçme në Kuvend dhe ato mund të zgjidhen me së paku 40 votat e deputetëve, sipas Amandamentit X. Kryetari i Gjykatës supreme të RM-së dhe Ministri i drejtësisë janë anëtarë të Këshillit gjyqësor sipas funksionit.

Përparim në këto ndryshime kushtetuese është ajo se shumica e anëtarëve të Këshillit gjyqësor (8 nga 15) zgjidhen nga vetë gjykatësit. Ky është një supozim për arritjen e pavarësisë politike të Këshillit gjyqësor

⁴ Në vitin 1990 policia tentoi të imponon vendim gjyqësor për bastisje nga ana e gjykatës në Kratovë. Të njëjtin vit policia thiri gjykatës në "biseda informative" për disa procedura gjyqësore. Kjo është drejtpërdrejt në kundërshtim me pavarësinë e gjyqësisë dhe të Kushtetutës dhe Ligjit për gjykatat (nenet 11, 14, 15 dhe 65), të cilët qartë ndalojnë çfarëdo shtypje ose ndikimi ndaj gjykatësve në punën e tyre.

dhe gjyqësisë në tërësi. Megjithatë, duke pasur parasysh traditat autoritare të RM-së, karakterin e kulturës politike dhe politizimin e madh në të gjitha sferat e jetesës, pjesëmarrja e Ministrit të drejtësisë në Këshillin gjyqësor në vete ngërthen rrezik të ndikimit politik nga bartës i funksionit të lartë në pushtetin ekzekutiv. Ajo çka paraqet problem në vendet me sistem të etabluar demokratik, mund në vete të bart rrezik nga shmangia e objektivave të deklaruara të refomës në vend, në të cilën akoma funksionojnë mjetet për kufizimin e pushtetit ekzekutiv. Baraspesha ndërmjet pushtetit gjyqësor dhe Këshillit gjyqësor me pushtetet tjera mundeshte pothuajse optimalisht të arrihet edhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të cilët i zgjedh Kuvendi i RM-së. Që deri dikund të amortizon ndikimin e Ministrit të drejtësisë dhe Kryetarit të Gjykatës supreme në Këshillin gjyqësor dhe veçanërisht që të zvogëlohet kumulimi i funksioneve në duart e Kryetarit të Gjykatës supreme, Ligji për Këshillin gjyqësor⁵ përmban dispozitë sipas së cilës Ministri i drejtësisë dhe Kryetari i Gjykatës supreme nuk mund të zgjidhen për Kryetar dhe zëvendës kryetar të Këshillit.

Kryetari i Këshillit gjyqësor zgjidhet nga rradhët e anëtarëve të Këshillit me shimicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me votim të fshehtë. Mandati i tij zgjat dy vite, pa të drejtë të rizgjedhjes. Këshilli në propozim të Kryetarit të Këshillit në seancën e njëjtë në të cilën zgjidhet edhe Kryetari, zgjedh edhe zëvendës i cilin e ndëron në mungesë të tij.

Ligji për Këshillin gjyqësor i RM-së e rregullon procedurën për zgjidhje të anëtarëve të Këshillit gjyqësor. Kryetari i Këshillit më së voni tre muaj para mbarimit të mandatit të Këshillit osë të anëtarë të Këshillit shpall konkurs për zgjidhje të anëtarit të Këshillit nga rradhët e gjykatësve. Ky konkurs shpallet në "Gazetën zyrtare të RM-së" dhe në së paku dy gazeta publike nga të cilat njëra në gjuhën shqipe. Në konkurs mund të paraqitet çdo gjykatës i cili në momentin e shpalljes ushtron funksionin gjyqësor; i cili ka së paku 5 vite stash gjyqësor dhe ka vlerësime positive për tre vitet e fundit gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor të dhëna nga Këshilli.

Në Ligjin për Këshill gjyqësor të RM-së është paraparë se gjatë zgjidhjes së anëtarëve të Këshillit gjyqësor nga rradhët e gjykatësve merret parasysh përfaqësimi i anëtarëve nga rajonet e të gjitha gjykatave të apelit, si dhe të Gjykatës supreme, për shkak të së cilës përgaditen listat e kandidatëve sipas njësive zgjedhore (lista për kandidatët nga

⁵ Ligji për Këshill gjyqësor i RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së Nr. 60/2006).

Gjykata supreme e RM-së, lista për kandidat nga rajoni i apelacionit në Shkup, Manastir, Gostivar dhe Shtip). Poashtu, gjatë përbërjes së Këshillit gjyqësor mbahet llogari edhe për përfaqësimin e drejtë të komuniteteve pakicë, për këtë arsye tre anëtarë zgjidhen nga lista e posaçme e kandidatëve nga gjykatësit e përkatësive të të gjitha komuniteteve të cilat nuk janë shumicë në RM për të gjithë territorin e vendit.

Zgjidhja për anëtarë të Këshillit nga rradhët e gjykatësve bëhet të njëjtën ditë në të gjitha gjykatat në RM. I zgjedhur llogaritet kandidati që ka fituar më shumë vota nga njësitë zgjedhore. Nëse më tepër kandidatë kanë fituar numër të njëjtë votash nga një listë zgjedhore, zgjedhjet për këto kandidatë përsëriten në afat prej 8 ditëve nga dita e votimit.

Për sa i përket anëtarëve tjerë të Këshillit, në Ligjin për Këshillin gjyqësor të RM-së ekziston një dispozitë sipas së cilës seanca e Kuvendit në të cilën zgjidhen anëtarët do të mbahet më së voni 30 ditë nga zgjidhja e anëtarëve për Këshill që zgjidhet nga ana e të gjithë gjykatësve.

3. Ndërprerja e mandatit të anëtarëve të Këshillit gjyqësor

Bazat për ndërprejen e mandatit të anëtarëve të Këshillit gjyqësor nuk janë rregulluar në Kushtetutë, përkatësisht në amandamentet kushtetuese, por ajo është lënë të bëhet me ligj që ka të bëjë me shumicën relative në Kuvend (së paku 40 vota). Kjo paraqet mungesë serioze në amandamentet kushtetuese të vitit 2005. Garanca kushtetuese e bazave për ndërprerje të mandatit të anëtarëve të Këshillit gjyqësor është një nga garancat themelore për pavarësinë e tyre nga pushteti politik. Amandamentet kushtetuese e lënë që kjo të rregullohet me ligj, dhe jepet mundësi për pasiguri në mandatin gjashtëvjeçar të anëtarëve të Këshillit gjyqësor, dhe me vetë këtë edhe një mundësi për ndikim politik ndaj tyre dhe ndaj gjyqësisë.

Sipas Ligjit për Këshill gjyqësor të RM-së, anëtarit të Këshillit i ndërpritet mandati: me kalimin e kohës për të cilën është zgjedhur; me këkesën e tij; me plotësimin e kushteve për pension; nëse është gjykuar me vendim të plotëfuqishëm për vepër penale me dënim të pakusht me burg së paku 6 muaj ose ka kryer vepër penale që e bën jodinjitoz për të ushtruar funksionin anëtar i Këshillit; nëse vërtetohet paaftësia e plotë për ushtrimin e funksionit dhe nëse është zgjedhur në funksion tjetër publik ose profesion.

Varësisht nga ajo se kush i zgjedh anëtarët e Këshillit gjyqësor (Kuvendi apo gjykatësit) ekzistojnë dallime rreth asaj se kush e miraton

dorëheqjen e anëtarit të Këshillit (Kuvendi apo Këshilli) dhe kush e përcakton paaftësinë e plotë për ushtrimin e funksionit (Kuvendi apo Këshilli).

4. Kompetencat e Këshillit gjyqësor të RM-së

Me amandamentet e reja kushtetuese është ndëruar edhe mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit të gjykatësve, ashtu që kjo tani është marrë nga kompetenca e Kuvendit dhe i është dhënë Këshillit gjyqësor. Me këtë RM iu bashkua grupit të vendeve në të cilat zgjedhja e gjykatësve është plotësisht në sferën e këtij organi, që në vete mban një rrezik tjetër, rrezikun nga korrupsioni i cili nuk mundej të mënjanohet në vendet me model të këtillë të zgjidhjes së gjykatësve dhe sistem të ngjashëm me sistemin politik maqedonas (psh., sistemi Bullgar). Transparenca në punën e Këshillit gjyqësor sigurohet përmes raportit vjetor të cilin e dorëzon deri të Kuvendi i RM-së. Rë raport përfshihen të dhëna për numrin e gjykatësve të zgjedhur dhe të shkarkuar dhe gjykatësve porota, për numrin e procedurave të ngritura dhe të mbaruara disiplinore, si dhe për më tepër aspektë tjera të punës së gjyqësisë (gjendja kadrovike, materiale-finansiare, bashkëpunimi me organet tjera, kualiteti dhe azhuriteti etj). Ligji për Këshillin gjyqësor të RM-së përmban dispozitë se Kuvendi i RM-së e miraton raportin e Këshillit gjyqësor me shumicë 2/3, ndërsa nëse nuk e miraton kjo do të ishte bazë për ngritjen e debatit përpara organeve që i kanë zgjedhur anëtarët e Këshillit gjyqësor për vlerësim të punës së tyre. Kjo dispozitë në praktikë nënkupton vetëm hapjen e debatit në Kuvend, pa rezultate konkrete nga ky debat, pasi që në ligj nuk është paraparë mundësia për ndonjëfarë përgjëgjësie të anëtarëve të Këshillit gjyqësor.

Ligji, poashtu parasheh se seancat e Këshillit janë publike dhe publiku mund të përjashtohet vetëm me vendim gjyqësor të Këshillit, të sjellur me 2/3 e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, për shkak të mbrojtjes së dinjitetit dhe integritetit të gjykatësit ose kandidatit për gjykatës.

Procedura për zgjidhjen e gjykatësve fillon me shpalljen e konkursit për gjykatës. Këshilli gjyqësor zgjedh gjykatës të gjykatës themelore nga lista e kandidatëve e dorëzuar nga Akademia për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve publik që janë paraqitur në konkurs. Praktikisht, vendimi i Këshillit gjyqësor për emërim të gjykatësit në gjykatë themelore është determinuar nga lista e kandidatëve dorëzuar nga Akademia për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve publik. Nga

këtu, duke pasur parasysh përbërjen e organeve të Akademisë, si dhe procedurën për emërim të gjykatësve mund të potencohet së ekziston rrezik nga krijimi i oligarkisë gjyqësore, e cila poashtu është e rrezikshme për gjyqësinë, aq sa edhe politizimi i saj.

Në Ligjin për Këshillin gjyqësor të RM-së është përcaktuar se nëse kandidati nga lista e propozuar e Akademisë, nuk paraqitet në tre konkurse të njëpasnjëshme për gjykatës, e humb prioritetin nga lista e kandidatëve të Akademisë. Në këtë mënyrë, kandidatët janë të detyruar që të paraqiten në konkurse për zgjidhje të gjykatësit edhe në vende të cilat janë jashta vendit të tyre të jetesës, vetëm për të mos e humbur prioritetin e listës.

Përveç emërimit dhe shkarkimit të gjykatësve, Këshilli gjyqësor ushtron edhe funksione tjera siç janë: i emëron dhe shkarkon kryetarët e gjykatave; përcakton ndërprerjen e funksionit porotë; ndjek dhe vlerëson punën e gjykatësve; vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve; vepron në bazë të ankesave të qytetarëve dhe personave juridik për punën e gjykatësve dhe gjykatave etj.⁶

Duke pasur parasysh atë që ndryshimet kushtetuese jo vetëm përgjegjësia disiplinore, por edhe shkarkimi i gjykatësve është vënë në kompetencë të Këshillit gjyqësor, Ligji parasheh mundësinë për ankesë në bazë të vendimeve të Këshillit gjyqësor për shkarkim ose masën e shqiptuar disiplinore. Pra, kundër këtyre vendimeve gjykatësi ka të drejtë në ankesë përpara Këshillit për vendosjen në bazë të ankesave të Këshillit gjyqësor të formuar në Gjykatën supreme të RM-së. Këshilli për vendosjen në bazë të ankesës përbëhet nga 9 anëtarë nga të cilët: tre gjykatës nga Gjykata supreme (mirëpo, jo edhe Kryetari i Gjykatës supreme), katër gjykatës nga gjykatat e apelit dhe dy gjykatës nga gjykata e cila është gjykatësi kundër të cilit e ngritur procedura. Krejt kjo procedurë del nga rregulla se çdoherë organi më i lartë vendos për ankesën ndaj vendimit të organit më të ulët. Për këtë arsye nuk është logjike për ankesat ndaj vendimeve të Këshillit gjyqësor të vendosin persona të cilët zgjidhen dhe shkarkohen në këtë rrugë gjyqësore dhe përgjigjen përpara tij.

⁶ Neni 31 nga Ligji për Këshillin gjyqësor të RM-së është shembull për nomoteknikën karatsrofale. Në të janë numëruar kompetencat e sistemit gjyqësor, gjatë së cilës janë potencuar kompetenca të caktuara, ndërsa nga ato janë nxjerë disa lloje të nënkompetencave. Psh., si kompetenca janë numëruar: ndërprerja e funksionit gjyqësor, për shkak të paaftësisë së përhershme për punë të gjykatësit. Shembull tjetër në al. 8 shprehet se Këshilli gjyqësor vendos për marrjen e imunitetit të gjykatësit, ndërsa në alinenë tjetër shënohet se vendos në bazë të kërkesës për paraburgim të gjykatësit, që nënkupton një lloj imuniteti të gjykatësit.

Përfundim

S'ka dyshim se reforma dhe modernizimi i sistemit gjyqësor në RM është një nga çështjet më të rëndësishme të cilës duhet ti përkushtohet vëmendje.

Praktika dëshmoi se vetëm ligjet, veçanërisht gjatë periudhës së tranzicionit nuk mund të sigurojnë pavarësinë gjyqësore, të cilët janë akoma nën ndikim të partive politike në pushtet. Prandaj, ndryshimet dhe kushtetuese dhe ligjore mund të jenë vetëm pikënisje në sigurimin e pavarësisë së gjykatësve nga: pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv, nga menaxhmenti gjyqësor dhe nga grupe shoqërore formale (siç janë partitë politike, mediat etj).

Përparim më i rëndësishëm në ndryshimet kushtetuese dhe ligjore në fushën e gjyqësisë është themelimi i Këshillit gjyqësor si organ në përbërjen e të cilit dominojnë anëtarë të zgjedhur nga radhët e gjykatësve dhe nga vetë gjykatësit. Me këtë përmirësohet pozicioni i gjyqësisë në sigurimin e pavarësisë së saj nga faktorët politik. Mirëpo, mënyra sipas së cilës zgjidhen gjykatësit, veçanërisht roli i Akademisë për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve publik në zgjidhjen e gjykatësve për gjykata themelore, bartin rrezikun nga krijimi i oligarkisë gjyqësore, ndërsa me të edhe paraqitjen e korrupsionit. Ajo është një nga mangësitë themelore të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore në fushën e gjyqësisë. Transparenca dhe arsyeshmëria e vendimit për zgjedhje të gjykatësit nga ana e Këshillit gjyqësor poashtu nuk janë në nivel të mjaftueshëm të siguruara dhe garantuara. Mangësi e rëndësishme është edhe ajo se kushtetuta nuk i përcakton bazat për ndërprerje të funksionit anëtar i Këshillit gjyqësor, por atë e lë të rregullohet me ligj.

Ligji për Këshill gjyqësor përmban edhe disa zgjidhje jologjike. Procedura në bazë të ankesës kundër vendimit të Këshillit gjyqësor për shkarkim ose përgjegjësi disiplinore të gjykatësit; procedura për miratimin e raportit të Këshillit gjyqësor në Kuvendin e RM-së dhe pasojat nga mosmiratimi i tij; arsyet për humbjen e prioritetit të listës së kandidatëve për gjykatës e formuluar nga Akademia për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve, janë vetëm disa nga ato mangësi.

Megjithatë, edhe sikur të ishte krijuar kornizë më e mirë kushtetuese dhe ligjore për pavarësi të gjyqësisë, ajo nuk do të ishte dhe nuk është e mjaftueshme për arritjen e pavarësisë së saj. Për të pasur sukses reformat në gjyqësi është e nevojshme ndërtimi i shtetit ligjor, sundimi i së drejtës dhe konstitucionalizmi në të cilën gjyqësia do të jetë rojtar i vërtetë i të drejtave të njeriut dhe mjet për kufizimin e pushtetit.

JUDICIAL COUNCIL OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA AND THE INDEPENDENCE OF THE JUDICIARY

(Resume)

This article deals with the constitutional and legal changes in the composition, position, election and competence of the Judicial council of the Republic of Macedonia. The author points the weaknesses of the previous concept of the Republican judicial council and the reasons for the changes.

In this article the author explains positive changes that were made with the constitutional amendments and the Law on Judicial council of the Republic of Macedonia, but also points the weak points and unlogical aspects of some of the new solutions.

The author suggests that if better legal norms were adopted, the independence of the judiciary would have been easier established; as well as that the legal changes are only the first step for obtaining that goal.

Maqedonia ndërmjet integritimeve dhe veto-s

(Abstrakt)

Në procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe NATO-s të dukshme janë më tepër elemente të cilat pohojnë në shfrytëzimin e disa parimeve të cilat i përcaktojnë rezultatet e tërë procesit. Parimi i kushtëzimit, koncepti i “kapacitetit absorbues”, si dhe grupimi i shteteve gjatë afrimit të tyre në BE janë vetëm ojesë e tyre. Politika e kushtëzimit të BE-së dhe NATO-s ndaj shteteve të Ballkanit perëndimor mbijetoi humbje serioze në samitin e NATO-s në Bukuresht. Edhe pse ishin plotësuar të gjithë kriteret, Republika e Maqedonisë nuk e fitoi ftesën e merituar, me çka motivimi dhe qëllimi i saj dhe shteteve tjera edhe mëtej vazhdojnë me reformat është vënë në pikëpyetje. Përfshirja e bërë me (keq)përdorimin e veto-s tani më pasqyrohet edhe në BE, ku çështjet bilaterale vihen si pengesë për integritet të disa shteteve-kandidate. Paralajmërimet për tentime për reforma në sistemin e pranimit të anëtarëve të rinj të NATO-s është akoma një tregues për nevojën për ballafaqim me rrezikun për bllokim unilateral të anëtarësimit të shteteve të Ballkanit perëndimor, që akoma më tepër do vijë në shprehje gjatë zgjerimit të mëtejshëm të BE-së dhe NATO-s. Konflikti i interesave nacionale të një shteti-anëtar me interesat kolektive të këtyre dy strukturave ndërkombëtare kanos që të dëmton imazhin e tyre në rajonin ballkanik akoma të brishtë, të cilit i nevojitet edhe integritet efektiv.

Integriteti euro-atlantik pa dyshim paraqet lëvizje më të fuqishme të proceseve reformuese në rajonin e Ballkanit perëndimor. Nga fillimi i tranzicionit ekonomik dhe politik, shoqërimi drejt BE-së dhe aleancës veri-atlantike është vënë në krye të prioritetëve në politikën e jashtme të shteteve nga kjo pjesë e Evropës. Pas hapjes së detyrës të BE-së për shtetet nga Evropa Qendrore dhe Veriore, shtetet ballkanike fuqimisht iu drejtuan në ndërmarrjen e hapave të nevojshme për hyrje në BE.

¹ Ligjërues pranë New York University – Shkup

Shtetet mund që të aplikojnë apo jo, mirëpo BE ka mundësi të vogël përveç që të pranon kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e parapara. Përpara përcaktimit të kriterëve të Kopengagës, kusht për aderim në Komunitetet evropiane ishte që shteti të jetë nga Evropa, ndërsa i vetmi aplikacion i refuzuar deri më tani ishte ai i Marokut, me arsyetim se nuk bëhet fjalë për shtet evropian. Nëse i plotësojnë kriteret ekonomike dhe politike për anëtarësim, BE nuk ka bazë që të refuzon shtetet që janë evropiane, sipas kriterit gjeografik. Megjithatë, diskutimet se kufijtë e Evropës a janë apo jo gjeografike, kulturore civilizuese ose të llojit tjetër do të jenë në redn dite edhe në radhët e ardhshme të zgjërimeve.

Vështruar nga aspekti historik, procesi i integritetit sipas kohëzgjatjes ishte i ndryshëm në të gjitha radhët. Më shumë zgjatën negociatat për aderimin e Portugalisë dhe Spanjës – më se 6 vjet, ndërsa më të shkurtëra ishin ato me Austrinë, Suedinë dhe Finlandën – vetëm 13 muaj. Finlanda është edhe shteti i cili më së shpejti iu bashkangjiti KE-ve – me vetëm dy vite e tetë muaj nga dita e aplikimit deri në anëtarësim.

Tabela 1: Kohëzgjatja e procesit të integritit të shteteve të reja anëtare deri në vitin 1992

Shteti	Data e aplikimit	Kohëzgjatja e negociatave	Data e anëtarësimit	Periudha ndërmjet aplikimit dhe anëtarësimit
Britania e Madhe <i>(aplikimi i dytë)</i>	10.05.1967	19 muaj	1.01.1973	5 vite e 8 muaj
Danimarka	11.05.1967	19 muaj	1.01.1973	5 vite e 8 muaj
Irlanda	11.05.1967	19 muaj	1.01.1973	5 vite e 8 muaj
Greqia	12.06.1975	2 vite e 10 muaj	1.01.1981	5 vite e 6 muaj
Portugalia	28.03.1977	6 vite e 8 muaj	1.01.1986	8 vite e 9 muaj
Spanja	28.07.1977	6 vite e 4 muaj	1.01.1986	9 vite e 5 muaj
Austria	17.07.1989	13 muaj	1.01.1995	5 vite e 3 muaj
Suedia	01.07.1991	13 muaj	1.01.1995	3 vite e 4 muaj
Finlanda	18.03.1992	13 muaj	1.01.1995	2 vite e 8 muaj

Lidhur me shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore, procesi i shoqërimit nga aplikimi deri në anëtarësimin e plotë më së shumti ka zgjatur për Qipron dhe Maltën (14 vite), ndërsa më shkurt për Çekinë dhe Slloveninë (8 vite). Negociatat më shpejt i kanë mbaruar Sllovakia, Lituania dhe Letonia (3 vite e gjysëm), ndërsa në rastet tjera kanë zgjatur pesë vite.

Këshilli i ministrave të BE-së në takimin e mbajtur në qershor të vitit 1993 në Kopenhagë i përcaktoi të ashq. Kriteria të Kopenhagës të cila në vete përmbajnë kritere politike, ekonomike dhe kritere lidhur me legjislacionin. Në pjesën politike përfshihen standardet për: 1) demokracinë në vend – pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje, zgjedhjet e lira me votim të fshehtë, liria e shtypit etj; 2) Sundimi i së

drejtës – pushteti patjetërsisht të praktikohet vetëm në pajtueshmëri me ligjet e miratuara në procedurë të caktuar; 3) respektimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave – miratimi i parimeve të Deklaratës universale mbi të drejtat e njeriut e OKB-së dhe Konventës evropiane mbi të drejtat e njeriut, siç janë mbrojtja dhe respektimi i kulturës, gjuhës dhe identitetit të pakicave.

Kriteret ekonomike paraqesin aftësinë e vendit të ketë ekonomi funksionale të tregut dhe aftësi për tu përgaditur për shtypjet nga konkurrenca e fuqive të tregut të përbashkët të BE-së. lidhur me kriteret e legjislacionit, të gjitha shtetet që dëshirojnë ti bashkohen BE-së patjetër duhet të implementojnë të ashq. *acquis communautaire* – aktet juridike evropiane të sjellura në suaza të BE-së.²

Tabela 1: Kohëzgjatja e procesit të integritetit të shteteve të reja anëtare deri në vitin 2004

Shteti	Aplikimi	Mendimi i Komisionit	Fillimi i negociatave	Marrëveshje për aderim	Referendum	Anëtarësim
Qiproja	3.07.1990	30.06.1993	31.03.1998	16.04.2003	<i>Ne e odr`an</i>	1.05.2004
Malta	16.07.1990	30.06.1993	13.10.1999	16.04.2003	8.03.2003	1.05.2004
Hungaria	31.03.1994	16.07.1997	31.03.1998	16.04.2003	4.12.2003	1.05.2004
Polonia	4.05.1994	16.07.1997	31.03.1998	16.04.2003	7-8.06.2003	1.05.2004
Sllovakia	27.06.1995	16.07.1997	13.10.1999	16.04.2003	16-17.05.2003	1.05.2004
Letonia	13.10.1995	16.07.1997	13.10.1999	16.04.2003	20.09.2003	1.05.2004
Estonia	24.11.1995	16.07.1997	31.03.1998	16.04.2003	14.09.2003	1.05.2004
Lituanija	8.12.1995	16.07.1997	13.10.1999	16.04.2003	10-11.05.2003	1.05.2004
Çekia	17.01.1996	16.07.1997	31.03.1998	16.04.2003	13-14.06.2003	1.05.2004
Sllovenia	10.06.1996	16.07.1997	31.03.1998	16.04.2003	23.03.2003	1.05.2004

Bashkimi Evropian që nga fillimi i procesit të zgjerimit drejt shteteve të Evropës Qendore dhe Lindore filloi ta përdor të ashq. parim të kushtëzimit. Ndikimi i këtij parimi mund kjartë të shihet në rastin me


² Presidency Conclusions, Copenhagen European Council 1993

Sllovakinë. Kësisoj, rizgjedhja e premierit Vladimir Meçijar në vitin 1994 kontriboi për zvaritjen e procesit të shoqërimit të këtij vendi në BE. Edhe pse në mënyrë deklarative ai heqeveria e tij ishin shprehur për anëtarësim në BE, parime të dyshimta demokratike dhe shkalla e pamjaftueshme e sundimit të së drejtës, pavarësia e rrezikuar e mediave, mosrespektimi i vendimeve të Gjytaës kushtetuese dhe raste tjera ishin më se të mjaftueshme që vendi të anashkalohet gjatë fillimit të negociatave për anëtarësim në vitin 1997, kur ato ishin hapur vetëm për Çekinë.

Në raportin e Komisionit evropian ishte potencuar se Sllovakia i plotëson kriteret ekonomike dhe administrative, mirëpo nuk është në gjendje të fillon me negociatat për shkak të mosplotësimit të kriterëve lidhur me stabilitetin e institucioneve, respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e së drejtës. Në periudhën që pasoi përjashtimi i vendit nga negociatat për anëtarësim në BE dhe NATO u bë temë kryesore e politikës vendore dhe rezultoi me ndërimin e pushtetit në vitin 1998. Qeveria e re ishte përkrahur nga BE, mirëpo kushtet tjera që duheshin të plotësohen ishin kyçja e partive të pakices hungareze në qeveri dhe mbyllja e qendrës nukleare "Bohunic". Në vitin 1999 Sllovakia ishte thirrur për të filluar negociatat për anëtarësim së bashku me shtetet tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Parimi i dytë edhe pse joformal, ishte ai i krijimit të grupeve të shteteve të cilat bashkërisht do të avansojnë në rrugën drejt BE-së. Duke i analizuar raportet e Komisionit evropian për përparimin e shteteve nga Ballkani perëndimor, rezolutat e Parlamentit evropian si dhe partneritetet evropiane të realizuara nga Këshilli i ministrave, del se shtetet ballafaqohen me më tepër ose më pak problem të njëjta, të cilat ndryshme shprehen në çdo shtet. Përparimi drejt anëtarësimit në BE varet nga zgjidhja e këtyre çështjeve, ndërsa për disa nga to është qenësore zgjidhja e përbashkët, për shkak të natyrës së problemit dhe rrethanave në rajon (psh., kthimi i rrrefugjatëve, tregtia me njerëz, kriminaliteti i organizuar, përforcimi i bashkëpunimit rajonal tregtar etj).

Rrëfimi 1: Hapat e nevojshme për përparimin e shteteve nga Ballkani perëndimor drejt BE-së



Përpos kriterëve të përbashkëta për çdo shtet-aplikant ekzistojnë kushte të posaçme që janë të ndryshme për nga karakteri i tyre. Poashtu, në anën e kushteve të nevojshme është edhe kapaciteti absorbues i BE-së, përkatësisht aftësia që të pranohen anëtarë të rinj në familjen evropiane. Vënia e nocionit “kapacitet absorbues” dhe paralejmërimet se ngadalësimi ose ndërprerja e e plotë e zgjerimit ishin rezultat i më tepër momenteve: fillimi i negociatave me Kroacinë Turqinë në vitin 1995, ndarja e statusit kandidat për Maqedoninë, si dhe shterja eventuale e mundësive për funksionim të sistemit të BE-së pas pranimit të Bullgarisë dhe Rumanisë. Ndikimi i rasteve politike në shtete-anëtare të caktuara (Gjermanisë, Francës, Holandës), si dhe frika nga rrëmuja e migrantëve, posaçërisht ga Turqia poashtu kishin ndikim në përforcimin e qëndrimeve kundër pranimit të shteteve të reja anëtare. Është interesant

konstatimi se një funksionari evropian se “Problemi i vetëm që kemi me kapacitetin absorbues është problem mental”.³

Në këtë drejtim është edhe konstatimi se “BE i ngjan pronarit i cili nuk ka disponim që të mbindërton vendbanim të vetë komod për të pranuar familjarët e vet të vobegët”. Mund që ato të jenë të çuditshëm, të zëshëm apo të kenë shumë kërkesa? A mundet që mbindërtimi të rrezikon sigurinë e tërësishme? Shumë më lehtë është që të paramendohet rindërtim dhe rinovim i vendqëndrimit ekzistues sesa të fillohet me plane të reja.⁴ Kushtetuta ishte perceptuar si mjet me të cilin do të mundësohet zgjerimi i mëtejshëm, ndërsa tani lehtësimi i procesit lidhet me miratimin e Traktatit reformues. Reformimi i institucioneve dhe zgjerimi janë shprehje e të njëjtës “shtypje strukturore”,⁵ dhe janë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën.

Koncepti i “kapacitetit absorbues” është marrë nga kimia, ku ka të bëjë me kuantitetin dhe kualitetin e elementeve të reja të cilat mund të integrohen, në çfarëdo qoftë moment ose gjatë kohës në periudhë të caktuar, në system ekzistues ose prodhim, duke mos u vënë në pikëpyetje vetitë e tij, identitetin dhe kapacitetin që ti arrin objektivat e veta”, ndërsa shfrytëzohet edhe në studimet e mbrojtjes, ku ka të bëjë me “kapacitetin e individit që të mbijetojë zjarrin armiqësor dhe të mbrohet nga sulmet e kundërshtarit.”⁶

Megjithatë, duke njohur madhësinë dhe popullatën e shteteve-kandidate dhe kandidatëve potencial nga i ashq. Ballkan perendimor, absorbimi i tyre në BE nuk do të paraqet rrezik të veçantë për strukturën e saj institucionale dhe funksionimin. Në suaza të debatit për kapacitetin absorbues duhet përcaktuar kufirin e kuartë ndërmjet grupit të shteteve nga Evropa Jug-lindore (Kroacia, Maqedonia, Sërbija, Mali i Zi, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, dhe eventualisht Kosova) dhe grupa e shteteve “rëndë të ziera” (Turqia, Ukraina, Bjellorusia dhe Rusia). Grupi i dytë gjithësesi meriton trajtim më ndryshe, mirëpo jo edhe *a priori* përjashtim nga agjenda për anëtaresim. Kriteret e Kopenhagës nuk përmbajnë dispozita për madhësinë e shteteve që dëshirojnë të bëhen pjesë e BE-së,

³ “El Pais”, 16 June 2006, cituar në: Ren, Oli (2007) Slednite granici na Evropa (Skopje: Institut za ekonomski strategii i me|unarodni odnosi “Ohrid”)

⁴ Grabbe, Heather (2001) Profiting from EU Enlargement (London: Centre for European Reform)

⁵ Wiener, Antje (2002) Finality vs. Enlargement: Constitutive Practices and Opposing Rationales in the Reconstruction of Europe, Jean Monnet Working Paper 08/02. ⁵

⁶ Ren, Oli (2007) Slednite granici na Evropa, Skopje: Institut za ekonomski strategii i me|unarodni odnosi “Ohrid”)

për religjionin e tyre, kulturën ose të kaluarën ideologjike. Pengesë e vetme e kësaj për refuzimin e shtetit të caktuar është dispozita e nenit 49 të Marrëveshjes për BE, e cila potencon se “çdo shtet evropian që i respekton dispozitat e nenit 6(1) mund të aplikojë për anëtarësim” (primet e lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave njerëzore dhe lirisë themelore si dhe sundimi i së drejtës). Aplikacioni i vetëm i refuzuar deri më tani është ai i Marokut në vitin 1987, për shkak se shteti aplikant nuk është evropian. Megjithatë, edhe ky kriter gjeografik nuk është plotësisht i respektuar gjatë zgjërimeve të deritanishme. Kështu psh., Qiproja është vetëm 100 km larg Sirisë dhe Libanit, ndërsa 800 km nga Evropa kontinentale.

Në rastin e shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore, stabilizimi dhe “pika nga e cila nuk ka kthim”⁷ në procesin e integritetit evropian ishte arritur shumë shpejtë pas pavarësimit të tyre dhe demokratizimit. Për pjesë të shteteve në Ballkanin perëndimor ky stadium akoma nuk është arritur. Dallimi në mes Ballkanit perëndimor dhe shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore ka të bëjë me shkallën më të lartë heterogjene të popullatës, mirëpo edhe të politikës nacionaliste të pothuajse të gjithë liderëve nga rajoni. Rajoni ballkanik paraqet pjesë të pandashme nga hapësira e re evropiane dhe njëkohësisht ai është rajon më pak stabil dhe më pak i integruar në Evropë.

Pa dallim se a bëhet fjalë për anëtarësim në sindikat, parti politike ose në rast të strukturës supranacionale çdoherë ka disballans formal të fuqisë në mes atyre të cilët janë në klub dhe atyre të cilët deshirojnë që të shoqërohen.⁸ Pa dyshim, ekziston lidhje e kushtëzimit dhe procesit të zgjerimit. Zbatimi i njëjtë i kushteve për zgjerim të vendosura nga BE ndaj të gjitha shteteve aplikante shpesh herë është lëndë e kritikave, prandaj për to thuhet edhe se paraqesin “standard të dyfishta” të cilat duhet të plotësohen.⁹ Mirëpo, shtetet të cilat janë në listën e pritjes për anëtarësim në BE – ato nga Ballkani perëndimor – nuk kanë zgjidhje. Plotësimi i kriterëve për anëtarësim është pa alternativë. Konstatim interesant në këtë drejtim është edhe ai se “kur BE si entitet do të

⁷ Topan, Angelina (2001) *The European Integration Process: A Historical and Comparative Institutional Analysis* (Münster: Lit Verlag)

⁸ Walker, Neil (2003) *Constitutionalising Enlargement, Enlarging Constitutionalism*, *European Law Journal*, 9, 3.

⁹ Wiener, Antje (2002) *Finality vs. Enlargement: Constitutive Practices and Opposing Rationales in the Reconstruction of Europe*, Jean Monnet Working Paper 08/02.

aplikonte për anëtarësim vetë në vete, do të mund të ishte më pak e suksesshme se Turqia”.¹⁰

Politika e kushtëzimit të BE-së dhe NATO-s ndaj shteteve të Ballkanit perëndimor përjetoi dështim serioz në shtetin e NATO-s në Bukuresht. Edhe përpos plotësimit të të gjitha kriterëve, Republika e Maqedonisë nuk e mori ftesën e merituar, me çka motivimi dhe qëllimi i saj dhe shteteve tjera edhe mëtej të vazhdojnë me reformat është vënë në pyetje. Faza e njohur për “shkopin dhe karrotën” shton se nëse plotësohen të gjitha kriteret – fitohet shpërblimi (“karrota”). Nëse nuk do të lëvizim përpara – nga prapa është dënimi (“shkopi”). Beneficionet janë pasqyrim i anëtarësimit në NATO dhe BE, ndërsa dënimi do të ishte izolimi dhe sanksionet ekonomike dhe politike.

Në samitin e NATO-s ishte vërtetuar se RM i plotësoi të gjitha kriteret e nevojshme, edhe ato politike, edhe ato nga fusha e mbrojtjes. E gjithë kjo ishte rezultat i reformave të cilat jo çdoherë ishin mire të pranuar nga qytetarët, mirëpo kaluan në faleminderim të besimit të tyre se të gjitha hapat janë të nevojshme për tu arritur deri te anëtarësimi në NATO. Paramendimi se pas të gjitha reformave shteti do të kyçet në strukturën e sigurisë kishte prioritet më të madh.

Megjithatë, pas samitit u pa se shpërblimi mbeti i paaritshëm. Pothuajse nuk është e drejtë të besohet se pas një rezultati të këtillë – qytetarët edhe mëtej do të japin përkrahjen e reformave të cilat bëhen për plotësimin e ndonjëfarë kriteri. Përvoja është se – edhe përpos kriterëve të plotësuar – jo çdoherë fitohet e merituar. Ky sinjal negativ dërgohet edhe te shtetet tjera të rajonit, të cilat poashtu duhet të realizojë reformat për plotësimin e kriterëve të njëjta. Shembulli me Maqedoninë i dekurajon të gjitha ata dhe e vë nën dyshim përparimin e tërësishëm të rajonit ndaj Evropës.

(Këq)përdorimi i të drejtës së veto-s tanimë pasqyrohet edhe në BE, ku çështjet bilaterale parashtrihen si pengesë për integrim të disa shteteve-anëtare. Bllokimi i negociatave me të cilat u ballafaqua Kroacia është rezultat i kësaj situatë. Nëse Greqisë nuk i lejohej të bllokonte ftesën për Maqedoninë për në NATO – ndoshta çdo shtet-anëtar i NATO-s dhe BE-së do të përmbahej nga një hap i ngjashëm. Megjithatë, mundësitë për pengim unilateral të zgjerimit mbeten karta e cila mund të përdoret edhe në të ardhmen.

¹⁰ Joerges, Christian (2002) ‘Deliberative Supranationalism’ – Two Defences, European Law Journal, 8, 1.

Paralajmërimet për tentime për reform në sistemin e panimit të anëtarëve të rinj në NATO është edhe një tregues për nevojën e ballafaqimit me rrezikun për bllokim të njëanshëm të anëtarësimit të shteteve nga Ballkani perëndimor, që akoma do të vijë në shprehje gjatë zgjerimit të ardhshëm të BE-së dhe NATO-s. Në një situatë të paramenduar, çdo shtet nga ish Jugosllavia do të në mundësi të bllokoi shtetin tjetër nga i njëjti rajon. Kështu, përveç kontestit aktual të Sllovenisë me Kroacinë, në të ardhmen Kroacia do të kishte bllokuar Sërbinë, ndërsa Serbia do të kundërshtojë pranimin të Malit të Zi, Kosovës ose Bosnjë e Hercegovinës. Me këtë hapet në rreth magjik i bllokimit të ndërsjelltë, që gjithësesi nuk do të përshtatet në sistemin e tolerancës dhe bashkëpunimit që mbizotëron në BE dhe NATO.

Ndeshja e interesave nacionale të një shteti-anëtar me interesat kolektive të këtyre dy strukturave ndërkombëtare rrezikon të dëmtojë imazhin e tyre në akoma rajonin e thyeshëm ballkanik, të cilit i nevojitet integrim i shpejtë dhe efektiv. Pa marrë parasysh gjithë këtë, Maqedonia duhet të drejtojë të gjitha kapacitetet e disponueshme për afrim të shtetit drejt BE-së, dhe pa fillim formal të negociatave për anëtarësim. Në këtë mënyrë, pasi të fillojnë negociatat – të njëjtat mund të mbarojnë shumë më herët, pasi që pjesa më e madhe e çështjeve do të jenë zgjidhur. Koha e humbur në periudhë kur shteti është përgaditur – mirëpo nuk negociohet, mund të kompenzohet në periudhë të negociatave të përshpejtuar. Ndoshta kohëzgjatja e negociatave me shtetet e EFTA-s janë të paaritshme, megjithatë nuk është e pabesueshme se ato mund të skurtohen në dy deri tre vjet. Fillimi i prituri i negociatave në vitin 2008 ndoshta do të nënkuptonte 4-6 vite negociata, me çka shteti do të bëhej pjesë e BE-së deri në vitin 2014. Tani, nëse negociatat fillojnë në vitin 2010 apo 2011 dhe zgjatin dy ose tre vite, objektivi përfundimtar përsëri do të ishte realizuar.

Realiteti dhe sfidat e Republikës së Maqedonisë në fushën e politikës sociale

Hyrje

Përveç reformave në administratën publike, sistemin gjyqësor dhe sferat tjera të jetës shoqërore, integrimi i Republikës së Maqedonisë në Bashkimin European kërkon një sërë reformash në sistemin nacional edhe në sferën sociale. Me ndihmën e reformave në sferën sociale do të përmirësohet baza juridike për përmirësimin e standardit jetësor të popullatës në RM.

Legjislacioni i RM-së në sferën sociale filloi të harmonizohet me atë të BE-së që nga nënshkrimi i Marrëveshjes për stabilizim dhe asocim. Në pajtueshmëri me dispozitat e Marrëveshjes për stabilizim dhe asocim me BE-në, legjislacioni i RM-së ka intencë të reformohet dhe harmonizohet konform standardeve sociale të BE-së. Ndër burimet kryesore të legjislacionit social në RM, mund t'i numërojmë: Kushtetutën (nenet 32-42), ligjet, marrëveshjet ndërkombëtare dhe Konventat e ONP-së, rregulloret, kontratat kolektive, aktet e punëdhënësve dhe kontratat e punës.

Poashtu, vend të rëndësishëm kanë edhe rregulloret e Qeverisë së RM-së dhe aktet nënligjore të cilat i miratojnë: Agjensioni për nëpunës shtetëror, organet e administratës shetërore dhe organet tjera shtetërore; me të cilat përpunohen dispozitat të caktuara të ligjeve me qëllim të implementimit efikas të tyre.

Në veçanti vlen t'i përmendim disa nga çështjet kyçe të politikës sociale dhe të drejtave sociale të implementuara në legjislacionin e RM-së, në pajtueshmëri me frymën e proceseve euro-integruese, veçanërisht: politikën e punësimit, trajtimin e barabartë, jodiskriminimin, dialogun social, sigurimin social dhe mbrojtjen sociale, mbrojtjen gjatë punës, të drejtat që dalin nga marrëdhënia e punës etj.

¹ Ligjërues pranë Fakultetit të Administrimit Publik dhe Shkencave Politike, UEJL

1. Politika e punësimit

Karakteristikë kryesore e tregut të punës në RM është niveli i lartë i papunësisë dhe problemet e shumta lidhur me ofertën e fuqisë punëtore, nga njëra anë dhe mundësitë e zvogëluara për punësimin e saj nga ana tjetër. Situata e pavoritshme në tregun e punës lind jo vetëm nga përmasat e papunësisë, por edhe nga kualiteti i potencialit të disponueshëm që është jashtë aktivitetit ekonomik. Struktura e të papunëve sipas nivelit të përgaditjes profesionale në pjesën më të madhe është e pakualifikuar, ndërsa pjesa tjetër disponojnë me profesione të cilat nuk përputhen me kërkesat e tregut të punës. Papunësia i përfshin të gjitha kategoritë e personave, pa marrë parasysh moshën, ndërsa në veçanti i prek të rinjtë me arsim të lartë.

Si rezultat i papunësisë permanente, rritet edhe shkalla e varfërisë. Arsytet e këtyre situatave të pavoritshme në tregun e punës duhet të kërkojnë në faktorët politik, ekonomik, social dhe teknologjik, duke u nisur nga periudha e tranzicionit dhe transformimit të shoqërisë.

Papunësia, sot paraqet një ndër problemet më të ndjeshme me implikime dhe pasoja të shumta, të cilat manifestohen në më tepër sfera. RM-ja ka papunësi të madhe që nga fillimi i tranzicionit dhe situata në vend përshkruhet me nivel të lartë të papunësisë afatgjate (35%). Mirëpo, mosekzistimi i statistikave të sigurta lidhur me “ekominë e zezë” dhe paraqitja e të papunëve vetëm për të pasur qasje në sigurimin shëndetësor, paraqet pengesë serioze për vlerësimin e tregut të punës. Prandaj, duhet të ndërmeren hapa serioze në përgaditjen e bazës institucionale dhe ligjore për investime të jashtme, nxitjen e afarizmit, përkrahjen e ndërmarjeve të vogla dhe të mesme, stimulimin e vetëpunësimit, biznesit të vogël dhe atij familjar.

Duke ndjekur përvojën që del nga “Metoda e hapur e bashkëpunimit” midis shteteve-anëtare të BE-së, mund të thuhet se RM-ja pjesërisht i realizon Rekomandimet, Udhërfyesit dhe Qëndrimet e përbashkëta në këtë drejtim.

Në sektorin për mbrojtje sociale, pranë Ministrisë së Punës dhe politikës sociale të RM-së është themeluar Zyrë për mbrojtje dhe përkujdesje të fëmijëve në rrugë, viktimave të dhunës familjare, shfrytëzuesve të drogës dhe personave me nevoja të posaçme. Me venien e Regjistrimit të OJQ-ve në sferën e mbrojtjes sociale, mundësohet kyçja e

shoqatave qytetare në programet për ballafaqimin dhe përjashtimin social.²

Zvogëlimi i rreziqeve nga përjashtimi social, realizohet edhe përmes formimit të formave jashtëinstitucionale për mbrojtje sociale dhe ndihmë të grupeve të ndjeshme, me çka zvogëlohet rreziku nga institucionalizimi. Në këtë drejtim janë hapur: 17 Qendra për fëmijë me pengesa intelektuale, 2 Qendra ditore për fëmijët në rrugë dhe 1 Qendër private për trajtimin e njerëzve pa shtëpi.³

RM nuk ka strategji për punësim, e cila përfshin spektër të gjërë të masave dhe fushave të intervenimit lidhur me punësimin në tregun e punës. Pjesa më e madhe e masave dhe aktiviteteve në këtë sferë kishte të bëjnë me politikën e tregut të punës, konkretisht vëmendja ishte përqëndruar në ndryshimin e legjislacionit të punës.

Vlen të përmendet se në RM nuk ekziston Fond social i ngjashëm si Fondi social Evropian.

Papunësia edhe më tej është e madhe dhe duke marrë pasur parasysh sfidat në këtë sferë, duhet të ndërmeren aktivitete plotësuese.

2. Trajtimi i barabartë dhe jodiskriminimi

RM-ja si shtet kandidat për anëtarësim në BE i ka implementuar dispozitat e direktivave të BE-së për barazi në Ligjin për mundësi të barabarta të burrave dhe grave (Gazeta zyrtare e RM-së, Nr. 66/06, 29.5.2006), i cili ndër të tjerat parasheh masa themelore dhe masa të veçanta për vënien e mundësive të barabarta.

Ky ligj parasheh edhe procedurë për mbrojtjen e mundësive të barabarta gjinore. Procedura e trajtimit të njëjtë inicohet nga individë dhe shoqata të qytetarëve, ndërsa udhëhiqet nga Ministria e punës dhe politikës sociale, gjegjësisht nga Përfaqësues-person i punësuar si nëpunës shtetëror në këtë Ministri, i angazhuar për mbajtjen e procedurave për përcaktimin e trajtimit jo të barabartë të burrave dhe grave.

² Për zhvillimin e marrëdhënieve të partneritetit me shoqatat joqeveritare dhe institucioneve private, Ministria e punës dhe politikës sociale themeloi Zyrë për institucionet publike dhe private përmes së cilës gjatë vitit 2006 u realizua bashkëpunim me 2 organizata joqeveritare për: SOS linja nacionale për viktimat e dhunës familjare dhe SOS linjë për ndihmë lidhur me problemet e drogës.

³ Qeveria e RM-së, Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së, Shkup 2007, f.202.

Barazia gjinore është e garantuar edhe gjatë shpalljes së vendeve të lira të punës. Kështu, sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e punës, punëdhënësi nuk guxon vendin e lirë të punës ta shpall vetëm për burra ose vetëm për gra, ndërsa përjashtim nga ky rregull ekziston vetëm nëse gjinia e caktuar paraqet kusht të domosdoshëm për ushtrimin e punës. Gjatë shpalljes së vendit të lirë të punës nuk duhet të sugjerohet se punëdhënësi jep përparësi punësimit të gjinisë së caktuar (neni 24).

Legjislacioni i RM-së e garanton edhe parimin e barazisë së rrogave për punë të njëjtë të burrave dhe grave. Ligji mbi marrëdhëniet e punës e garanton të drejtën e punëtorit, i cili punon të njëjtën punë me kërkesa të njëjta në vendin e punës, të pranon pagë të njëjtë pa marrë parasysh gjininë, ndërsa dispozitat e kontratës për punësim, kontratës kolektive, gjegjësisht aktit të përgjithshëm të punëdhënësit, të cilët janë në kundërshtim me këtë i llogarit si të pavlefshme (neni 108). Mirëpo, dallime në rroga ekzistojnë rreptësisht vetëm për shkak të dallimeve në punët të cilat në të shumtën e rasteve i ushtrojnë burrat dhe në të shumtën e rasteve i ushtrojnë gratë dhe nuk kanë të bëjnë me dallimet gjinore.

Me qëllim të implementimit sa më të mirë të kornizës ligjore lidhur me barazinë gjinore dhe trajtimin e njëjtë, me vendim të Qeverisë së RM-së, në janar të vitit 1997 është themeluar *Zyrë për avansimin e barazisë gjinore* (në suaza të Ministrisë për punë dhe politikë sociale), ndërsa në suaza të Parlamentit të RM-së, është formuar *Komision për mundësi të barabarta të grave dhe burrave*.

Në RM, ndalimi i diskriminimit parashihet me dispozitat e nenit 6 (1) të Ligjit mbi marrëdhëniet e punës, i cili ndër të tjerat pohon se ...punëdhënësi nuk duhet që kandidatin për punësim ose punëtorin t'a ven në pozitë jo të barabartë për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, moshës, gjendjes shëndetësore ose invaliditetit, bindjes religjioze ose asaj politike, anëtarësimi në sindikat, prejardhjes sociale ose asaj nacionale, statusit familjar, gjendjes pronësore, orientimit seksual, ose për shkak të rrethanave tjera personale. I njëjti ligj, në nenin 7 e definon diskriminimin direkt dhe atë indirekt në frymën e direktivave të BE-së.⁴

4

Diskriminim indirekt paraqet çdo veprim i kushtëzuar nga dallimet e përmendura në nenin 6, me të cilin personi është vënë, vihet apo mund të vihet në pozitë më të pavolitshme sesa personat tjerë në raste të caktuara; ndërsa diskriminimi indirekt ekziston kur dispozita që duket neutrale, kriteret apo praksat e vënë personin në pozitë më të pavolitshme në krahasim me personat tjerë-kandidat për punësim ose punëtor për shkak të cilësisë së caktuar, statusit dhe dallimeve tjera të caktuara në nenin 6. Diskriminimi është i ndaluar lidhur me: kushtet për punësim, avansimin në punë, qasjen në të gjitha nivelet e trajnimit profesional dhe rikualifikimit, kushtet e punës dhe për të gjitha të drejtat që dalin nga marrëdhënia e punës, aftësimi, arsimimi, rikualifikimi, pagat, shpërblimet, mungesat në punë, orarin e punës.

Sipas vlerësimit të Komisionit Evropian, në sferën e jodiskriminimit dhe mundësive të barabarta ekzistojnë disa dispozita ligjore kundër diskriminimit, të cilat përfshijnë gjininë, racën dhe religjionin. Masat nacionale në këtë drejtim nuk janë gjithëpërfshirëse, prandaj kërkohet të ndërmeren hapa të mëtejshme për implementimin e plotë të legjislacionit të BE-së. Komisioni Evropian vlerëson se është bërë hap i dukshëm në avansimin e mundësive të barabarta, pasi që me kornizën e re ligjore përmirësohen mekanizmat institucional për mundësi të barabarta përmes themelimit të Zyrës për mundësi të barabarta (pranë Ministrisë për punë dhe politikë sociale) dhe përmes detyrimit të autoriteteve lokale që të formojnë Komitete për mundësi të barabarta dhe të emërojnë Koordinator për mundësi të barabarta. Është bërë përpunim në më tepër fusha, përfshirë edhe arsimin, mbrojtjen sociale, pjesëmarrjen politike të sektorit joqeveritar, mirëpo ekziston akoma nevoja për aktivitete plotësuese lidhur me punësimin, gjendjen e grave në vendet rurale, gjendjen e grave të pakicave nacionale, dhunën dhe tregtinë me gra, si dhe implementimin e dispozitave të legjislacionit që kanë të bëjnë me jodiskriminimin në të gjitha sferat e jetës shoqërore.⁵

3. Dialogu social

Në RM ekziston edhe mekanizmi i dialogut social, funksioni i të cilit bazohet në Konventen e ONP-së për lirinë e shoqërimit dhe mbrojtjes së të drejtës së organizimit (Nr.87), Konventën e ONP-së për të drejtën e organizimit kolektiv (Nr.98) si dhe Kushtetutën e RM-së dhe Ligjin mbi marrëdhëniet e punës (nenet 203-235).

Në vitin 1966, Qeveria e RM-së, organizata e sindikatave të RM-së dhe Dhoma ekonomike nënshkruan marrëveshje të posaçme për formimin e Këshillit ekonomiko-social (kompetencat e tij përcaktohen me nenin 246 të Ligjit mbi marrëdhëniet e punës). Këshilli ekonomik dhe social vepron si trup këshillues trepalësh dhe përbëhet nga përfaqësuesit e tre partnerëve social (Qeverisë, përfaqësuesve të punëtorëve dhe përfaqësuesve të punëdhënësve), të cilët i shqyrtojnë çështjet ekonomike dhe sociale dhe i harmonizojnë interesat e tyre lidhur me politikën

⁵ Raporti analitik për opinionin lidhur me kërkesën e RM-së për anëtarësim në BE, COM (2005), Bruksel 1425, f.118-122.

ekonomike dhe masat për stabilitet ekonomik dhe social, politikën e çmimeve dhe rrogave, sigurinë sociale, standardin jetësor, kushtet e punës dhe mbrojtjen gjatë punës, mbrojtjen shëndetësore, sigurimin pensional dhe invalidor, mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve etj.

Ekzistojnë dy kontrata kolektive nacionale (njëra me Qeverinë dhe tjetra me Dhomën ekonomike) dhe 31 marrëveshje të degëve, me të cilat përfshihen gati se të gjitha sferat në sektorin publik dhe atë privat. Mirëpo, pasiqë dispozitat e këtyre marrëveshjeve nuk respektohen sistematikisht, ato akoma nuk u treguan të suksesshme në pengimin e konflikteve të punës.

Në sferën e dialogut social, përparimi është i kufizuar, pasiqë 6 muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit mbi marrëdhëniet e punës, nuk është respektuar afati i harmonizimit të kontratave kolektive (ajo e përgjithshme për sektorin privat u nënshkrua në qershor të vitit 2006, ndërsa ajo për sektorin publik ende nuk është nënshkruar).

4. Sigurimi social dhe mbrojtja sociale

Mbrojtja sociale në kuptimin e përgjithshëm të fjalës në RM përfshin: mbrojtjen shëndetësore, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin në rast papunësie, të drejtën e punësimit dhe aftësimin profesional dhe orientimit të personave invalid, kompenzim për invaliditet, rehabilitim profesional dhe shtesë për mjete ortopedike, kompenzim finasiar për familjen e kryefamiljarit i cili është në shërbim ushtarak, dhe e drejta e mbrojtjes familjare. Mirëpo, nuk ekzistojnë dispozita ligjore për sistemet e sigurimit social të profesioneve të caktuara veçmas.

Në sistemin e përgjithshëm të sigurimit social, në mënyrë të njëjtë sigurohen të drejtat e të gjithë kategorive të personave të siguruar (përfshirë edhe nëpunësit shtetëror).

Beneficionet sociale i përfshijnë kompenzimet, të cilat popullata i pranon në bazë të pensioneve të paguara, kompenzimeve për papunësi (të cilat i paguan Fondi për punësim), kompenzimeve në bazë të pushimeve mjekësore (të paguara përmes Fondit për mbrojtje shëndetësore), shtesa fëmijërore dhe kompenzime tjera në bazë të mbrojtjes sociale.

Sistemi i mbrojtjes sociale është i organizuar në mënyrë që të pengon dhe tejkalon rreziqet sociale themelore, me të cilat ballafaqohen qytetarët. Me rreziqe sociale nënkuptohen rreziqet lidhur me shëndetin (sëmundjet, lëndimet dhe invaliditetin), rreziqet e pleqërisë, amësisë dhe familjes, rreziqet nga papunësia dhe papërshtatshmëria profesionale, dhe mjedisi social.

Finansimi i mbrojtjes sociale realizohet në bazë të programës vjetore për realizimin e mbrojtjes sociale, të cilën e miraton Qeveria e RM-së. Nga buxheti finansohen këto të drejta: ndihma e përhershme në para, ndihma sociale në para, kompenzimi financiar për përkrahje të personit tjetër, kompenzim të rrogës për orar të shkurtuar të punës së prindit për shkak të përkujdesjes për fëmijë të hendikepuar, ndihmë financiare njëkahëshe, vendosje në familje për përkujdesje, vendosje në institucion të mbrojtjes sociale, funksionim të institucioneve për mbrojtje sociale dhe qendrave ditore dhe kompenzim financiar për invalidë civil.

Koordinimi i rregullave të sistemit për mbrojtje sociale të punëtorëve të RM-së, të cilët janë të punësuar legalisht në territorin e shteteve anëtare të BE-së, është paraparë me nenin 46 nga Marrëveshja për stabilizim dhe asocim (2001) midis RM-së dhe shteteve anëtare të BE-së.

Legjislacioni i RM-së, në përgjithësi i ndjek dhe zbaton përcaktimet e përgjithshme dhe rekomandimet e BE-së për mbrojtje sociale. Me Ligjin për mbrojtje sociale (Gazeta zyrtare e RM-së, Nr.21, 20.02.2006) u dha mundësia për decentralizim, deinstitutionalizim dhe pluralizëm të sistemit për mbrojtje sociale.

Procesi i decentralizimit, në pajtueshmëri me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjin për mbrojtje sociale dhe Ligjin për mbrojtje të fëmijëve, është realizuar ashtu që institucionet publike për pleq (shtëpitë e pleqve) dhe çerdhet e fëmijëve, janë bartur në nivel lokal, ndërsa komunave gjegjësisht qytetit të Shkupit i është dhënë mundësia që të kyçen si dhënë të shërbimeve të caktuara të mbrojtjes sociale, përmes programeve vetanake për zhvillim, për nevojat specifike të qytetarëve, të miratuara dhe finansuara nga organet e komunave përkatëse.

Edhe pse mbrojtja sociale në RM realizohet nga institucionet publike të themeluara nga Qeveria e RM-së (me sjelljen e vendimit për përcaktimin e rrjetit të llojit të duhur dhe numrin e institucioneve publike), ekziston mundësi ligjore për themelimin e institucioneve private për mbrojtje sociale (përveç për themelimin e qendrave për punë sociale dhe institucioneve për vendosjen e fëmijëve me probleme edukativo-

sociale), në mënyrë, kushte dhe procedurë të përcaktuara me ligj. Vendim për themelimin të institucionit privat për mbrojtje sociale sjell Qeveria e RM-së, ndërsa Ministria e punës dhe politikës sociale e jep lejen.

Në këtë sferë, organet e komunës poashtu kanë mundësi që të themelojnë institucione publike. Me Ligjin për mbrojtje sociale është bërë decentralizimi i institucioneve publike për pleq, që plotësisht kalojnë në kompetencat e komunave, ku mund të zhvillohen forma institucionale dhe jashtëinstitucionale të mbrojtjes, dhe të pëpilohen programe për mbrojtje sociale, si dhe të sigurojnë mjete për realizimin e tyre. Mirëpo, mbikëqyrjen mbi punën e Komunës gjatë zbatimit të Ligjit për mbrojtje sociale e bën Ministria e punës dhe politikës sociale.

Rrjeti i sigurimit social në vend, nuk i përfshin të gjitha grupet për shkak të mosekzistimit të resurseve financiare, njerëzore dhe institucionale. Sistemi pensional dhe sigurimi social duhet të transformohen ashtu që tu përgjigjen sfidave demografike dhe ndryshimeve shoqërore. Është bërë përparim i kufizuar në sferën e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes në vendin e punës, mirëpo duhet të ndërmeren aktivitete plotësuese që të sigurohet realizimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore në praktikë.

5. Të drejtat e punëtorëve

Në rast të **lëshimeve kolektive**, punëtorët kanë të drejta të caktuara në Ligjin mbi marrëdhëniet e punës. Në mesin e këtyre të drejtave parashihet obligimi për informim gjatë lëshimit të numrit më të madh të punëtorëve, për shkak të arsyeve afariste (neni 95). Punëdhënësi për qëllimin e lëshimit kolektiv nga puna të numrit më të madh të punëtorëve, më së voni 30 ditë para sjelljes së vendimit është i obliguar për arsyet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, për numrin e caktuar dhe kategorinë e tepriçës së punëtorëve dhe për afatin e paraparë në të cilin do të ndërpritet marrëdhënia e punës së punëtorëve, t'a informon sindikatin përfaqësues ose përfaqësuesin e punëtorëve dhe t'a këshillon për mënyrat e mundshme për kufizimin e numrit të lëshimeve kolektive dhe për masat e mundshme për zvogëlimin e pasojave të dëmshme. Për procedurën e përcaktimit të ndërprerjes së punës të kategorisë më të madhe të punëtorëve, punëdhënësi është i obliguar t'a informon me shkrim Shërbimin për ndërmjetësim.

Të drejtat dhe obligimet në rast të lëshimit kolektiv të punëtorëve për arsye afariste, janë të parapara me nenin 96. Kështu që, punëdhënësi para se të ndërpret kontratën e punës për arsye afariste (teknologjike, ekonomike, organizative dhe ndryshimeve tjera), për shkak të cilave mbaron nevoja për ushtrimin e punëve të caktuara, mund që punëtorit t'i ofron:

- punësim tek punëdhënësi tjetër pa shpallje, me transfer dhe lidhje të kontratës për punësim për ushtrimin e punëve të cilat i përgjigjen përgaditjes së tij profesionale, gjegjësisht kualifikimit;
- aftësim profesional (trajnim, rikualifikim tek i njëjti apo punëdhënësi tjetër) ose
- kontratë të re për punësim.

Në rast të ndërprerjes së marrëveshjes për arsye afariste, punëdhënësi është i obliguar që punëtorit t'i paguan kompenzim me datën e ndërprerjes së punës (neni 97), dhe atë: prej 1 rrogë për marrëdhënie pune që ka zgjatur deri 5 vjet, deri në 6 rroga për marrëdhënie pune që ka zgjat mbi 25 vjet.

Lidhur me të drejtën e punës, vlerësohet se legjislacioni nacional i RM-së, gjegjësisht Ligji mbi marrëdhëniet e punës, mbulon një numër të caktuar të parimeve themelore nga legjislacioni i BE-së, veçanërisht atyre lidhur me orarin e punës dhe informimin e punëtorëve për kushtet e punësimit. Mirëpo, nuk ka dispozita të cilat sigurojnë mbrojtjen e duhur të punëtorëve në rast të insolvencës së punëdhënësit të tyre.

Në rast të **transferit të punëdhënësit**, sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e punës, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë nga kontrata e punës kalojnë tek punëdhënësi i ri në rastet kur paraqiten ndryshime statusore. Të njëjtat këto të drejta punëdhënësi i ri është i obliguar që t'i siguron për së paku 1 vjet, gjegjësisht deri sa të skadon kontrata e punës. Nëse për shkak të ndërimit të punëdhënësit, për arsye objektive keqësohen të drejtat e punës, punëtori ka të drejta të njëjta sikur t'a kishte refuzuar kontratën e punës për arsye afariste. Gjatë përcaktimit të afatit përjashtues dhe të drejtës së kompenzimit, merren parasysh stazhi i punës tek të dy punëdhënësit, nga ku edhe punëdhënësi i mëparshëm edhe ai i fundit përgjigjen solidarisht për kompenzimin e të gjitha kërkesave që janë paraqitur për shkak të përjashtimit. Nëse punëdhënësi përkohësisht e bart pjesërisht apo plotësisht veprimtarinë e tij tek punëdhënësi tjetër, me kontratë të plotëfuqishme juridike, atëherë pas mbarimit të saj punëtorët kthehen përsëri tek punëdhënësi (neni 68).

Punëtorët, poashtu kanë edhe **të drejtë në grevë**, sipas neneve 236-245 të Ligjit mbi marrëdhëniet e punës. Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave ekonomike dhe sociale të punëtorëve, sindikata e punëtorëve ka të drejtë të thir grevë. Si e drejtë e sindikatit me qëllim të mbrojtjes së të drejtave sociale dhe ekonomike të anëtarëve të saj, greva duhet të paraqitet me shkrim tek punëdhënësi. Greva nuk duhet të fillojë para mbarimit të procedurës për pajtim. Në shkresën me të cilën paralajmërohet greva duhet të ceken arsyet, vendi i mbajtjes së grevës, kohëzgjatja, dita dhe koha e fillimit të saj. Greva duhet të organizohet në atë mënyrë që të mos e pengon rrjedhën e procesit të punës së punëtorëve të cilët nuk marrin pjesë në grevë dhe të ndalohej hyrja e punëtorëve në zyrat afariste të punëdhënësit (neni 236). Megjithatë edhe gjatë kohës së grevës sindikata dhe punëdhënësi i dakordojnë bashkarisht rregullat për vazhdimin e punës, e cila nuk duhet të ndërpritet gjatë grevës, për shkak të sigurisë dhe shëndetit të qytetarëve (neni 238).

Punëtorët të cilët e organizojnë ose marrin pjesë në grevë në pajtueshmëri me dispozitat ligjore ose kontratën kolektive, nuk duhet të vihen në pozitë më të pavolishme sesa punëtorët tjerë, ndërsa punëtori mund të përjashtohet vetëm nëse ka organizuar ose ka marrë pjesë në grevë e cila nuk është organizuar në pajtueshmëri me ligjin ose kontratën kolektive (neni 239).

Legjislacioni i RM-së lidhur me **orarin e punës, pauzat dhe pushimet**, në përgjithësi është i harmonizuar me legjislacionin e BE-së. Neni 116 i Ligjit mbi marrëdhëniet e punës pohon se orari i plotë i punës nuk guxon të jetë më i gjatë se 40 orë në javë dhe zakonisht zgjat 5 ditë pune. Me ligj ose kontratë kolektive mund të përcaktohet si orar i plotë pune edhe orari i punës që zgjat së paku 36 orë në javë, ndërsa në vendet ku ekzistojnë rreziqe më të mëdha për lëndime ose rrezik për shëndetin, orari i plotë i punës mund të zgjat edhe më pak se 36 orë në javë.

Në nenin 117 parashihet mundësia që punëtori në kërkesë të punëdhënësit të ushtron punë mbi orarin e plotë të punës në rast të rritjes së nivelit të punës, vazhdimin të procesit prodhues, sigurimit të njerëzve dhe pronës dhe rastet tjera të caktuara me kontratë kolektive. Mirëpo, puna mbi orarin e plotë të punës mund të zgjat më së shumti 10 orë në javë dhe 190 orë në vit. Mirëpo, vlen të cekët se neni 120 ndalon ushtrimin e punës shtesë mbi orarin e plotë të punës, dhe punëdhënësi nuk guxon të urdhëron punë më të gjatë se orari i plotë nëse: puna mund të organizohet me vënien e turneve të reja, punëtorja është shtatzënë ose

nënë e fëmijës deri në moshën 3 vjeç, dhe nëse punëtori është më i ri se 18 vjeç.

Si mundësi parashihet puna shtesë (neni 121). Punëtori i cili punon me orar të plotë pune, mund me përjashtim të lidh kontratë pune me orar të shkurtuar me punëdhënësit tjetër, mirëpo jo më tepër se 10 orë në javë, me pëlqimin paraprak të punëdhënësit ku është i punësuar me orar të plotë pune.

Vlen të ceket si risi në legjislacionin e punës, se kontratat për punësim në kohë të caktuar (neni 46) për ushtrimin e punëve të cilat për nga natyra e tyre zgjasin kohë të caktuar, me ndërprerje apo pa ndërprerje deri 4 vjet, mund të transformohet në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar nëse punëtori vazhdon të punon pas kalimit të këtij afati sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me këtë ligj.

Të drejtën e pushimit vjetor, punëtori e fiton pasi të ketë punuar së paku 6 muaj pandërprerë, pa marrë parasysh se a punon me orar të plotë apo të shkurtuar (neni 139).

Përveç kësaj, punëtori ka të drejtë në pushim të paguar për arsye personale dhe familjare (lidhje të martesës, lindje të fëmijës ose vdekje e familjarit të afërt) deri në 7 ditë pune (neni 146). Punëtori mund të shfrytëzon edhe pushim të paguar dhe kontribute të rrogës deri në 3 muaj gjatë vitit, dhe për këtë kohë i pezullohen të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës (neni 147).

6. Mbrojtja gjatë punës

Bazë juridike për miratimin e Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës është neni 32 i Kushtetutës së RM-së, sipas së cilit çdokush ka të drejtë në mbrojtje gjatë punës. Në RM në sferën e mbrojtjes gjatë punës zbatohen Konventat e ratifikuara të ONP-së,⁶ Ligji për mbrojtje gjatë

⁶ Konventa Nr.12 për kompensim nga fatkeqësitë gjatë punës në bujqësi (1921), Konventa Nr.81 për inspektion të punës në industri dhe tregti (1947), Konventa Nr.89 për punë të grave të punësuar në industri (1948), Konventa Nr.90 për punën e natës së fëmijëve në industrinë (1948), Konventa Nr.119 për mbrojtjen nga makinat (1963), Konventa për kompensimet në rast fatkeqësie gjatë punës dhe sëmundjeve profesionale (1964), Konventa Nr.129 për inspektion të punës në bujqësi (1969), Konventa Nr.136 për mbrojtje nga helmimi me benzol (1971), Konventa Nr.139 për ndalimin dhe kontrollin e rreziqeve profesionale të shkaktuara nga materie dhe agjense kancerogjene (1974), Konventa Nr.148 për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet profesionale për shkak të helmimit të ajrit, zhurmës dhe vibrimeve në mjedisin e punës (1981), Konventa Nr.162 për mbrojtje gjatë përdorimit të azbestit (1968).

punës (Gazeta zyrtare e RM-së Nr.13/98, 33/00, 29/02) si dhe aktet nënligjore.⁷

Dispozitat e Ligjit për mbrojtje gjatë punës, parashohin përgjegjësi të punëdhënësit për planifikim, organizim dhe rregullim të mbrojtjes gjatë punës, trajnim dhe aftësim të punëtorëve për punë të sigurtë, realizim të kontrollëve të kohëpaskohshme të mjeteve të punës dhe kushteve për punë, dhe kontrolleve mjekësore të punëtorëve të cilët punojnë sipas kushteve të veçanta. Përveç obligimeve tjera, punëdhënësi është i obliguar të mban evidencë në sferën e mbrojtjes gjatë punës, ndërsa punëtorët janë të obliguar gjatë kohës së punës tu përmbahen masave dhe mjeteve mbrojtëse gjatë punës dhe punën t'a ushtrojnë me vëmendje, si dhe të bashkëpunojnë me punëdhënësin gjatë realizimit dhe avansimit të mbrojtjes në punë. Poqëse punëtori nuk u përgjigjet masave të parashikuara dhe mjeteve për mbrojtje në punë, dhe me atë e rrezikon shëndetin dhe jetën e tij dhe të punëtorëve tjerë, dhe pronën e punëdhënësit, atëherë mund në pajtueshmëri me aktin e punëdhënësit dhe kontratën kolektive që përkohësisht të largohet nga vendi i punës. Në këtë drejtim, parashihet emërimi i përfaqësuesit për mbrojtje gjatë punës, i cili ka për detyrë në çdo kohë të kontakton me punëdhënësin dhe po që se llogarit se masat dhe mjetet e ndërmara nga punëdhënësi nuk janë adekuate për sigurinë dhe shëndetin e punëtorit, atëherë ai mund të ankohet deri te Inspektorati shtetëror i punës.

Ligji për mbrojtje gjatë punës i klasifikon masat e mbrojtjes gjatë punës në të përgjithshme dhe të veçanta. Masat mbrojtëse në punë i cakton Ministri për punë dhe politikë sociale, nëse me ligj tjetër nuk thuhet ndryshe (neni 9). Mbikëqyrjen e respektimit të dispozitave nga ky ligj e bën Ministria e punës dhe politikës sociale, ndërsa kontrollin inspeksional e bën Inspektorati Republikan i punës, i cili poqëse konstaton parregullësi rreth zbatimit të ligjit, me vendim do të urdhëron që të mënjanohen parregullësitë të cilat mund ta rrezikojnë jetën dhe shëndetin e punëtorëve në punë, mirëpo ai mund edhe të sjell vendim për ndalesë të ushtrimit të punës nëse punëdhënësi nuk vepron në pajtueshmëri me udhëzimet e tij (nenet 50-55).

⁷

Regullore për mbrojtje gjatë punës lidhur me ngarkim dhe shkarkim të mallit (Gazeta zyrtare e RM-së Nr.31/89, 33/93, 36/89), Rregullore për realizimin e punëve ndërtimore (Gazeta zyrtare e RM-së Nr.13/88), Rregullore për mbrojtje gjatë punës në industrinë tekstile (Gazeta zyrtare e RM-së Nr.12/88), Rregullore për masat e posaçme mbrojtëse gjatë punës në hekurudha (Gazeta zyrtare e RM-së Nr.1/89), Rregullore për mbrojtje gjatë përpunimit të drurit (Gazeta zyrtare e RM-së Nr.1/89), Rregullore për mbrojtje gjatë përpunimit të lëndëve jometalike (Gazeta zyrtare e RM-së Nr.74/92), Rregullore për kushtet që duhet ti plotësojnë personat juridik për fitimin e autorizimit për ushtrimin e punëve të caktuara nga sfera e mbrojtjes gjatë punës (Gazeta zyrtare e RM-së Nr.71/03), Rregullore për mënyrën dhe afatet për realizimin e kontrollëve periodik (Gazeta zyrtare e RM-së Nr.27/88) etj.

Me këtë ligj sigurohet që çdo punëdhënës, para se të fillon të ushtron veprimtarinë e tij duhet të siguron pëlqim nga Inspektorati i punës, i cili kontrollon se a janë zbatuar masat dhe standardet e mbrojtjes në punë (neni 11).

Përveç kësaj, parashihet edhe **mbrojtje e posaçme e kategorive të caktuara** në Ligjin mbi marrëdhëniet e punës për këto raste:

- ndalimin e ushtrimit të punëve nëntokësore nga gratë (neni 160),
- mbrojtja e punëtorëve për shkak të shtatzënisë dhe amësisë (neni 161),
- ndalimi i ushtrimit të punëve gjatë kohës së shtatzënisë dhe pas lindjes (neni 162),
- mbrojtja e posaçme gjatë shtatzënisë (neni 163),
- mbrojtja gjatë shtatzënisë dhe amësisë lidhur me punën e natës dhe orarin shtesë (neni 164),
- pushim nga puna gjatë shtatzënisë, lindjes dhe amësisë në kohëzgjatje prej 9 muaj, kështu kjo e drejtë duhet të shfrytëzohet 45 ditë para lindjes ose më së voni 28 ditë përpara lindjes (neni 165),
- kthim i sërishëm në punë nga mungesa e punës për shkak të shtatzënisë, lindjes dhe pushimit prindor (neni 166),
- mbrojtja e punëtorëve të rinj deri në moshën 18 vjeç nga puna e natës (neni 175) dhe rritja e pushimit vjetor për 7 ditë shtesë (neni 176),
- mbrojtja e invalidëve (nenet 177-178),
- punëtorët e moshuara gra mbi 57 vjeç dhe burrat mbi 59 vjeç, gëzojnë mbrojtje të posaçme (neni 179) si dhe nuk guxojnë të punojnë punë natën ose jashtë orarit të punës (neni 180),
- mbrojtja e fëmijëve nën 15 vjeç nga puna, ndërsa përjashtim ekziston nëse angazhohet me kompenzim dhe merr pjesë në inçizimin e filmave, përgaditjen dhe mbajtjen e spektakleve skenike, kulturore, sportive ose reklamave (neni 250).

Meqenëse ligji i mëparshëm për mbrojtje gjatë punës nuk ishte plotësisht i harmonizuar me Direktivën e Këshillit 89/391 (12.6.1989), u shfaq nevoja që të miratohet ligj me konceptcion i cili është plotësisht i harmonizuar me këtë direktivë. Ligji i ri për siguri dhe shëndet gjatë punës (2007) i rregullon obligimet e punëdhënësit dhe të drejtat e punëtorëve në sferën e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës, si dhe masat preventive kundër rreziqeve profesionale, mënjanimin e faktorëve të rrezikshëm, informimin, konsultimin, trajnimin e punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre, si dhe pjesëmarrjen e tyre në planifikimin dhe ndërmarjen e masave të sigurisë dhe shëndetit gjatë punës. Si risi në këtë ligj, parashihet themelimi i institutit *Këshill për siguri dhe shëndet gjatë punës*, si trup ekspertësh këshilldhënës, të cilin e emëron Qeveria e RM-së me detyra dhe përbërje të caktuara.

Në funksion të harmonizimit të legjislacionit të RM-së nga sfera e mbrojtjes në procesin e punës me ate të BE-së, në të ardhmen aktivitetet duhet të përqëndrohen në drejtim të sjelljes së:

- Rregullores për vënien e shenjave mbrojtëse në vendin e punës,
- Rregullores për pajisjet personale mbarëvajtëse, të cilat punëtorët i përdorin gjatë punës,
- Rregullores për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve që punojnë në vende të punës me zhurmë dhe vibrime,
- Rregullores për sigurinë e punëtorëve që punojnë në vende me substanca kimike, biologjike dhe fizike,
- Rregullores për sigurim nga substancat kancerogjene në vendin e punës.

Rezyme

Edhe pse RM punon në drejtim të përafrimit të legjislacionit të saj me ate të BE-së, megjithatë ekzistojnë edhe sfera në të cilat duhet të ndërmerren aktivitete legjislative. Përkatësisht, RM-së i mungojnë institucione kompetente në rast të insolvencës (paaftësi finasiare që punëdhënësi ti paguan punëtorët). Garancë për ate se punëtorët i realizojnë të drejtat e tyre duhet të jetë shteti, përmes themelimit të institucioneve garantuese, duke përcaktuar me ligj afatin në të cilin duhet të plotësohen obligimet ndaj punëtorëve dhe mënyra e finansimit të institucioneve garantuese. Është me rëndësi që prona e institucionit të jetë e pavarur nga kapitali i ndërmarrjes, ndërsa borxhet e institucioneve nuk guxojnë të ndikojnë në plotësimin e obligimeve ndaj punëtorëve. Institucionet garantuese si zakonisht sigurojnë shkallë minimale të mbrojtjes së punëtorëve në rast të insolvencës së punëdhënësit, ndërsa në shtetet-anëtare të BE-së i ndërmarrin masat e nevojshme për mënjanimin e keqpërdorimeve gjatë plotësimit të obligimeve.

Mandej, vërejtjet mund ti adresojmë edhe në aspektin praktik të implementimit të dispozitave lidhur me barazinë sociale, konkretisht ato lidhur me barazinë gjinore në praktikë, gjegjësisht me gjendjen e grave në vendet rurale, të pakicave nacionale, dhunën dhe tregtinë me gra etj.

RM në të ardhmen përveç aktiveve që kanë të bëjnë me harmonizimin e legjislacionit konform standardeve të BE-së, me rëndësi jetike është ti përkushton vëmendje të veçantë edhe procesit të imlementimit praktik të të gjitha masave ligjore.

Harmonizimi i sistemit të të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë me standardet ndërkombëtare (Procesi i integritimeve euroatlantike)

Abstrakt

E drejta ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ndikoi mbi krijimin e standardeve të reja në Evropën postsocialiste. Agjenda e ndryshimeve sistematike në vendet e tranzicionit është qartë e mbështetur në të dhënat se të drejtat e njeriut janë qëllimi i fundit legjitim për bashkësinë globale demokratike. Të drejtat e njeriut luajtën dhe luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e tranzicionit në Evropën Qendrore dhe Lindore, për arsye se japin kuptim dhe i sigurojnë legjitimitet sistemeve që lindin dhe i japin rëndësi morale dhe shpresë aktiviteteve individuale. Harmonizimi i legjislacionit të Republikës së Maqedonisë me standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, në esencë paraqet konsolidimin e vendimeve të legjislacionit nacional me të drejtën ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, si dhe me të drejtën evropiane. Të drejtat e njeriut luajnë një rolë të rëndësishëm në proceset tranzitore në Republikën e Maqedonisë, për shkak se të njëjtat i japim stimul dhe shtytje për integrimin euroatlantik të shtetit. Në këtë punim jepen sqarime në dimensionet e ndryshme të sistemit të të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë në periudhën tranzitore. Të drejtat e njeriut përveç aspektit juridik ndiqen edhe brenda kontekstit politiko-social, si një anë e procesit për vendosjen e lirisë njerëzore. Ana e dytë e atij procesi është demokratizimi i Republikës së Maqedonisë. Demokracia dhe të drejtat e njeriut janë aksiome të lidhura ngushtë njëra me tjetrën. Problemi në Republikën e Maqedonisë nuk qëndron në rregullimin juridik të të drejtave të njeriut, por në zbatimin e tyre të përditshëm. Vënia e sundimit të së drejtës është njëra nga detyrat më të ndjeshme dhe të rënda në procesin e sendërtimit të konceptit të të drejtave të njeriut në vendet postsocialiste.

¹

Dr. sc. Ali MUSLIU është ligjërues në Fakultetin Juridik të USHT-së.

1. Harmonizimi i legjislacionit në Republikën e Maqedonisë – sfidat dhe problemet

Harmonizimi i legjislacionit të Republikës së Maqedonisë me standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, në esencë paraqet konsolidimin e vendimeve të legjislacionit nacional me të drejtën ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, si dhe me të drejtën evropiane.² Nëse merret parasysh konventat e shumata ndërkombëtare në fusha të ndryshme, a posaçësisht në fushën e të drejtave të njeriut, mund të konstatohet se harmonizimi i së drejtës është tendencë e përgjithshme e të drejtës bashkëkohore. Në suaza të Unionit Evropian harmonizimi, si dhe unifikimi i së drejtës duhet të mundësoj krijimin e hapësirës unike të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, si dhe treg të përbashkët në të cilin pa kufizime realizohen funksionet ekonomike dhe funksionet tjera të Unionit. Nevoja dhe përkushtimi për harmonizimin e legjislacionit të Republikës së Maqedonisë me të drejtën e UE-së është inicuar me vendimin e Komisionit Evropian nga data 17 dhjetor 2005, kur Republika e Maqedonisë i jepet statusi i vendit kandidat për anëtarësim në Unionin Evropian.³ Procesi i harmonizimit të legjislacionit të Republikës së Maqedonisë me të drejtën evropiane është një nga parakushtet për anëtarësim të plotë në Unionin Evropian. Nga momenti kurë Republika e Maqedonisë është orientuar për integrimet euroatlantike, regullimi juridik i UE-së (duke i përfshirë edhe burimet juridike primare dhe sekondare) është regullim juridik referues ndaj të cilit sistemi juridik i

² E drejta e Unionit Evropian në përgjithësi emërohet si e drejtë komunitare, e cila është e adoptuar nga gjuha frenge *Acquis Communautaire*. Me të nënkuptohet, tërësi e të drejtave dhe obligimeve që shtetet-anëtare i obligon dhe i unifikon në Unionin Evropian. E drejta komunitare e UE-së nuk është e drejtë vetëm në kuptim të ngushtë të fjalës për shkakë se ajo përfshinë: përmbajrje, parime dhe qëllimet politike të traktateve themeluese, legjislacionin e adoptuar në bazë të traktateve themeluese, aktëvendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, deklaratat dhe rezolutat e miratuara të Unionit Evropian, masat që kanë të bëjnë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, si dhe traktateve ndërkombëtare që i ka nënshkruar Unioni Evropian, si dhe traktatet që janë të lidhura në mes shteteve anëtare me vendet e treta nga domeni i veprimtarisë së Unionit Evropian. Çdo shtet që aspirojnë anëtarësimin në Unionin Evropian duhet të pranon vendimet e traktateve themelore si dhe të nivelizon dhe harmonizon sistemin e vetë juridik me trashëgimin e përbashkët juridike të Unionit Evropian. Më gjerësisht shih në: Upoznaj Evropsku uniju. (2007), Vodič kroz evropske integracije, Zagreb.

³ Shih në Raportin e Komisionit Evropian: COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES, Brussels, 08.11.2006, SEC (2006)1387, COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT The former Yugoslav Republic of Macedonia 2006 Progress Report..

Republikës së Maqedonisë duhet të afërohet.⁴ Me harmonizimin e legjislacionit duhet të vendoset sistem juridik i qartë dhe konsistent në të cilin nuk do të ketë kolizione të brendshme të ligjeve. Në lëmitë përkatëse juridike, harmonizimi do të tërhek dhe nevojën për kodifikimin e legjislacionit.

Sistemi juridik i Republikës së Maqedonisë i përfshin përkrah Kushtetutës së RM të vitit 1991, ligjet dhe aktet nënligjore të sjellura pas vitit 1991, si dhe legjislacionin e bashkësisë së ish shtetit Jugosllav që ka qënë konsistent me kushtetutën e re dhe rregullimit të ri juridik, konform nenit 5 të Ligjit kushtetues për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Kjo do të thotë se, gjatë një periudhe kohore, nga momenti që Republika e Maqedonisë e fitoi pavarësinë e saj, një numër i madh i ligjeve të përbashkëta implementohen si pjesë e legjislacionit nacional.

Hapë të rëndësishëm në harmonizimin e legjislacionin e Republikës së Maqedonisë kundrejt të drejtës së UE-së është ajo se gjatë sjelljes së akteve të reja i jepet llogari të pajtueshmërisë së tyre me legjislacionin e të drejtës evropiane. Respektivisht, në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë është implituar detyra për gjitha ligjet e reja ose aktet juridike që propozohen të jenë të shoqëruara me kontroll të përputhshmërisë së tyre me të drejtën evropiane.⁵ Kjo është jashtëzakonisht me rëndësi nëse merret parasysh se Qeveria e RM është propozues dominant i ligjeve që sillen në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë.⁶ Posaçërisht është me rëndësi të përcaktohet se sa Republika e Maqedonisë mundet dhe duhet të pranoj nga ajo që quhet e drejta evropiane, për shkak se harmonizimi i legjislacionit mbi të drejtat e njeriut nuk është një translatim i thjeshtë i masave të UE-së në legjislacionin nacional. Harmonizimi i legjislacionit nuk nënkupton

⁴ Pas marrjes së statusit kandidat në dhjetor të 2005, Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mars të vitit 2006 solli propozim programën për adoptimin e të drejtës evropiane. Përmbajtësisht dokumenti i përmban planet për harmonizimin e legjislacionit nacional me legjislacionin e Unionit Evropian, dinamikën e duhur për forcimin e institucioneve për implementimin e legjislacionit, si dhe resurset e nevojshme për realizimin e këtyre ndryshimeve. Programi ishte prezentuar në maj të 2006 para shërbimeve të KE në Bruksel. Në shtator të 2006 janë marrë komentet e para nga ana e Komisionit Evropian. Në tetor të 2006 për propozim-programën diskutoi Komisioni për çështje evropiane pranë Parlamentit të Republikës së Maqedonisë.

⁵ Rregullorja për punën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, (Tekst i spastruar), nga 8 maj 2006, (Fletorja Zyrtare e RM nr. 51/2006).

⁶ Përpos Qeverisë së RM, iniciativë për sjellje të ligjit mund të japin: grupë të qytetarëve, institucionet ose organizatat qytetare. Si dhe propozim për sjelljen e ligjit mund të jepet çdo deputet ose 10 000 votues. Këtu themelohet një raport reciprok në mes propozuesve të atutorizuar dhe organizatave joqeveritare, respektivisht asociacioneve qytetare.

nivelizim total, por mundet që të ekzistojnë disa dalime ose specifika. Kur bëhet fjalë për harmonizimin e të drejtës në lëmi përkatëse, duhet të merret parasysh se normat juridike duhet përshtatet në kushtet konkrete në vendin se ku sillen, se në të kundërtën, ato do të jenë të pa implementuara dhe realizuara. Megjithatë, këto karakteristika të legjislacionit nacional duhet të jenë në korniza të mundshme të dhëna nga Unioni Evropian, dhe të njëjtat do të pakësohen me kalimin e kohës, deri në anëtarësimin e plotë të vendit në Unionin Evropian. Respektivisht, harmonizimi është hapë i parë drejt unifikimit që do të thotë sjelljen e regullave të njëjta në fushat përkatëse juridike.

Të drejtat e njeriut luajnë një rolë të rëndësishëm në proceset tranzitore në Republikën e Maqedonisë, për shkak se të njëjtat i japim stimul dhe shtytje për integrimin euroatlantik të shtetit. Republika e Maqedonisë u orvat të krijoj mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke nisur nga dy principe parësore. Qytetarët në Maqedoni jetonin nën regjim që sistematikisht i mohonte dhe i shkelte të drejtat e njeriut, kurse në të njëjtën kohë proklamonte se i respekton të njëjtat. Arsyeja e dytë është aspirata e Republikës së Maqedonisë të anëtarësohet në strukturat euroatlantike, kurse një nga kushtet elementare është ajo që tregoj se i respekton dhe i mbron të drejtat e njeriut. Republika e Maqedonisë është nënshkruese e të gjitha marrëveshjeve relevante ndërkombëtare në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë i pranon të gjitha marrëvashjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtueshmëri me Kushtetutën si pjesë e brendshme e regullimit juridik të shtetit.⁷ Për atë shkak, Kushtetuta e re e Republikës së Maqedonisë vendosi një akcent të veçantë në të drejtat e njeriut. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë në vetë fillimin e saj jepë një katalog të gjërë dhe sistematik të të drejtave të njeriut dhe të qytetarit, duke filluar me të drejtat qytetare, për të vazhduar me të drejtat politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe mbrojtjen e tyre kushtetuese, që përputhet me zhvillimin evolutiv të të subjektivitetit qytetëruar në historinë politike evropiane. Me këto dispozita, statusi politik i çdo qytetari bëhet në esencë i barabart, pa marrë parasysh prejardhjen dhe përkatësinë nacionale, që për Republikën e Maqedonisë, si bashkësi shoqërore që e përbëjnë përfaqësues të etnikumeve dhe nacionaliteteve të ndryshme, është me

⁷ Neni 118. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë.

relevancë të madhe në korniza të regullimit kushtetues të saj. Korniza kushtetuese dhe juridike në Republikën e Maqedonisë është në përputhshmëri me Konventën evropiane mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe Protokolet shtesë, që është në fuqi në Republikën e Maqedonisë prej prilli të vitit 1997.⁸ Konkluzat e përgjithshme për konceptin e të drejtave të njeriut në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë është ajo se siguron një koncept modern dhe liberal mbi të drejtat të njeriut.⁹

2. Të drejtat e njeriut dhe integrimi euroatlantik i Republikës së Maqedonisë

Për proces sa më të sukseshëm në harmonizimin e legjislacionit të Republikës së Maqedonisë me të drejtën evropiane, si dhe konzistencës, koordinimit dhe pasqyrës së qartë të monitorimit të procesit të harmonizimit të legjislacionit në vitin 2007 u përgatit Programi nacional për adoptimit të së drejtës së Unionit Evropian. Për arritjen e qëllimit të integritimit evropian, Republika e Maqedonisë duhet të investojë shumë mund në drejtim të përbushjes së kushteve për anëtarësim në Unionin Evropian. Duhet të parashihen ndryshimet kushtetuese me të cilën do të mundësohet që RM të mbartë një pjesë të sovranitetit të vetë organizatave supranacionale (NATO dhe EU). Për anëtarësimin në EU, nga pikëpamja e të drejtave dhe lirive të njeriut, Republika e Maqedonisë duhet t'i përmbushë kriteret politike. Kriteret e Kopenhagenit qartësisht përcaktojnë kushtet për anëtarësim në Unionin Evropian, në veçanti duke potencuar stabilitetin e institucioneve që garantojnë, sundimin e së drejtës, demokracisë, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të drejtat e

⁸ Të dhënat jooficiale flasin se numri i ankesave nga momenti i ratifikimit të Konventës evropiane mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nga ana e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë në 10.04.1997, përmbyllur me dhjetor të 2006 është 726. Në përputhje me kriteriumet për lejimin e përcaktuar me nenin 35 të Konventës, përmbyllur me dhjetorin 2006 nga Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë i është dërguar 76 lëndë për përgjigje. Nga 76 lëndë të komunikuar, 29 janë të kryera dhe atë 16 me aktëvendim, ndërsa 13 me vendim të Gjykatës evropiane. Me atë, Gjykata evropiane me 12 aktëvendime konstatoi shkeljen e Konventës nga ana e Republikës së Maqedonisë. Me 4 aktëvendime Gjykata konstatoi shkelje të të drejtave të njeriut, ndërsa me 11 vendime Gjykata evropiane i hodhi paditë e aplikuesve si të pabaja dhe e ndërpreu procedurën në lëndët konkrete.

⁹ Në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës evropiane mbi të drejtat e njeriut në vitin 2006, u bë ndryshimi i Kodit penal se u anulua dënimi me burg për veprat penale dhëpifje dhe fyerje. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2006 u bënë disa ndryshime procedurale në Ligjin mbi procedurën penale të Republikës së Maqedonisë.

minoriteteve. Në atë drejtim veçanarisht është me relevanc krijimi dhe forcimi i mekanizmave institucional për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në atë kontekst, në 2006 u formua Organi ndër-resorial për të drejtat e njeriut me të cilin udhëheq përfaqësues nga Ministria e drejtësisë.¹⁰ Organi ndër-resorial për të drejtat e njeriut, ka për qëllim të vë koordinimin në mes resore ministrore, të marrë pjesë në avancimin dhe inicimin e propozimeve në raport me regullativën ligjore në lëmin e të drejtave të njeriut si dhe shkëmbimin e informatave, të dhënave dhe realizimin e rekomandimeve nga raportet e komiteteve kompetente të OKB dhe të Këshillit të Evropës. Konform Vendimit ky organ është i detyruar të informon Qeverinë një herë në vitë për punën e vete. Etablimi i këtij organi është e nevojshme dhe paraqet një hapë pozitiv në promovimin e të drejtave të njeriut në Maqedoni. Promovimi i të drejtave të njeriut është në lidhje të ngusht me mbrojtjen dhe prevencën nga shkelja e tyre. Nuk ka dyshim se qëllimi i drejtë i promovimit të të drejtave të njeriut qëndron në mbrojtjen dhe prevencën e tyre në mënyrë sa më të mirë nga ana e shtetit.

Shqetëson fakti se Organi ndër-resorial për të drejtat e njeriut thuase është enigmë për opinionin më të gjërë, a mos të flasim për rezultatet e punës së këtij organi. Ngelët shpresa se ky Organ ndër-resorial për të drejtat e njeriut nuk do të jetë vetëm një detyrë formale, rekomandim i dhënë nga Komisioni Evropian ose si formë e zbrazët pa përmbajtje me qëllim që të fshehen dobësit substanciale në raport me të drejtat e njeriut, implementimit dhe mbrojtjes së tyre. Duke nisur nga principi demokratik pushteti ekzekutiv në Republikën e Maqedonisë duhet ta informoj opinionin publikë për punën e këtij organi, për hapat e ndërmarura si dhe të mundëson bashkëpunim të këtij organi me sektorin joqeveritar që merren me lëmin e të drejtave të njeriut.

Poashtu, niveli i suksesit të institucioneve bazike nacionale mbi të drejtat e njeriut (prokuroria publike, gjykatat, Gjykata kushtetuese, ombudsmani) mvaren nga faktorë të shumtë politik, financiar, shoqëror që ndikojnë në funksionimin e këtyre institucioneve. Sistemi gjyqësor në Republikën e Maqedonisë ishte reformuar në periudhën 1995 – 1997, kurë legjisllacioni në masë të madhe ishte harmonizuar me konventat dhe standardet ndërkombëtare, (Këshilli Evropian pozitivisht i vlerësoi reformat). Qëllimet kryesore të reformave aktuale janë të përqëndruara

¹⁰ Vendimi i Qeverisë, nr. 19-1378/1 nga 29.03.2006 (Gaz. Zyrtare, nr. 44/2006).

në forcimin e pavarësisë dhe rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor.¹¹ Gjatë periudhës së 2005 dhe 2006 janë ndërmarë aktivitete kruciale legjislative të parapara me agjendën reformuese. Amandamentet kushtetuese të miratuara në dhjetor të 2005 mundësuan ndryshime rënjësore në strukturën dhe funksionimin e institucioneve gjyqësore. Zgjedhje dhe shkarkimi i gjykatësve dhe prokurorëve publik kaloi në kompetenca të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (shumicën e anëtarëve i zgjedhin gjykatësin nga radhët e tyre), gjegjësisht në Këshillin e prokurorëve publik. Me vendimet e reja ligjore¹² operacionalizohen dispozitat e reja kushtetuese me të cilat redefinohet kompetenca në procesin e zgjedhjes dhe shkarkimit të gjykatësve, përbërjes dhe kompetencat e trupit që do të kryej zgjedhjen dhe shkarkimin (Këshillit gjyqësor të RM)¹³ si dhe ndryshimet në strukturën organizative dhe kompetencat e gjykatave.

Një risi e rëndësishme në sfërën e gjyqësisë është përfshirja e specializmit të gjykatave. Bëhet fjalë për dikastere dhe sektor te specializuar në gjykata, e cila duhet të shërbej për efektivitetin e sistemit gjyqësor. Risi tjetër është formimi i Gjykatës Administrative kompetente për zgjidhjen e ligjshmërisë së akteve të administratës shtetëre me ç'rast erdhi deri tek shkarkimi apo lehtësimi i Gjykatës Supreme nga lloje të këtilla lëndësh. Gjithashtu është formuar edhe nje gjykate tjetër e Apelit në Gostivar (perkra h 3 eksituesve) për arsye të rritjes së aksesit në drejtësi nga ana e qytetarëve. Edhe pse në ligjin e ri për gjykatat janë

¹¹ Strategjia e reformës së sistemit gjyqësor së bashku me Planin aksional të realizimit të saj (2004-2007).

¹² Me Ligjin mbi gjykatat (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë me nr. 58/06 nga 11 maj 2006), janë të inkorporuara instrumentet ndërkombëtare siç vijojn: Konventa evropiane për mbrojtje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; Rekomandimet e Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës për pavarësin, efikasitetin dhe rolin e gjykatësve; Karta evropiane mbi statusin e gjykatësve; Deklaratën universale për gjyqësi të pavarur; Rezolutën 1987/23 dhe Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së me nr. 40/32/4/1.

¹³ Ligji mbi këshillin gjyqësor të RM (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 60/06 nga 15.05.2006).

¹⁴ Në ligj është pranuar parimi i gjykimit në afat të arsyeshëm kohor në përputhshmëri me nenin 6 nga Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore. Ligji është në përputhshmëri me aktet ndërkombëtare dhe të UE në vijim: Aksioni përbashkët nga 22 prill 1996 e miratuar nga ana e Këshillit në bazë të nenit K3 nga Marrëveshja për UE-në, e cila i referohet definimit të kornizës për shkëmbimin e gjykatësve për përmirësimin e bashkëpunimit me vendet anëtare të UE-së; Aksioni i përbashkët i 29 qershorit 1998 e miratuar nga Këshilli në bazë të nenit K3 nga Marrëveshja për UE-në, për themelimin e rrjetit e gjykatave evropiane; Rekomandime e Komiteti i ministrave të Këshillit të Evropës për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjykatësve; Karta Evropiane për statusin e gjykatësve dhe Deklarata Univerzale për pavarësinë e gjyqësisë; Rezoluta 1987/23 dhe Rezoluta Asamblesë së Përgjithshme të OKB nr.40/32;4/1.

inkorporuar te gjitha standardet ndërkombetare në lidhje me gjykimin në afat te arsyeshem kohor, përsëri procedurat gjyqësore janë të stërgjatura.¹⁴ Është shumë serioz numri i ngelur i lëndëve nëpër gjykata. Gjykatat sikur nuk i kushtojnë rëndësi faktit se drejtësia e vonuar është padrejtësi. Me qëllim të rritjes së efikasitetit të procedurave gjyqësore u vendosën risi të rëndësishme në legjislacion dhe në të drejtën procedurale. Me vendosjet e reja në ligjet procedurale u krijuan prezumime ligjore për përshpejtimin e procedurave¹⁵ nëpërmjet tejkalimit të dobësive të gjetura, të cilat kontribonin në zgjatjen e procedurave. Kishte dhe ende ndërmerren aktivitete si synim zvogëlimin e numrit të lëndëve penale në gjykata dhe të eliminohen problemet e detektuara në gjyqësi.¹⁶

Përparim adekuat është bërë edhe në përmirësimin e pozitës së bashkësive nacionale në Republikën e Maqedonisë. Marrëveshja Kornizë e Ohrit paraqet kornizë të harmonizuar për ndërtimin e një shoqërie të integruar multietnike e cila do të garantojë paqe, stabilitet dhe zhvillim demokratik në Republikën e Maqedonisë. Marrëveshja Kornizë e vërtetoi paprekshmërinë e sovranitetit, integritetit territorial si dhe karakterin unitar të shtetit, e ktheu stabilitetin në gjithë territorin e saj, duke zhvilluar një mekanizëm për ndërtimin e mëtutjeshëm të mirëbesimit. Marrëveshja kornizë nënkupton ndryshime thelbësore në rregullimin kushtetues dhe legjislacion në kahje të avancimit të drejtave të bashkësive, me çka evitohetn motivet për konflikt në shoqërinë e maqedonisë në baza etnike. Njëherit, parimi i përfaqesimit të drejtë përfshirje intensive në jetën publike janë bazë për reintegrim në shoqërinë e maqedonisë dhe një kohezion më i fortë në të. Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i qytetarëve që i përkasin të gjitha bashkësive në organet e pushtetit shtetëror dhe institucioneve tjera publike në të gjitha nivelet

¹⁵ Me rëndësi është sjellja e Ligjit të ri për Procedurën kontestimore (2005) dhe gjetja e mekanizmave adekuat ligjor me të cilat do të mundësohet veprimi më i shpejtë dhe efikas i gjykatave në kontestet personale, familjare, marrëdhëniesve të punës, pronësore dhe marrëdhëniet e tjera juridikocivile, a me atë edhe zgjidhje të plotëfuqishme në marrëdhëniet kontestuese midis subjekteve juridike, me çka krijohet siguri juridike më e madhe në atë sferë.

¹⁶ Për shembull, me ndryshimet e Ligjit për procedurën penale nga viti 2004 është kryer harmonizimi me aktet juridike evropiane dhe konventat e tjera ndërkombëtare si dhe me rekomandimet nga Raportet për RM (Konventa e OKB kundër krimit të organizuar transnacional; Konventa evropiane për të drejtat e njeriut; Konventa për larjen e parave, zbulimin, ndalimin dhe konfiskimin e përfitimit pronësor e fituar me vepër penale; Konventa për ndëshkimin e korrupsionit; Konventa për krimin kompjuterik; Konventa evropiane për transferimin e personave të dënuar me protokollin, Rekomandimet e GRECO (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit); Rekomandimet e Komitetit Evropian për preventimin nga tortura dhe trajtimin johuman de ç'njerezor.

me amendamentet e Kushtetutes nga viti 2001 është instaluar si një nga vlerat themelore të regullimit kushtetues.¹⁷ Për arsye të përfshirjes së dispozitave për përfaqësim të drejtë dhe adekuat të qytetarëve që u përkasin të gjitha bashkësive u ndryshuan dhe u sollën ligje të caktuara, me qëllim që të arrihet përfaqësim adekuat i bashkësive.¹⁸ Edhe përkundër kësaj përfaqësimi i drejtë dhe adekuat nuk është në nivelin e duhur. Progres i caktuar është bërë në disa dikastere, ku numër i caktuar i zyrtarëve të rinj janë punësuar në shërbimet shtetërore. Edhe përkundër ndryshimeve Kushtetuese, kemi një disbalans në mes përcaktimit dhe implementimit të këtyre ndryshimeve Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë. Marrëveshja e Ohrit është një modus i mirë për ndërtim të një shoqërie stabile, por sfidë paraqet zhagjitja e implementimit të këtij akti kurse rrezik më i madh, mbetja e tij vetëm shkronja të hudhura në letër.

3. Në vend të përfundimit

Problemi në Republikën e Maqedonisë nuk qëndron në pranimin juridik të të drejtave të njeriut, por në zbatimin e tyre të përditshëm. Vënia e sundimit të së drejtës është njëra nga detyrat më të ndjeshme dhe të rënda në procesin e sendërtimit të konceptit të të drejtave të njeriut në vendet postsocialiste. Qeveria bëri shumë pak në vendosjen e sundimit të së drejtës në Republikën e Maqedonisë, si një pjesë shumë e rëndësishme e të drejtave të njeriut. As edhe sundimi i së drejtës në kuptimin e vet më të ngushtë joformal asnjëherë nuk ka ekzistuar në Republikën e Maqedonisë.¹⁹ Vlerat më të larta dhe mundësitë juridike nuk u rrespektuan nga ana e pushtetit shtetëror. Principi i sigurisë juridike dhe përgjegjësisë së funksionarëve shtetëror nuk ka asnjë kuptim në jetën politike dhe juridike të Maqedonisë. Krimi i organizuar

¹⁷ Amendamenti nr.VI i Kushtetutës së R. Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM nr.91 nga 20.11.2001).

¹⁸ Për shembull janë miratuar dhe ndryshuar: Ligji për nëpunësit shtetëror; Ligji për avokatin e popullit; Ligji për marrëdhënie pune; Ligji për ndërrmarjet publike; Ligji për prokurorinë publike; Ligji për gjykatat, etj.

¹⁹ Për kushtëzimi reciprok të ndërtimit të konceptit të të drejtave të njeriut nga njëra anë dhe shtetin e së drejtës nga ana tjetër, shih në pjesën e kriteriumeve politike në Raportin e Komisionit Evropian COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES, Brussels, 06.11.2007, SEC (2007) 1432, COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT The former Yugoslav Republic of Macedonia 2007 Progress Report, fq. 6-16.

dhe korrupcioni ishin dhe mbeten në skenën e jetës politike. Për shkak të gjithë kësaj, mund në konkludojmë se në Republikën e Maqedonisë duhet edhe shumë veprime për tu vendosur rrespektimi i plote i të drejtave të njeriut, siç janë të parashikuara në vendet demokratike. Republika e Maqedonisë së pari duhet të krijojë vetëdije për të drejtat e njeriut dhe një opinion publik të fortë i cili do t'i përmbajë vlerat e së drejtës dhe sundimit të së drejtës, ndërsa pastaj duhet t'i përmisojë teknikat për avansimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu sendërtimi i kulturës politike participuese dhe kulturës së të drejtave të njeriut, është shumë e rëndësishme, ndër më të rëndësishmet për pranimin e konceptit demokratik për të drejtat e njeriut në sistemin politiko-kushtetues të Republikës së Maqedonisë. Të drejtat e njeriut nuk mund të opservohen vetvetiu jashtë kontekstit politiko-social, por edhe si një anë e procesit për vendosjen e lirisë njerëzore. Ana e dytë e atij procesi është demokratizimi i Republikës së Maqedonisë. Demokracia dhe të drejtat e njeriut janë aksiome të lidhura ngushtë njëra me tjetrën. Realisht ato janë dy fytyra të një pyetjeje. Nuk mund të flitet për demokraci nëse nuk ekzistojnë të drejtat e njeriut, sikurse nuk mund të ketë demokraci pa rrespektimin e të drejtave të njeriut. Ekzistimi i sistemit politik demokratik si dhe institucioneve të saj në mes tjerash bazohet edhe në arritjen e mbrojtjes juridike e cila përgjigjet dhe jep siguri për të drejtat themelore të njeriut. Në atë mënyrë vërtetimi politiko-juridik i të drejtave të njeriut paraqitet si gjenerator në gjithë shtetin, i cili tenton të jetë demokratik. Pyetja bazike e demokracisë është promovimi dhe rrespektimi i të drejtave të njeriut, e cila drejtpërsëdrejti është e lidhur me parimet demokratike të shoqërisë demokratike, ndërsa ajo mbaron edhe në shoqërinë civile. Krijimi i shoqërisë civile, dhe moduleve të ndryshme në të cilën qytetarët mblidhen, organizohen dhe veprojnë jashtë kornizave shtetërore, është padyshim edhe pjesa më e rëndë e këtij ndryshimi global. Pjesëmarrja e vogël e qytetarëve në punët publike është pasojë e kuptimit të dobët të shoqërisë civile dhe mosbesimi i tyre në elementët e ndryshëm të organizimit të shoqërisë. Për atë njerëzit duhet t'i edukojmë që të mund të shërbejnë me të drejtat e tyre, nga arsimimi parashkollor, fillor, i mesëm e deri tek arsimimi i lartë.

ANALIZA KRAHASIMORE E KRITERIUMEVE EKONOMIKE PER ANETARËSIM TË R.MAQEDONISE NË BE

(Sipas Raporteve për përparim të RM nga Komisioni Evropian për vitin 2007/2008)

Abstrakt

Vendet e Ballkanit perëndimor e ndajnë gati fatin e njëjtë për anëtarësim në Bashkësinë Evropiane. Intenca kryesore e këtyre vendeve është integrimi në BE. E ardhmja e tyre do të ishte e zbehtë jashtë kësaj zone.

Republika e Maqedonisë i ndanë të gjitha avantazhet dhe obligimet që dalin pas nënshkrimit të Marrëveshjes së stabilizim asocimit dhe Agjendës së Selanikut nga viti 2003 që njëherit paraqet kornizën e politikës së BE për Ballkanin perëndimor. Bashkimi Evropian vazhdon të zbaton kriteriume të ashpra drejt vendeve kandidat duke zbatuar kushtëzime të ashpra të përparimit të vendit në aspekt ekonomik dhe politik.

Duke u nisur nga kjo që u tha më lartë del motivimi i shkuarjes së këtij punimi. Tema qendrore e punimit është një analizë krahasimore e kriteriumeve ekonomike të nevojshme për anëtarësim të RM në BE. Analizën krahasimore do të realizoj duke patur për bazë Raportet për përparim të RM të krijuara nga Komisioni Evropian. Republika e Maqedonia ka treguar përcaktim të theksuar në drejtim të përmbushjes së kushteve për të arritur statusin e plotë të vendit anëtar në BE.

Pasqyra e qartë e funksionimit të një vendi shihet nga funksionimi i sistemit ekonomik dhe atij politik si nënsisteme të një sistemi të përbashkët. Këto dy nënsisteme duhet të jenë në nivel të përkrahjes dhe përplotësimit të njëri-tjetrit e jo të paraqesin pengesë në zhvillimin e tyre dhe të sistemit në tërësi (siç ndodh shpesh në vendet në tranzicion).

¹ Asistent pranë Fakultetit të Biznes Administratës në UEJL-Tetovë

² Asistent pranë Fakultetit të Biznes Administratës në UEJL-Tetovë

Në qendër të punimit do të jenë analizat e faktorëve ekonomik për ekzistimin e ekonomisë funksionale të tregut dhe kapaciteti për ballafaqim me presionet konkurruese të tregjeve në BE.

Në fund do të përçjellen konkluzionet në lidhje me përparimet apo ngecjet e ekonomisë së Maqedonisë konform kushteve dhe kriterëve të kërkuara nga Bashkësia Evropiane.

RRUGËTIMI I R. MAQEDONISË DREJTË EVROPËS

Rrugëtimin i Republikës së Maqedonisë nëpër vite drejt fitimit të statusit vend kandidat për në BE ka një rrjedhë të këtillë të aktiviteteve edhe atë:

- **Prill, 2001 Marrëveshja e Stabilizim Asocimit me BE,**
- **1 Qershor, 2001 Marrëveshja e përkohshme tregtare**
- **Mars, 2004 Përcjellja e aplikacionit për anëtarësim në BE**
- **1 Tetor, 2004 Marrja e pyetësorit nga BE**
- **Nëntor, 2005 Mendimi pozitiv nga Komisioni Evropian për kandidimin e RM**
- **17 Dhjetor 2005 RM ka fituar statusin e vendit kandidat për në BE**

1. PËRMBUSHJA E KRITEREVE EKONOMIKE TË MASTRIHTIT KRITERIUMET PËR KONVERGJENCË TË MASTRIHTIT

Kriteriumet e konvergjencës të njohur si kriteriumet e Mاستrihtit të cilat vendet kandidate do të duhet ti plotësojnë që të fitojnë statusin e plotë në BE janë:


1. **Stabiliteti i çmimeve:** Norma e inflacionit (e matur sipas CPI) nuk duhet të tejkalojë 1,5% nga mesatarja e tre normave më të ultë të inflacionit të vendeve anëtare,
2. **Normat e kamatave:** Norma mesatare afatgjate e kamatës nuk duhet të tejkalojë 2% e normave mesatare të kamatës në tre ekonomitë e vendeve anëtare me inflacion më të ulët,
3. **Stabiliteti i kursit të këmbimit:** Vendet anëtare duhet të respektojnë kornizat normale të fluktuimit të kursit në kuadër të BE, pa tensionime të veçanta (devalvime) së paku në dy vitet e fundit,

4. **Pozicion fiskal të qëndrueshëm:** Deficitet e larta nuk janë të lejuara, duhet të respektohen kufizimet e mëposhtme:
- Deficiti buxhetor qeveritar nuk duhet të jetë më i lartë se 3% nga PBB,
 - Borxhi qeveritar nuk duhet të tejkalon 60% e PBB-së

STABILITETI I ÇMIMEVE

Republika e Maqedonisë me sukses ka menaxhuar me politikat makroekonomike dhe ka arritur të siguron stabilitet të çmimeve në vend, si një parakusht për një ekonomi stabile (*Shiko tabelën 1 dhe 2*). Nga pavarësimi e gjer më vitin 2004 norma e inflacionit ka trend rënës nga 5,8% (viti 2000) gjer në -0,4% (deflacion më vitin 2004). Nga viti 2004 e gjer më sot ku ballafaqohemi me një krizë mbarë botërore, norma e inflacionit ka patur një trend rritës edhe atë nga 0,5% (2005) gjer më 6,0% (2008). Për periudhën e ardhshme parashikohet një stabilizim të normës së inflacionit edhe atë gjer më 2,8% (2010)³. Nëse kriza ekonomike mbarë Botërore do të godas më thellësisht ekonominë e vendit tonë, do të jetë vështirë të rruhet kjo normë e parashikuar e inflacionit! (*Shiko grafikonin 1*)

Grafikoni 1: Norma e inflacionit në RM nga viti 2000-2010




³ Bogoev, J., Bojceva, T. S., Egert, B. and Petrovska M. (2007), "Real exchange rate dynamics in Macedonia: Old wisdoms and new insights, The Open-Access, Open-Assesment E-Journal, Vol. 2, 2008-12

NORMAT E KAMATAVE

Në pamundësi të arritjes gjer te të dhënat relevante për normat kamatore të konvergencës nga ana e institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare për Maqedoninë (të pa konfirmuara), këtë çështje do ta elaborojmë nga këndvështrimi i normave kamatore aktive, pasive dhe margjinës kamatore të sektorit bankier. Vlen të theksohet se nga viti 2000 e gjer më vitin 2007 normat kamatore kanë patur një trend rënës që është mjaft pozitive për impaktin në sektorin real. Shqetësimi në këtë drejtim vjen nga shkalla e lartë e margjinës kamatore që e bën sektorin bankier në R. e Maqedonisë sektor më profitabil. Në vitin 2000 korrelacion në mes të normave ka qenë 18,9% kamata aktive, 11,2% kapata pasive dhe një margjinë mjaft e lartë amatore rreth 7,7% (*Margjinë kjo gati ekuivalente me normën kamatore aktive të bankave në Evropën perëndimore*). Në vitin 2007 ky korrelacion është ngushtuar dhe margjina kamatore ka arritur gjer më 5,3% (10,2% kamata aktive-4,9% kamata pasive). Për shkaqe të krizës globale në vitet e ardhshme pritet të kemi një politikë monetare më të shtërnguar në këtë drejtim. Këtë konstatim e dëshmon fakti i rritjes së normës së interesit të bonave të thesarit nga ana e BPM fillimi i vitit 2009. (Shiko grafikonin 2)


Grafikoni 2: Norma e kamatave aktive, pasive dhe margjina kamatore në RM nga viti 2000-2010



STABILITETI I KURSIT TË KËMBIMIT

Republika e Maqedonisë me Euro Zonën realizon rreth 60% të eksportit dhe 47% të importit që e bën të detyrueshme valutën vendore denarin të jetë në pozicion të lidhur me Euron. Pariteti valutor në mes të Euros dhe Denarit të jetë stabil nga viti 2000 gjer më 2008 edhe atë 1 euro = 61.2 denar ($\pm 0,5$) dhe parashihet të ngel kështu edhe në vitet e ardhshme. Në anën tjetër nga mëvetësimi i RM pariteti valutor në mes të Dollarit dhe Denarit ka qenë në rritje ku në vitin 2001 arrinë maksimumin 1 dollar = 68,042 denar, ndërsa nga viti 2002 e gjer më sot ky kurs ka patur trend rrënës edhe atë 1 dollar = 44,71 denar (2008). (Shiko grafikunin 3)

Grafikoni 3: Kursi i këmbimit në RM nga viti 200-2010




STABILITETI FISKAL


Analizuar politikën fiskale në aspekt të të hyrave dhe të dalave buxhetore mund të konstatojmë se R. e Maqedonisë nga viti 2000 gjer më 2007 ka arritur të menaxhoj me sukses suficitin/deficitin dhe borxhin publik. Ekonomia e vendit në vitin 2000 ka regjistruar suficit në buxhet edhe atë rreth 2,5% të GDP-së ndërsa në vitet e ardhshme pas konfliktit të armatosur në 2001 në buxhet është paraqitur një deficit rreth 6,35% që do të pason mandaj me 5,56%. Në vitet e ardhshme e gjer më sot deficitin buxhetor është sjellur në norma shumë të ulta $\pm 0,65\%$ të GDP-së.

Me plotë të drjtë mund të konstatojmë se pushteti fiskal gjatë periudhës 2000-2007 ka arritur të redukton borxhin publik për rreth 38% edhe atë nga 57,1% (2000) në 35,20% (2007). Nëse analizojmë strukturën e borxhit publik vijmë në konstatim se gjatë kësaj periudhe se borxhi i jashtëm i paraprinë borxhit të brendshëm. Borxhi i brendshëm pasqyron trend rritës edhe atë nga 2,92% të GDP-së (2000) gjer në 17,4% (2008) ndërsa borxhi i jashtëm ka një trend rënës nga 33,12% (2000) në 31,25% të GDP-së (2008) (Shiko grafikonin 4 dhe 5, tabela 1 dhe 2).

Grafikoni 4: Suficiti/deficiti & Borxhi publik në RM nga viti 2000-2007



Grafikoni 5: Borxhi publik i brendshëm & jashtëm në RM nga viti 2000-2007



Indikatorët makroekonomik për RM nga viti 2000-2010

Tabela 1: Indikatorët makroekonomik për RM nga 2000-2005						
	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Popullata (mil)	2.026	2.017	2.020	2.027	2.032	2.037
Papunësia (%)	32.20	30.50	31.90	36.70	37.20	37.30
GDP (nom) mil. Euro	3893	3893	4001	4105	4325	4676
Norma e rrit.GDP-%	4.50	-4.50	0.90	2.80	4.10	4.10
Inflacioni	5.80	5.50	1.80	1.20	-0.40	0.50
Bilanci tregtar (mil\$)	-691	-527	-806	-851	-1139	-1063
Kursi devizor den/ €	60.725	60.913	60.978	61.264	61.337	61.295
Kursi devizor den/\$	65.885	68.042	64.734	54.303	49.410	49.292
Të hyrat buxhetore(miln den)	86,583	80,503	86,254	84,167	88,176	100,877
Të hyrat % e GDP	36.63%	34.43%	35.35%	33.47%	33.24%	35.19%
Të dalat buxhetore	80,678	95,349	99,808	86,760	88,169	100,219
Të dalat % e GDP	34.13%	40.78%	40.91%	34.50%	33.24%	34.97%
Suficit/Deficit (% eGDP)	2.50%	-6.35%	-5.56%	-1.03%	0.00%	0.23%
Borxhi publik i brendshëm	113.62	482.56	506.38	479.53	441.44	750.39
BPB (%GDP)	2.92	12.40	12.66	11.68	10.21	16.05
Borxhi publik i jashtëm	1289.5	1,613.00	1,643.35	1,568.89	1,576.46	1441.16
BPJ (%GDP)	33.12	41.43	41.07	38.22	36.45	30.82
Borxhi publik (GFS metoda) (si pjesë e GDP-së)	57.10%	55.50%	48.60%	44.90%	42.60%	46.90%
Burimi: FMN, M.Financave RM (Vjetori financiar 2000-2007 Ministria e financave)						

Tabela 2: Indikatorët makroekonomik për RM nga 2006-2010					
	2006	2007	2008	2009	2010
Popullata (miln)	2.043	2.047	2.051	2.055	2.059
Papunësia (%)	36.00	34.90	33.00	31.50	30.00
GDP (nom) miln. Euro	5059	5545	6230	6834	7482
Norma e rrit.GDP-%	4.00	5.10	6.00	6.50	6.50
Inflacioni	3.20	2.30	6.00	3.00	2.80
Bilanci tregtar (miln\$)	-1285	-1627	-2122	-2262	-2426
Kursi devizor den/€	61.188	61.183	61.183	61.183	61.183
Kursi devizor den/\$	48.785	44.718	44.718	44.718	44.718
Të hyrat buxhetore(miln den)	104,044	119,609	128,740	138,210	146,975
Të hyrat % e GDP	33.61%	35.26%	33.77%	33.05%	32.11%
Të dalat buxhetore	105,744	117,441	134,280	144,074	153,488
Të dalat % e GDP	34.16%	34.62%	35.23%	34.46%	33.53%
Suficit/Deficit (% e GDP)	-0.55%	0.64%	-1.45%	-1.40%	-1.42%
Borxhi publik i brendshëm	806.48	899.95	1,061.52	-	-
BPB (%GDP)	15.94	16.23	17.04	-	-
Borxhi publik i jashtëm	1223.01	1027.86	1,947.15	-	-
BPJ (%GDP)	24.17	18.54	31.25	-	-
Borxhi publik (GFS metoda) (si pjesë e GDP-së)	40.40%	35.20%	48.29%	-	-
Burimi: FMN, M.Financave RM (Vjetori financiar 2000-2007 Ministria e financave)					

2. PËRMBUSHJA E KRITEREVE EKONOMIKE TË KOPENHAGËS (Bazuar në raportin e përparimit të RM nga Komisioni Evropian për vitin 2008)

Komisioni Evropian nga marsi i vitit 2002 dorëzon rregullisht raport gjer te Këshilli dhe Parlamenti Evropian për përparimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky raport përfshinë periudhën nga 1 tetori i vitit 2007 gjer në fillim të tetorit të vitit 2008.

Në vazhdim do të analizojmë kriteriumet ekonomike konform raportit edhe atë:

a.) Ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut

- Bazat e politikës ekonomike
- Stabiliteti makroekonomik
- Veprimi i lirë i forcave të tregut
- Hyrje dhe dalje e lirë në treg
- Sistemi adekuat juridik
- Niveli zhvillimor i mjaftueshëm i sektorit financiar

b.) Kapaciteti për ballafaqim me presionet konkurruese të tregjeve

- Ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut
- Kapital i mjaftueshëm human dhe fizik
- Struktura adekuate sektoriale dhe e kompanive
- Ndikimi i shtetit mbi konkurrencën
- Integrimi tregtar me BE

a.) EKZISTIMI FUNKSIONAL I EKONOMISË SE TREGUT

Funksionalitetin e ekonomisë së tregut në R. e Maqedonisë do ta prezantojmë duke shprehur karakteristikat përkatëse të: *Bazës politike të ekonomisë, Stabilitetin makroekonomik, Veprimin e lirë të forcave të tregut, Hyrjen dhe daljen e lirë nga tregu, Sistemin adekuat juridik, Zhvillimin e sektorit financiar* konform raportit të Komisionit Evropian për vitin 2008.

Bazat e politikës ekonomike

- ✓ Në shtator të vitit 2008 qeveria proklamoi ndërprerjen (e përkohshme) e aranzhmaneve me FMN, përkundër faktit se FMN paraqet kornizën themelore e krijimit të politikave ekonomike të vendeve anëtare të FMN-së.
- ✓ Ngadalësim – ngecje në zbatimin e reformave para dhe pas zgjedhjeve.

Stabiliteti makroekonomik

Stabiliteti makroekonomik është një parakusht me shumë rëndësi për realizimin e një rrite të qëndrueshme ekonomike (*FMN 2001*),


Stabiliteti makroekonomik definohet nga ekspertët e Bankës Botërore se është arritur në ato raste kur inflacioni është nën kontroll, kur borxhi i brendshëm dhe i jashtëm menaxhohen me sukses dhe kur krizat e paraqitura makroekonomike tejkalohen në kuadër të një ose dy viteve (*IBRD 1993*),

Kuptimi më i gjerë teorik i stabilitetit makroekonomik nënkupton jo vetëm realizimin e normave të ulëta të inflacionit dhe të deficitit buxhetor por edhe nivele të kënaqshme të rritës ekonomike dhe norma të ulëta të papunësisë (*Fiti 2004, Shkup*),

Në vazhdim do të prezantojmë karakteristikat ekokonomike të ekonomisë së vendit për 3 vitet e fundit (*shiko tabelën 1 dhe 2*):


- Rritja e prodhimtarisë nga 4%-5%-6% nga viti 2006- 2007-2008;
- Investimet dhe konsumi individual janë faktorët kryesor të rritjes së prodhimtarisë;
- Prodhimtaria industriale ka prezantuar rritje mesatare për 10% në 8-muajt e 2008 në krahasim me periudhën e njëjtë në 2007;
- Rritja e eksportit ngadalësohet ndërsa importi vazhdon trendin rritës;

Grafikoni 6: Eksporti, Importi dhe deficitit tregtar në RM nga viti 2000-20010 (milion \$)



- Deficit në llogarinë rrjedhëse ka trend rritës, në mesin e 2008 deficitin arrin gati 13% nga GDP, kjo si rezultat i rritjes së kërkesës së përgjithshme dhe rritjes së çmimeve të energjisë nga kërkesa vendore;
- Rezervat oficiale devizore arritën në vlerë absolute prej 1,6 miliard dollar të cilat mbulojnë importin për 3-muaj;
- Bruto borxhi publik i përgjithshëm në vitin 2008 do të paraqet një rritje prej afër 6% q pasqyron mbi 50% të GDP, ndërsa krahasuar me 2007 paraqite 44%;
- Gjendja e tregut të punës ka një përmirësim të vogël ndërsa papunësia efekturon një rënie marginale të papunësisë në 33,8% në 2008;
- Ekzistimi i një sektori informal në një shkallë të lartë që ndoshta do të kishte reduktuar këtë shkallë të lartë të papunësisë;
- Rritja e shkallës së kreditave të dhëna nga sektori bankar kah sektori real për afër 40%;
- Norma e inflacionit nga 6,1% (dhjetor 2007) gjer në 9% (mars 2008), 7,1% (në shtator 2008);
- Deficiti buxhetor nga 2% në 2007 deri në 4,25% me rebalancin e qershorit 2008

Grafikoni 7: Norma e rritjes së GDP, papunësisë dhe inflacionit në RM për periudhën 2000-2010



Veprimi i lirë i forcave të tregut

- Procesi i privatizimit gati është kryer,
- Pjesëmarrja e sektorit privat në prodhimtarinë e përgjithshme arrin 80%
- Kapitali shtetëror arrin 13% të GDP, 5 ndërmarrje publike shërbyese rreth 12% të GDP
- Në përgjithësi sundon veprimi i lirë i forcave të tregut.

Hyrje dhe dalje e lirë nga tregu

Qeveria e Maqedonisë ka ndërmarr hapa të rëndësishëm në drejtim të krijimit të kushteve të volitshme të klimës së biznesit⁴.

- ✓ Instalimi i sistemit të një sportelit më 2007 duke zvogëluar afatin e regjistrimit të SHT nga 3 ditë në muaj në 26 orë dhe në fillim të vitit 2008 u zhvillua në 4 orë.
- ✓ Procedurat e falimentimit janë zvogëluar dhe përsheptuar por ende nuk janë në nivelin e duhur.

⁴ Doing Business 2009, World Bank

Nëse do të analizonim biznes klimën e Maqedonisë duke e krahasuar atë me ekonomitë e regjionit (*sipas raportit të Doing Business*) mund të konstatojmë se ka avantazh krahasimor me to. Ajo është e ranguar më mirë se vendet e analizuara përveç Bullgarisë⁵ (*Shikoni tabelën 3-Të bësh biznes*). Nëse do të analizonim shkallën e korupcionit në vend sipas Corruption Perceptions Index 2008 me plotë të drejtë mund të konstatojmë se kemi një përmirësim të dukshëm por jo të mjaftueshëm. Krahasuar me vendet e regjionit RM në vitin 2009 ka disavantazh vetëm nga Kroacia (HR) dhe nivel të njëjtë me vendin anëtarë të BE-Bullgarinë, ndërsa me vendet tjera të krahasuara ka avantazh të theksuar. (*Shikoni tabelën 3-Korupcioni*)

Tabela 3: Të bësh biznes & Korupcioni në RM

Ekonomia (Rang)	Të bësh biznes				Korupcioni			
	2008	2007	2006	2005	2008	2007	2006	2005
ALB	86	135	120	115	85	105	111	126
BH	119	117	95	91	92	84	93	88
BUL	45	44	54	59	72	64	57	55
HR	106	107	124	134	62	64	69	70
MKD	71	79	92	94	72	84	105	103
MZ	90	84	70	64	85	84	90	97
SR	94	91	68	95	85	79	90	97

Sistemi adekuat juridik

- Qeveria tenton të zvogëlon periudhat kohore në realizimin e procedurave gjyqësore,
- Konstatatimi gjeneral është se procedurat gjyqësore vazhdojnë të jenë të ngadalshme dhe paraqesin pengesë në funksionimin e mekanizmit të lirë të tregut.


⁵ Corruption Perceptions Index 2008

- Vështirësi në procedurat e pronësimit të pronës-kadastrit.
- Vështirësi në procedurat gjyqësore në drejtim të realizimi të kontratave ndërmjet kontraktorëve,
- Përparim i ngadalshëm në drejtim të rrënjosjes së korrupsionit,

Zhvillimi i sektorit financiar


- Depozitat e sektorit privat jofinanciar tregojnë rritje dhe arrijnë rreth 47% nga GDP (viti 2007) në krahasim me 41% në vitin 2006.

Grafikoni 8: Depozitat në sektorin banka në RM për periudhën 2006, 2007



- Rritja e depozitave ka mundësuar rritjen e përqindjes së kreditimit të sektorit privat nga ana e bankave komerciale edhe atë nga 26% në 2006 gjer në 37% nga GDP në 2007.
- Banka qendrore në mënyrë rregullative veproi duke rritur normën e rezervave të detyrueshme për 1%.
- Sistemi bankar stabël me rreth 18 banka dhe 12 kursimore
- Margjina kamatore ka tendencë rrenëse nga 4,6 në 2007 në 4,0 2008 (shtator)
- Rritet shkalla e rentabilitetit të sektorit bankar, nga 12,3% mesatarja e kthimit të kapitalit për 2006 në 15,2% në 2007.
- Sektori financiar vazhdon trendin pozitiv të zhvillimit (përforcimin e standardeve rregullatorë dhe supervisor) edhe pse ai është relativisht i vogël

Grafikoni 9: Rezervat devizore në \$/€ në RM për periudhën 2000-2007



b.) KAPACITETI PËR BALLAFAQIM ME PRESIONET KONKURUESE TË TREGJEVE

Analizimi i kapacitetit të ekonomisë së vendit kundrejt presioneve konkurruese të tregjeve të BE do të realizohet duke përcjellur karakteristikat e veçanta për: *Ekzistimin e ekonomisë funksional të tregut, Kapitalin e mjaftueshëm fizik dhe njerëzor, Strukturën sektoriale dhe strukturën e kompanive, Ndikimin e shtetit mbi konkurrencën, Integrimin tregtar në BE.*

Ekzistimi i ekonomisë funksional të tregut

- Stabiliteti makroekonomik në gjeneral është i arritur, por tendenca e rritjes së inflacionit dhe jo ekuilibri tregtar i theksuar,
- Përparim në drejtim të zvogëlimit të barrierave për hyrje dhe dalje nga tregu,
- Përmirësim të ambientit afarist por me defekte të theksuara në sundimin e drejtësisë, prolongimi dhe mos realizimi efikas dhe efektiv i procedurave gjyqësore, që mundëson diskriminim të pjesëtarëve në treg.

Kapitali i mjaftueshëm fizik dhe njerëzor

- Orientim i politikës qeveritare për një rini të arsimuar dhe të kualifikuar profesionalisht (arsimim i mesëm i obliguar)
- Mjetet buxhetore për arsim nga 5% të GDP për 2007 zhvendosen në rreth 6% në 2008.
- Papunësia është shumë e lartë dhe me karakter më shumë strukturor. (tregu jo i ekuilibruar në mes të ofertës dhe kërkesës për punë).
- Struktura e fuqisë punëtore vazhdon të jetë në një shkallë të ulët arsimore dhe kualifikuese,

Struktura sektoriale dhe struktura e kompanive

- Trend i përgjithshëm kah rritja e shërbimeve tregtare dhe prodhuese në drejtim të krijimit të outputit, kundrejt rënies së pjesëmarrjes së sektorit bujqësor,
- Ndërtimtaria dhe biznesi me patundshmëri udhëheq me numër më të madh të subjekteve, ndërsa prodhimtaria ka rënie,
- Rritja e konkurrencës në sektorin e telekomunikacionit dhe të transportit që dukshëm përmirësoi cilësinë e shërbimeve dhe produkteve,
- Rritet numri i ndërmarrjeve të reja për rreth 6%,
- Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme zënë një vend të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Ato krijojnë rreth 54,5% të GDP dhe afro 78,5% të të punësuarve (për vitin 2006),
- Niveli i lartë i ekonomisë informate, kundrejt luftës së hapur të qeverisë në uljen e saj.

Ndikimi i shtetit mbi konkurrencën

- Ndikimi i shtetit në konkurrencë është i kufizuar,
- Qeveria ka një ndikim të theksuar direkt apo indirekt në sektorin e energjetikës,
- Sjellja e ligjeve që rregullojnë veprimet afariste në procedura të përshpejtuar apo ad hok paraqesin çrregullim të të priturve dhe rritjen e rizikun të subjekteve ekonomike.

Integrimi tregtar në BE

- Maqedonia ka një ekonomi të vogël por të hapur me tregjet e jashtme⁶
- Integrimi tregtar me BE është rreth 60% e eksportit të vendit dhe rreth 47% e importit,
- Ballkani përëndimor paraqet destinacionin e dytë më të rëndësishëm për Maqedoninë pasi që realizon rreth 34% të eksportit dhe 11% të importit.
- Struktura e eksportit me BE është: rreth 24% prodhime tekstili dhe veshmbathje dhe 26% prodhime të hekurit dhe xingut.

KONKLuzionET**Traktati i Mastrihitit për integrim në BE**

- Maqedonia duhet të përkrah rriten ekonomike dhe të zvogëloj vakumin i cili ekziston me gjendjen reale që e kërkojnë standardet e të qenurit anëtar në BE.
- Maqedonia duhet të rris fuqinë ekonomike në tregjet ndërkombëtare.
- Të arrijë rritjen ekonomike në përputhshmëri me standardet ekologjike, sociale dhe etnike.
- Maqedonia duhet të mbështes integrimin stabil dhe efektiv të Republikës së Maqedonisë në BE.
- Maqedonia në periudhën e deritashme transitore në veçanti pas nënshkrimit të MSA ka evidentuar të arritura të theksuara në plotësimin e kriterëve të Mastrihit.
- Nga pesë kriteret e përcaktuara tre tashmë janë të përmbushura me sukses me përjashtim të normës së kamatave afatgjata të konvergencës dhe pjesërisht me kursin e këmbimit.

⁶ Gutierrez, E. (2006), "Export Performance and External Competitiveness in the Former Yugoslav Republic of Macedonia", IMF Working Paper No. 261

Traktati i Kopenhagës për integrim në BE

- Maqedonia ka evidentuar rezultate të pjesërishme në plotësimin e kriterëve të Kopenhagës;
- Maqedonia ka arritur të siguroj stabilitet makroekonomik;
- Maqedonia ka arritur të përmirësojë pozitën në drejtim të arkëtimit të tatimeve;
- Në Maqedoni janë evidentuar ngecje në ndërtimin e ekonomisë funksionale të tregut;
- Zhvillim i theksuar i sektorit bankar ndërsa një shkallë e pamjaftueshme e zhvillimit të sektorëve tjerë;
- Shkallë e ulët e funksionimit të sistemit juridik në drejtim të funksionimit të ekonomisë së lirë të tregut;
- Maqedonia evidentohet si shtet me shkallë të lartë të ekonomisë informale;

Integrimi i Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian

Hyrje

Anëtarësimi i Maqedonisë së bashku me shtetet tjera Ballkanike² në Unionin Evropian është një temë interesante, e ndryshueshme dhe e rëndësishme si për vendet që aspirojnë të jenë pjesë e saj ashtu edhe për vet UE-në.

Në samitin e Kopenhagës që u mbajt më 12-13 Dhjetor 2002 u diskutua rreth politikës së zgjerimit të anëtarëve të Unionit Evropian dhe u vendos që Maqedonia dhe shtetet tjera Ballkanike të pranohen si partnerë të saj që janë në procesin e Stabilitetit dhe të Partneritetit. Në samitin e Unionit Evropian në Kopenhagë qartë u theksua se „nëse Maqedonia dhe shtetet Ballkanike i plotësojnë kushtet e Kopenhagës një ditë do të mund të jenë anëtarë të Unionit Evropian”.

Vendimi i marrë në Kopenhagë ishte etapa më e rëndësishme për Maqedoninë dhe shtetet tjera Ballkanike në periudhën prej kurë ato janë partnerë në procesin e Stabilitetit dhe të Partneritetit me Unionin Evropian. Në këtë etapë, me samitin e Kopenhagës dhe me fjalët që u thanë pas tij qartë shihet se ky vendim kishte vizione të qarta për ardhmërinë e Evropës. Përveç kësaj, aktivitetet që filloi Konvencioni për ardhmërinë e Evropës më 28 Shkurt 2002, me seriozitet i vazhdon aktivitet e veta që qartë do të ndikojnë në ardhmërinë e shteteve Ballkanike.

Vendimet e marra në samitin e Kopenhagës dhe vendimet që u morën në samitin e Selanikut kanë rëndësi jetike për Maqedoninë dhe shtetet tjera Ballkanike për integrim në Unionin Evropian³.

¹ Asistent pranë Fakultetit Juridik, UEJL

² Shqipëria; Bosnia dhe Hercegovina; Kroacia; Serbia dhe Mali i Zi.

³ <http://www.edsh.org>

1. Proçesi i zgjerimit të Unionit Evropian dhe relacionet mes Maqedonisë dhe Unionit Evropian

Unioni Evropian është një organizatë që vazhdimisht i rritet numri i anëtarëve. Në vitin 1951 me themelimin Komunitetit për qymyr dhe çelikut, Komuniteti Evropian numëronte gjashtë anëtarë, ndërsa me zgjerimet e ardhshme numri i UE-së tani arrin 27 shtete-anëtare.⁴

Kështu më 1 Maj 2004, dhjetë shtete anëtarësohen në Unionin Evropian, duke përfshirë këtu shtetet e Evropës lindore, Malltën dhe Qipron. Parashtrohet pyetja vallë me këtë zgjerim a do të ngadalësohet proçesi i anëtarësimit të shteteve Ballkanike në U.E? A mund të pritët që pas rritjes së numrit të anëtarëve UE-ja për një kohë të ndal zgjerimin e saj?

UE-ja me aplikimin e marrëveshjes së Nicës prej 1 Shkurt 2003 i ka tejkaluar vështësitë që mund të paraqiten me zgjerimin e saj për dhjetë shtete. Pasi që me marrëveshjen e Nicës është marrë vendimi që të ndalohet vetoja nacionale, mundësoi që UE-ja të veprojë më me ndikim.

Është e domosdoshme që UE-ja të zgjerohet drejt shteteve Ballkanike dhe të kontribojë në zhvillimin e këtyre shteteve.

Shpresojmë që ky proçes nuk do të ndalet këtu, por do të vazhdojë duke i përfshirë edhe shtetet Ballkanike. Të gjitha shtetet Ballkanike duke përfshirë këtu edhe Maqedoninë pasi që t'i plotësojnë kushtet e parapara politike, dhe nëse i respektojnë të drejtat e qytetarëve, do të jenë në pritje të bisedimeve për anëtarësim. Sipas nenit 49 të Marrëveshjes së UE-së, cili do shtet Evropian që mbron lirinë, demokracinë, të drejtat e qytetarëve dhe liritë themelore të tyre dhe i mbron parimet ligjore do të mund të konkurojë për anëtarësim në UE.

Përparsitë nga anëtarësimi i Maqedonisë në UE do të jenë:

- Qytetarët e saj do të mund të jetojnë, të shëtisin dhe të punojnë në një hapësirë të gjerë që shtrihet prej detit Adriatik në detin Baltik dhe prej detit të Zi deri në oqeanin Atlantik;

- Prodhimet e Maqedonisë do të mund të ekspozohen në tregun më të madh botëror duke kaluar nëpër procedurat standarde;

- Me zgjerimin e UE-së drejt Ballkanit ofrohet mundësia për bashkimin e sërishëm të kontinentit Evropian.

Ajo që është me rëndësi të theksohet është fillimi i aktiviteteve të Konventës për Ardhmërinë e Evropës. Në samitin e UE-së që u mbajt në Laeken kah fundi i vitit 2001 u soll vendimi të sillet Konventa për

⁴ <http://www.ads.gov.mk>

Ardhmërinë e Evropës. Kjo konventë aktivitetet e veta i filloi më 28 Shkurt 2002 nën udhëheqjen e kryetarit të shtetit të Francës Valéry Giscard d'Estaing. U pregatit edhe kushtetuta e parë e Evropës dhe më 28 Tetor 2002 u paraqit për diskutim.

Nëse kushtetutën Evropiane që e paraqiti konventa e analizojmë në tërësi, do të kuptojmë se UE shkon në drejtim të një shteti federativ. Aktivitetet që i zhvillon Konventa përcaktojnë ardhmërinë e Evropës. Këto aktivitete duke përfshirë këtu edhe Maqedoninë të gjitha shtetet Evropiane ndiqen me një kujdes të veçantë. Edhe Maqedonia me një seriozitet punon në këtë drejtim të anëtarësimit në UE. Me iniciativën e ish-kryetarit Trajkovski, letra e përbashkët e 5 shteteve Ballkanike dërguar qeverisë së Danimarkës dhe vizitën që e bëri ish-kryetari Trajkovski, d'Estaing'ut e vërtetojnë se Maqedonia dëshiron që të jetë pjesë e një shoqërie të këtillë Evropiane dhe aktivitetet e saja i zhvillon në këtë drejtim.

Por, gjatë diskutimit rreth kushtetutës Evropiane, ardhmëria e Maqedonisë dhe shteteve Ballkanike në UE përveç faktorëve tjerë, do të varet nga modeli për të cilën do të përcaktohet UE-ja. Atë që e propozuan konvencioni Evropian, Gjermania dhe Komisioni Evropian që UE-ja të jetë një shtet federativ i përbërë prej anëtarëve federalë u refuzua nga disa shtete në krye të së cilëve qëndron Anglia, të cilët ishin të mendimit se shtetet e UE-së rrugën e vetë duhet ta vazhdojnë si shtete të pavarura. Pritet që në të ardhmen konvencioni Evropian ta paraqes modelin e ri për një Evropë me mekanizma të shumta.

2. Nënshkrimi i Marrëveshjes për Stabilizim Asocim me Maqedoninë

Pas një procesi të negociatave që zgjatën më shumë se dy vite u nënshkrua në Luksemburg Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim (MSA) në mes të UE-së dhe Republikës së Maqedonisë më 9 prill 2001 gjatë një ceremonie speciale në margjinat e Këshillit për Punë të Përgjithshme. Gjithashtu u nënshkrua edhe Marrëveshja e Përkohshme që mbulon çështjet e tregut. Kjo ishte një ngjarje me domethënie të madhe politike, simbolike, ekonomike dhe praktike që markon një hap të rëndësishëm në procesin e vendosjes së relacioneve më të afërta me shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Republika e Maqedonisë është vendi i parë me të cilin negociimet për një Marrëveshje për Stabilizim Asocim kanë përfunduar suksesshëm

dhe Marrëveshja është nënshkruar edhe në mënyrë formale. Këshilli më 24 janar 2000 i miratoi direktivat negociuese të Komisionit në përputhshmëri me dispozitat e nenit 300 të Traktatit të Bashkësisë Evropiane. Pastaj negociatat u lancuan nga Komisioni në Shkup në 5 mars 2000 dhe duke ndjekur tre raunde të negociatave MSA u inicua në margjinat e Samitit të Zagrebit në 24 nëntor 2000.

Marrëveshja për Stabilizim Asocim me Republikën e Maqedonisë është e ndarë në sekcione dhe fokusohet në këto elemente kryesore:

- Themelimi i një asociacioni në mes të Komunitetit Evropian dhe shteteve të tij anëtare nga njëra anë dhe Republikën e Maqedonisë nga ana tjetër brenda një periudhe tranzicionale prej maksimum dhjetë viteve.

- Respektimi i paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar, zhvillimi i relacioneve të mira me fqinjë, parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, të drejtat e minoriteteve, parimet e të drejtës ndërkombëtare dhe qeverisja e së drejtës.

- Përfshirja e dialogut politik me Republikën e Maqedonisë;

- Dispozita për një bashkëpunim më të zgjeruar regjional, përfshirë perspektivën për themelimin e zonave të tregtisë së lirë në mes të shteteve të regjionit;

- Perspektiva për themelim të një zone të tregtisë së lirë në mes të Komunitetit dhe Republikës së Maqedonisë brenda dhjetë viteve pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes;

- Dispozita për lëvizjen e punëtorëve, liria e themelimit, furnizimi me shërbime, pagesat aktuale dhe lëvizja e kapitalit;

- Përkushtimi i Republikës së Maqedonisë për të përafruar legjislacionin e saj me atë të Komunitetit Evropian, sidomos në fushat kyçe të tregut të brendshëm;

- Dispozita për bashkëpunim me Republikën e Maqedonisë në një rang të gjerë fushash, përfshirë drejtësinë dhe punët e brendshme;

- Dispozita për themelimin e një Këshilli për Asocim dhe Stabilizim i cili do të mbikqyr implementimin e marrëveshjes, një Komiteti për Stabilizim dhe Asocim dhe të një Komiteti Parlamentar për Asocim dhe Stabilizim.

Rëndësia politike e Marrëveshjes është mjaft e lartë pasi që ajo i jep Republikës së Maqedonisë statusin e kandidatit potencial dhe kështu hap mundësinë për një pranim të ardhshëm në Unionin Evropian. Kjo është bërë eksplicite në Preambulë e cila e thërret “gadishmërinë e Unionit Evropian të integrojë Republikën e Maqedonisë në gjerësinë më të

tërësishme të mundshme në bashkësinë politike dhe ekonomike të Evropës dhe statusin e saj si kandidate potenciale për anëtarësim në UE në bazë të Traktatit të Unionit Evropian dhe përmbushjen e kriterit të definuar nga Këshilli Evropian në Samitin e Kopenhagës në qershor të vitit 1993, që është çështje e një implementimi të suksesshëm të kësaj Marrëveshjeje, sidomos lidhur me bashkëpunimin regjional”.⁵

Qëllimi përfundimtar i stabilitetit dhe integritetit rajonal si dhe i respektimit të të drejtave fundamentale dhe të minoriteteve konstituojnë një themel qendror të marrëveshjes dhe janë përfshirë në Preambullë si dhe në Parimet themelore të Traktatit.

3. Marrëveshja e Përkohshme

Në 9 prill në Luksemburg gjithashtu u nënshkrua edhe një Marrëveshje e Përkohshme në mes të Unionit Evropian dhe Maqedonisë i cili hyri në fuqi më 1 qershor 2001.

Me Marrëveshjen e Përkohshme palët lejojnë që çështjet e tregut nga MSA të hyjnë në fuqi në 1 qershor 2001 pa domosdoshmërinë që të pritët ratifikimi formal nga parlamentet nacionale të shteteve anëtarë të UE-së. Koncesioni më favorizues i tregut i grantuar Republikës së Maqedonisë nga Rregullorja e Këshillit 2007/2000 e ndryshuar nga Rregullorja e Këshillit (EC) 2563/2000 do të vazhdojë të aplikohet paralelisht me Marrëveshjen e Përkohshme. Marëdhëniet në transportin e brendshëm do të vazhdojnë të mbulohen nga Marrëveshja për Transport në mes të Unionit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë që është në fuqi që nga 28 nëntori 1997.

4. Hyrja në fuqi e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim

Marrëveshja për stabilizim dhe Asocim në mes të Unionit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë hyri në fuqi më 1 prill 2004, duke e sjellur kështu vendin një hap më afër në rrugën drejt integritimeve evropiane. Kjo është Marrëveshja e parë për Stabilizim dhe Asocim që hyn në fuqi. Tani Marrëveshja i lidh palët që të punojnë edhe mëtej në stabilizimin politik, ekonomik dhe institucional të vendit, ndërtimit institucional dhe reformave në administratë, bashkëpunim të zgjeruar tregtar dhe

⁵ <http://Evropa.eu/scadplus/leg/en/lvb/l14536.htm>

ekonomik, përafrim të legjisllacionit me *acquis-in* (kriterin juridik) e Unionit dhe një bashkëpunim më të përforcuar në drejtësi dhe punë të brendshme. Implementimi i tërësishëm i Marrëveshjes gjithashtu do të krijojë një klimë të re për zhvillimin e tregtisë dhe investimeve që janë faktorë krucial për ristrukturimin ekonomik dhe modernizimin e vendit.

Edhe pse e frenuar nga situata buxhetore dhe ekonomike, Republika e Maqedonisë ka bërë përpjekje për të çuar përpara procesin e Stabilizimit dhe Asocimit⁶. Në shumë fusha, procesi i reformave është ende në fillim dhe do ti duhen përpjekje të mëtejshme për tu konvertuar në ndryshime konkrete dhe të sjellë beneficinet që priten.

Situata politike ka mbetur në përgjithësi stabile, duke u ndërtuar nga procesi i inicuar në Ohër më 2001 i cili mbetet krucial për sigurimin e zhvillimit të Republikës së Maqedonisë si një shtet unitar dhe multietnik. Përkrahja e komunitetit ndërkombëtar, veçanërisht ajo e UE-së solli në operacionin “Concordia” dhe misionin e ri policor “Proxima”, që ka qenë kritik në përkrahjen e stabilizimit gradual. Konsolidimi i stabilitetit kërkon nga Qeveria që tërësisht ta implementojë Marrëveshjen Kornizë dhe të përforcojë sundimin e së drejtës si dhe përkushtimin dhe sensin e përgjegjësisë nga të gjitha komponentat e popullatës.

Ende mbesin sfida të reja, sidomos ajo e decentralizimit, reformave në sektorin e sigurisë etj. Implementimi i reformave gjithashtu do të implikojë përforcimin e kapacitetit administrativ duke e transformuar administratën publike në një servis publik modern dhe të pa korruptuar. Sistemi gjyqësor gjithashtu duhet të reformohet në pjesën më të madhe të tij.

Republika e Maqedonisë ka qenë e suksesshme në mbajtjen e një kornize stabile makroekonomike dhe iu bashkangjiti Organizatës Botërore Tregtare. Sidoqoftë, situata ekonomike, dhe sidomos dobësitë serioze në funksionimin e ekonomisë, është një sfidë e madhe për tranzicionin e suksesshëm të vendit.

Procesi i Stabilizimit dhe Asocimit ka çuar në formimin e një Plani Akcional Nacional për të ndjekur rekomandimet për një bashkëpunim më të madh.

⁶ <http://www.sep.gov.mk>

Përfundim

Në këtë punim u munduam që të sqarojmë disa kushte që UE-ja dhe shtetet Evropiane i kërkojnë prej Maqedonisë dhe shteteve tjera Ballkanike për t'u pranuar në UE, si shtete përbërëse të një kontinenti të bashkuar të Evropës.

Maqedonisë deri në fund të vitit duhet t'i jepet data për fillimin e negociatave për anëtarësim të plotë dhe të liberalizohet procesi i vizave në tërësi – është rekomandimi i Parlamentit Evropian në muajin mars të këtij viti. Maqedonia i ndërmer hapat e duhura për plotësimin e kriteriumeve për anëtarësim në UE. Ka përparim në implementimin e Marrëveshjes për Stabilim Asocim dhe në plotësimin e kushteve të vendosura nga Komisioni Evropian.

Të gjithë ne duhet ta kemi qartë se nëse duam që një ditë të bëhemi anëtarë të një Evropë të bashkuar, atëherë duhet të punojmë edhe më tepër në këtë drejtim. Në veçanti të gjithë politikanët e Maqedonisë, por edhe qytetarët duhet ta kuptojnë se ardhmëria e këtij shteti është në duart e tyre.

Kohëve të fundit jemi dëshmitarë se sot bëhen manipulime dhe interpretime të ndryshme të Marrëveshjes së Ohrit më qëllim që kjo të mos respektohet në tërësi. Pikërisht mungesa e vullnetit politik për implementimin e saj, tek qytetarët e Maqedonisë ngjall ndjenjën e destabilizimit të sërishëm të rajonit.

Çështja e egzistimit të marrëdhënieve të mira me shtetet fqinje mbetet si një nga sygjerimet kryesore të institucioneve të Unionit Evropian ndaj shteteve të cilat aspirojnë të jenë anëtare të plota të UE-së. Këtu mund të përmendet edhe kontesti i Maqedonisë me Greqinë në lidhje me emrin.

Duhet ta kemi të qartë dhe ta kuptojmë si shumë të rëndësishme vërejtjen e Parlamentit Evropian se pa arritjen e kompromisit mes Shkupit dhe Athinës për çështjen e emrit, Maqedonisë do ti ngadalësohet dhe shtyhet data e anëtarësimit në këtë organizatë supranacionale.

STANDARDET EVROPIANE MBI MJEDISIN JETËSOR DHE TË ARRITURAT E R. MAQEDONISË

Hyrje

Investimet globale në mënyrë domethënëse e përforcuan Politikën e Ambientit Jetësor të Unionit Evropian. Disa nga botimet më të spikatura me tematikë ekologjike janë me karakter global: ndryshimet klimatike, prishja e mbështjellësit dhe biodiversitetit të ozonit. Të gjithë këta çështje kërkojnë aktivitete globale të koordinuara për mbrojtje efektive. Problemet tjera ekologjike mund të trajtohen regjionalisht, mirëpo kërkojnë aktivitete nëpër tërë botën.

Politika e UE-së për mbrojtje të ambientit jetësor fokusohet me gjithë fuqinë e vet në problemet globale (ndryshimet klimatike dhe biodiverzitetin).

Një nga imperativat e globalizimit është kyçja e principeve për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm në negociatat ekonomike, si dhe të zhvillojë marrëdhënie të harmonizuara ndërmjet politikave për tregti dhe për mbrojtjen e ambientit jetësor në nivel ndërkombëtar.² Kjo është krejtësisht identike me kushtet e vendosura në Marrëveshjen e Amsterdemit. Kësisoj, përvojat tregojnë se do të vështirësohet marrja e një përkrahje të gjërë për tregti dhe liberalizimin e investimeve përderisa nuk kontrollohet mbrojtja e ambientit jetësor dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Programet për mbrojtje dhe përparimin e ambientit jetësor të cilat i ka ndërtuar Komisioni ishin në formë të aksioneve pesëvjeçare, ndërsa plani i fundit aksional për dallim nga të tjerët ishte dhjetëvjeçar.³

¹ Instituti i Ambientit Jetësor dhe Shëndetit -UEJL

² Michael F. Niessen N., Environmental Law in Development - Lessons from the Indonesian Experience.

³ Action plan 2006-2011, ECO ACTION.

Në katër planet e para të UE-së për mbrojtjen e ambientit jetësor (1973-1992) janë të përgaditura 200 masa ligjore. Plani i pestë është domethënës në vete për shkak të qasjes fundamentale.

- Marrëveshja e Mastrihtit (1992), i jep një rëndësi më të madhe mbrojtjes së ambientit jetësor në polikën e UE-së. Marrëveshja ngërthen në vete edhe aspekte të mjedisit dhe ate:
- Promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të ambientit jetësor,
- Vendosjen e një niveli më të lartë të mbrojtjes së ambientit jetësor,
- Integrimin dhe implementimin e mbrojtjes së ambientit jetësor në krijimin e politikës në të gjitha sektorët,
- Duke filluar nga kjo periudhë, zhvillimi i qëndrueshëm do të bëhet një nga temat më kryesore të projektit Evropian.

Projekti i pestë për mbrojtjen e ambientit jetësor në UE me titullin “Në kahje të qëndrueshmërisë” e përfshin periudhën nga viti 1993-2000. Ai me vete mbante një strategji gjenerale duke lëvizur me një përparim të madh në kahje të zhvillimit të qëndrueshëm dhe definon 5 sektorë (industri, energji, transport, bujqësi dhe turizëm), në të cilat mbrojtja e ambientit jetësor patjetër të ketë ndikim më të madh në krijimin e politikës së tyre dhe atje ku kërkohet një akcion konkret dhe domethënës.

Për çdo sektor të veçantë të lartpërmendur janë formuar sfera, tërësi dhe afate. Ky lloj i strategjisë kërkon përgjegjësi nga të gjitha faktorët kyç (qeveria, organizatat, autoritetet lokale dhe nga publiku) për arsye se përparësitë janë të mundësuar vetëm nëse të gjithë e kuptojnë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e ndarjes së pronës.

1. Rreziqet ambientale për Evropën

Në dekadën e fundit të gjithë e përballuam rrezikun ndaj ambientit jetësor nga shfrytëzimi i jokontrolluar i rezervave natyrore. Nxemja globale (efekti i kopshtit të qelqt), prishja e mbështjellësit të ozonit dhe shkatërimi sistematik i pyjeve me rreshje tropikale janë vetëm tre shembuj për atë se si është thyer principi i zhvillimit të qëndrueshëm. Mbas dy dekadash të masave korektive (të cilët jo çdoherë ishin të sukseshëm), EU tani preferon partneritet intensiv dhe ndarje të përgjegjësisë për të vepruar në mënyrë preventive.

UE ka miratuar mbi 200 akte nga viti 1970 e këndeje me qëllim të përmirësimit të kualitetit të ajrit, ujit të pijshëm dhe për kontrollin e

mbeturinave të ngurta; mbikëqyrjes së ndotësve potencial dhe mbrojtjes së natyrës.⁴ Qëllimet kryesore për çka ishte sjellur legjislacioni në fjalë ishin: zvogëlimi i emetimit të sulfurit në ajër (shkak i vetëm i shirave acidike), ndalimi i përdorimit të materialeve të cilët e shkatërojnë mbështjellësin e ozonit, kontrollimi i transportit, eliminimi i mbeturinave helmuese dhe mundësimi i standardeve të sigurta për të gjitha ujrat në EU.

Si shtesë e masave të vjetra ligjore, UE shtoi një spektër të gjërë masash me qëllim që të arihet principi i qëndrueshmërisë:

- Instrumente ekonomike për inkurajimin e produkteve të përdorura dhe proceseve;

- Instrumente finansiare nga të cilat "LIFE" ishte i vetmi i cili në mënyrë direkte që i përkushtohej mbrojtjes së ambientit jetësor. Që nga themelimi i tij në vitin 1992, ko-finansohej nëpërmjet 1000 projekteve demonstruese për qëllime industriale dhe lokale, si dhe aksione për mbrojtjen e natyrës.

- Përparësi sipas Raportit të Komisionit Evropian është arritur në integrimin e ambientit jetësor në politikat e sferave të ndryshme. Në sferën e transportit problemet rriten, përparsi është vërejtur në emitimin e gazrave ajrore nga automjetet, kualiteti i lëndëve djegëse dhe në teknologjinë e prodhimit të lëndëve djegëse, mirëpo rritja e numrit të automjeteve e la në hije këtë progres. Në sektorin energjetik mbrojtja e ambientit jetësor paraqitet nga aspekti i problemit dhe nga aspekti i zgjedhjes edhe atë si mungesë në internacionalizimin e shpenzimeve për ambientin jetësor në llogari të energjisë. Në disa sektorë, përmirësimi i kualitetit të ambientit jetësor është treguar në Raportin e Agjensionit Evropian për ambient jetësor, ku theks i veçantë është vendosur në: klorfluoroide, okside të azotit, bashkimi i organeve të rënda dhe metaleve të rënda.

Në disa sfera të ndotjes, shancat për përmirsim priten në vitin 2015, dhe atë: emetimi i Dioksidit të Sulfurit (SO₂); emetimi i elementeve të dëmshme për mbështjellësin Ozonik⁵; lëshimi i metaleve të rënda në atmosferën e Detit të Veriut dhe nëpër ujërat kontinental; emetimi Dioksidit të Karbonit (CO₂).

⁴ Caratti P, Dalkmann H, and Jilberto R., Analysing Strategic Environmental Assessment - Towards Better Decision – 2004.

⁵ Ismaili M. & Durmishi B., Shoqëria dhe Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit.

UE është në rrugë të drejtë në disa sfera të ambientit jetësor, mirëpo përsëri është mjaft larg nga ambicjet e veta në sektorët vijues:

- Acidimi: ekspansioni i ndryshimeve kritike do të vazhdojë edhe më tej;

- Nitratet: standardet e ujit të pijshëm janë rrallë të thyera, duke iu faleminderuar reduktimit të përdorimit të komponimeve të azotit në bujqësi. Mirëpo përsëri prezenca e nitrateve në ujrat ndërtokësor është aq e madhe saqë nuk mundet të pritët përparim pa denitrifikim;

- Menaxhimi me mbeturina të ngurta: edhe përpos zgjerimit të politikës për prevenimin nga ky lloj i mbeturinave, problemi rritet. Përfitimet e ardhshme nga reciklimet do të jenë të mbuluara nga shpenzimet e procesit dhe nga nevoja e tregut të materialeve të recikluara;

- Ambienti urban jetësor: problemet në këtë sferë, e posaçërisht ata të lidhura me fatkeqësitë do të vazhdojnë të deponohen në shumë qytete;

- Mbrojta për biodiversitetin: problemet rriten me rritjen e transportit dhe zhvillimin e turizmit edhe përpos asaj që një numër i madh i sferave janë të mbrojtura. Në të njejtën kohë, ndryshimet në bujqësi janë të reduktuara konform politikës së përbashkët të bijqësore si dhe me masat ekologjike të kyçura në farma.

2. Strategjitë e ardhshme për mbrojtjen e ambientit jetësor

Marrëveshja e Amsterdimit, e cila hyri në fuqi në vitin 1999, theks të veçantë vendosi në zhvillimin e qëndrueshëm, përveç tjerash kërkon që kujdesja për ambientin jetësor të integrohet në politikat e të gjitha sektorëve.⁶

Rëndësia globale e Planit të pestë aksional të programit ekologjik, duket në implementimin e saj në periudhën prej 1992-1999 dhe i prezentoj mundësitë e zhvillim të qëndrueshëm në dekadat e ardhëshme.⁷

Duke determinuar se si duhet të zhvillohet politika e Planit të pestë aksional, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet:

- Gjendjes aktuale në ambientin jetësor dhe trendet e pritura (duke përfshirë edhe efektet nga masat të cilat akoma nuk kanë efekt);
- Kërkesave nga Marrëveshja e Amsterdimit;

⁶ Шапуриќ З., Децентрализација на Власта во Република Македонија.

⁷ Втор Национален План за Климатски Промени

- Aderimit në UE të shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore;
- Mënyra e implementimit të principeve në zhvillimin e qëndrueshëm në tregtinë ndërkombëtare.

Plani aksional ekologjik i gjashtë i UE-së, i përfaqëson shtyllat ekologjike të Bashkësisë të vendosura në një koncept të gjërë të zhvillimit të qëndrueshëm. Edhe kjo programë ishte përmirësuar nëpërmjet procesit të vendosjes së përbashkët të Këshillit dhe Komisionit. Kjo është një programë dhjetë-vjeçare dhe nga ajo pritet që t'i implementojë të gjitha Direktivat e ofruara nga ana e Planit të pestë Aksional.

Në këtë Plan nuk ka rrisi të mëdha dhe iniciativa, dhe kjo përmban katër shtylla⁸:

- Ndryshimet klimatike
- Biodiversiteti dhe mbrojtja e ambientit jetësor
- Ambienti jetësor dhe shëndeti
- Resurset dhe mbeturinat

Në Planin e përmendur përfshihen tema politike në bazë të të cilave është ndërtuar e njëjta. Me pranimin e shumë vendeve anëtare, rëndësi më e madhe i kushtohet procesit të pranimit, i cili përfshin implementimin e direktivave të UE-së.⁹ Për një periudhë 10 vjeçare, ashtu siç parashihet në Planin përkatës duhet të harmonizohen plotësisht legjislacionet e shteteve-anëtare me direktivat.

Plani i gjashtë ka për qëllim që në aktivitetet ekonomike përkujdes ti kushtohet mbrojtjes dhe përmirësimit të ambientit jetësor. Ky plan potencon nevojën e pjesëmarrjes publike ashtu si dhe përforsimin e pozitës së qytetarëve të Unionit. Theks i veçantë është vendosur në Konventën e Arhusit, për të cilën thuhet se patjetër duhet të jetë plotësisht e implemtuar nga të gjitha vendet-anëtare. Mirëpo në të njëjtën kohë nevojitet edhe përgjegjësi e plotë nga qytetarët e Unionit.

Fondet strukturale dhe të kohezionit, si dhe mënyrat e distribuimit të tyre në nivel regional dhe lokal kanë ndikim të madh tek sfera e planifikimit e përdorimit të tokës dhe menaxhimit ekologjik. Plani i gjashtë i potencon pushtetet regjionale dhe lokale si pikë qendrore të zhvillimit të qëndrueshëm në lidhje me drejtimin me natyrën dhe resurset natyrore.

⁸ Мулев М., Заштина на Животната Средина.

⁹ Leveque F., Environmental Policy in Europe.

Plani i gjashtë për dallim nga plani i mëparshëm nuk është i bazuar në qasjet sektoriale, ku bujqësia, industria, energjetika, mbeturinat etj janë qëllime të veçanta. Ai përdor qasje integrale, në kontekst të politikës së zhvillimit të qëndrueshëm nga viti 2000.¹⁰ Plani potencon nevojën për një sërë masash të cilat do ta balancojnë zhvillimin dhe temat ekologjike. Biznesi është i frymëzuar të bëhet më inventues dhe të ketë sa më pak ndikim të mundur në ambientin jetësor. Janë formuar trupa në nivel të UE-së të cilët kanë për qëllim që t'a përmbajnë industrinë në përmbushjen e këtyre qëllimeve.

Përgjithësisht, një implementim i sukseshëm i planit dhe politikës së saj do të varet nga katër faktorë:

- Politika patjetër të jetë e bazuar në termin "sound science". Kjo do të thotë se të gjitha masat dhe aksionet që do të ndërmeren patjetër të kenë një arsye dhe kuptim total shkencor;
- Politika dhe strategjia patjetër duhet të formulohen në bazë të marrëveshjeve ekzistuese që të mundësohet efikasiteti i tyre;
- Përgjegjësia e parë e programit patjetër të jetë në lidhje me shoqërinë, që të mundën të zhvillojnë politikë ekonomiko-ekologjike;
- Konsultime dhe dialogje të gjata për zhvillim të politikave.

Ashtu siç u përmend më parë, ekzistojnë katër prioritetet e planit të gjashtë akcionar, të kufizohen ndryshimet klimatike, natyra dhe biodiversiteti, shëndeti dhe ekologjia, si dhe një zhvillim i qëndrueshëm i resurseve natyrore.¹¹

Rekomandime dhe konkluzat

Plotësimi i disa standardeve të parashtruara nga Unioni Evropian që priten të realizohen nga Republika e Maqedonisë janë me sa vijon:

- Përmirësimi i implementimit të legjislacionit ekzistues;
- Përfshirja e qasjes integrale ekologjike në vendimet e politikave sektoriale (zhvillim, bujqësi, ekonomi etj);
- Definimi i mënyrave të reja të bashkëpunimit me tregun dhe konsumatorët;

¹⁰ Ismaili M. & Durmishi B., Shoqëria dhe Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit.

¹¹ Vatn A., Institutions and the Environment

- Inkurajimi i një përdorimi më të mirë të tokës dhe menaxhimit me të;
- Përgaditja dhe zbatimi i politikave, legjisllacione dhe programe në pajtueshmëri me standardet e partneriteteve të Unionit Evropian dhe NATO-së;
- Ndjekja e gjendjes së ambientit jetësor, natyrës dhe hapësirës, vlerësimi dhe dhënia e lejeve për intervenime në ambientin jetësor dhe hapësirë;
- Planifikimi i hapësirës;
- Drejtimi i qëndrueshëm me resurset natyrore;
- Mbrojtja e natyrës;
- Drejtimi me të dhënat e ambientit jetësor dhe hapësirës, si dhe informimi;
- Ngritja e vetëdijes publike, përfshirja e publikut në procesin e vendimarrjes dhe edukimit;
- Mobilizimi i resurseve financiare dhe investimet;
- Decentralizimi dhe bashkëpunimi me bashkësitë e vetëqeverisjes lokale;
- Partneriteti me palët e interesuara;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar;
- Sigurimi i shërbimeve publike.

Procesi i anëtarësimit në BE dhe orvatjet e RM-së

Hyrje

Do të vijë dita kur të gjitha popujt e këtij kontinenti do të shoqërohen në shkallë më të lartë të unitetit dhe do të krijojnë vëllazëri evropiane, pa i humbur vetitë dhe individualitetin e tyre.

Do të vijë dita kur mendjet do të luftojnë luftërat e vetme – të tregjeve të reja të ideve.

Do të vijë dita kur listat votuese do të zëvendësohen plumbat dhe bombat."

Viktor Igo

Që prej vitit 1849, Viktor Igo i potencoi këto fjalë hyjnore, mirëpo duheshte më se një shekullpër të filluar realizimi i parashikimeve të tija utopike. Për ate kohë, dy luftëra botërore dhe numër i madh konfliktesh në Evropë morrën miliona jetëra. Ka pasur kohera kur është llogaritur se është zhdukur krejt shpresa. Sot, në shekullin XXI, ofron ardhmëri më të kjartë mirëpo poashtu edhe e ballafaqon Evropën me vështirësi të reja dhe sfida.

Bashkimi Evropian është pakt i lidhur midis popujve sovran të cilët kishin vendosur të ndajnë ardhmëri të përbashkët dhe të shoqërojnë pjesë sa më të madhe nga sovraniteti i tyre. Kjo ka të bëjë me ato çështje që janë të rëndësishme për popujt evropian: paqë, mirëqenie ekonomike dhe personale, siguri, pjesëmarje demokratike, drejtësi dhe solidaritet.

Ky pakt përforcohet dhe vërtetohet nëpër tërë Evropën: gjysëm miljard njerëz zgjedhën të jetojnë në kushte të sundimit të së drejtës dhe në pajtueshmëri me vlerat shekullore që kanë të bëjnë me njerëzimin dhe dinjitetin njerëzor.

Në të ardhmen, Evropa do të vazhdon të pranon shtete të reja dhe të ndodh zgjerim i ardhshëm i BE-së. Sipas deklaratave të politikanëve

¹

Studente në Master për Diplomaci, pranë FAP-së

nga shtetet e reja anëtare: "Evropa përfundimisht arriti që të përshtat pozicionimin historik dhe gjeografinë".²

Integrimi evropian sot ka ndikim në tërë kontinentin evropian, ndërsa kjo është pjesë e botës e cila shpejt dhe në mënyrë radikale ndryshon dh të cilit i duhet formë e re stabiliteti.

Integrimi evropian do të vazhdon edhe me vendet të cilat kanë synim të anëtarësohen në BE, sic është Republika e Maqedonisë, rreth çështjeve si tregtia, globalizimi, tregu i përbashkët, zhvillimi rajonal dhe social, zhvillimi dinamik ekonomik etj.

BE-ja ka një rrugë të gjatë përpara se të thuhet se flet me një zë dhe se është aktor i sigurt në skenën e politikës globale dhe diplomacisë.

1. Kriteriumet për anëtarësim në BE

Integrimi evropian cdoherë ka paraqitur proces politik dhe ekonomik, i cili është i hapur për të gjitha shtetet evropiane të gatshme për ti nënshkruar marrëveshjet themeluese dhe të pranojnë në tërësi legjislacionin evropian. Sipas Marreveshje së Romës, cdo shtet evropian mundet të aplikojë për tu bërë anëtar i Komunitetit. Në vitin 1993 në kërkesë të shteteve ish komuniste që ti bashkangjiten KE-së Këshilli Evropian parashitri tre kushte të cilat duhet ato ti plotësojnë për tu anëtarësuar. Këto kushte u njohën si kritere të Kopenhagës.

Kriteret e Kopenhagës janë parimet kryesore sipas të cilave funksionon BE, përkatësisht nga ana tjetër kushtet kryesore të cilat duhet ti plotëson cdo shtet që pretendon të bëhet anëtar i BE-së. Këtu bëjnë pjesë sundimi i së drejtës, liria e të shprehurit, liria e lëvizjes etj.³

Përderisa të hyjnë në BE anëtarët e rinj si *kusht i parë* patjetër duhet të kenë institucione stabile të cilat garantojnë demokraci, sundim të së drejtës, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave.

Kushti i dytë është ekonomia funksionale e tregut si dhe kapacitet e ballafaqim me shtypjen e forcave të tregut në BE.

Kushti i tretë është aftësia për të ndërmarrë obligimet nga anëtarësia, përfshirë edhe përkrahjen e objektivave të BE-së.

Shtetet të cilat dëshirojnë të bëhen anëtarë të BE-së duhet të kenë administratë publike të aftë për realizimin e legjislacionit të BE-së në

² Paskal Fontejn, Evropa në 12 lekcione, Komisioni Evropian, Luksemburg, 2006.

³ Билјана Лајмановска, Osnovni kriteriumi za ~lenstvo vo EU, 2009.

praktikë. kjo nënkupton se edhe Maqedonia këto kritere të Kopenhagës të pasqyrohen në kushtet shoqërore maqedonase.

Kriteret politike shumë qartë definojnë se sundimi i së demokracisë është parakusht themelor. Zgjedhjet janë shprehje më e mirë e asaj se sa demokracia është plotësisht prezente në vend.

Për kriteret ekonomike është potencuar lufta kundër korrupsionit dhe krimi i organizuar. Shteti juridik nënkupton para së gjithash lirinë e gjykatave nga ndikimet dhe shtypjet politike, si dhe nga korrupsioni, qasje të qytetarevë deri te gjykatat dhe prokuroria publike.

2. Interesi strategjik i RM-së për anëtarësim në BE

Anëtarësimi në BE paraqet interes strategjik për RM që nga pavarësimi i saj. Nga vënia e marrëdhënieve diplomatike me BE në dhjetor 1995, RM u legjitimua si partner i besimit dhe aleat i vërtetë i BE-së, madje duke mos anashkaluar asnjë fazë institucionale në afrimin drejt BE-së: nga lidhja e marrëveshjes për bashkëpunim, përmes MSA deri te marrja e statusit për kandidat.⁴

Në dhjetor 2005, me marrjen e statusit vend kandidat për anëtarësim në BE, RM hyri në fazë kyce të procesit të integritimeve evropiane.

Vendimi i Këshillit Evropian për ndarjen e statusit kandidat është mirënjohje politike si rezultat për përparimin e proceseve reformuese dhe në ngritjen e shoqërisë së hapur dhe demokratike.

Objektivi i RM-së është që plotësisht ti plotëson standardet evropiane për demokraci funksionale dhe ekonomi perspektive te tregut, aftësimi për ti ndërmarë obligimet nga anëtarësimi në BE.

Agjenda për anëtarësim të shtetit në BE është reflektuar në programën nacionale për miratimin e legjislacionit të BE-së (ndryshimet ligjore dhe masat për përforsim institucional në afatshkurt dhe afatmesëm).⁵

Programa paraqasëse ekonomike i përfshin masat për plotësimin e kriterëve ekonomike të Kopenhagës, ndërsa plani nacional për zhvillim i përfshin prioritetet investuese për realizimin e objektivave zhvillimore të shtetit. Objektivat kryesore afatshkurte të qeverisë së Republikës së

⁴ Paskal Fontejn, Evropa në 12 lekcione, Komisioni Evropian, Luksemburg, 2006.

⁵ Билјана Лајмановска, Која е исторijата на Европската Унија, 2009.

Maqedonisë në marrëdhëniet me BE janë fillimi i negociatave qasëse dhe liberalizimi i rregjimit të vizave me BE për qytetarët e Maqedonisë.

... 74% e qytetarëve të Maqedonisë presin benificione nga anëtarësimi në BE, tregoi hulumtimi i fundit i opinionit publik konform standardeve të Eurobarometar që realizohet dy herë në vit. Edhe përpos zvogëlimit prej 8% krahas anketës së realizuar në pranverë 2008, kjo është përkrahje më e madhe krahas vendeve tjera kandidat për anëtarësim, ku numri i të anketuarëve të cilat presin benificione është nën 50%.

Numri i të anketuarëve në vend të cilët kanë fotografi të pastër për BE-në poashtu ka shënuar ulje nga 67% në 60%. Megjithatë, vendi mbetet në krye të listës së shteteve qytetarët e të cilave kanë ndjenja positive ndaj BE-së....⁶

Si shtet kandidat për anëtarësim, Maqedonia pret të fillon negociatat me BE dhe sa me parë të bëhet pjesë e familjes evropiane, e cila është familje e gjërë e shteteve evropiane demokratike, të cilat përmes politikës së ndërsjelltë dhe bashkëpunimit ekonomik angazhohen për sigurimin e paqes së përhershme dhe prosperitetit.⁷

3. Kushtet të cilat BE-ja ia parashtron RM-së për anëtarësim

Komisioni Evropian i parashtroi tetë kushte RM-së për ti filluar negociatat për anëtarësim në BE.⁸ Në këto kushte të dukshme janë: implementimi i reformës gjyqësore, lufta kundër korrupsionit, zgjidhja e emrit të vendit dhe ballafaqimi me deficitin demokratik dhe zhvillimi ekonomik, zgjedhje të lira dhe dialogu me opozitën etj.

Aspektet konkrete të Raportit të Komisionit Evropian janë të rëndësishme për marrjen e rekomandimit për hapjen e negociatave. Megjithatë, këtu janë edhe sferat tjera të cilat ishin identifikuar në Raportin dhe kërkojnë vëmendje të madhe, ndërsa në vecanti kanë të bëjnë me: dialogun e rregullt dhe të qëndrueshëm të institucioneve demokratike, ndërsa bëhet fjalë për reforma në gjyqësi dhe politci,

⁶ Весна Коловска, Европска Македонија, 27 Јануари 2009.

⁷ Билјана Лајмановска, Која е историјата на Европската Унија, 2009.

⁸ http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement_process/accesion_process/criteria/index_en.htm

⁹ Quo vadis Македонија? FIOOM, Скопје, 17.08.2008.

ngritja e zhvillimit të arritur dhe garantimi i dosjes më të mirë rreth implementimit. Këto janë aspekte qenësore të këtyre reformave.⁹

Papunësia mbetet si sfidë kryesore e vendit. Buxheti është akoma një nga vërejtjet si dhe vërejtjet për politikën ekspansive fiskale dhe për të drejtat diskrecionale dhe shpenzimet afatshkurte pa kontroll, procedurat e ngadalshme, resurset joefikase të organeve rregullatore dhe supervizore të cilat e pengojnë sundimin e së drejtës, vecanërisht në realizimin e marrëveshjeve dhe krijimin e rregullave të njëjta mbi tregun, të cilat janë elemente për funksionim të plotë të tregut funksional.

Lufta kundër korrupsionit ishte identifikuar so sferë e cila kërkon më tepër vëmendje. Për të marrë datë për negocijatat nga Këshilli i BE-së, do të duhet edhe aktivitet më aktiv diplomatik dhe aftësi për organizim të shoqërisë më ndryshe në hapë me standardet dhe legjislacionin e BE-së.

4. Orvatjet e RM-së për anëtarësim në BE

Maqedonia në periudhën e kaluar në të vërtetë tregon zhvillim dragual ekonomik, rritje të bruto prodhimit nacional, mirëpo gjatë baraspeshës së prishur ekonomike është rritur deficitin i jashtëm tregtar i cili rezulton me inflacion të rritur dhe zbatim të politikës fiskale ekspansive.

*Efektet e definimit të objektivave të vitit për anëtarësim në BE janë: psikologjike, politike, motivuese, menaxheriale, te sigurisë dhe multietnike.*¹⁰

1. Efekti i parë është pastër **psikologjik**: njerëzit dhe komunitetet (sipas marrëveshjes kornizë) duhet të besojnë në objektiv më të lartë, ndërsa ai qëllim përcaktimi i vitit për anëtarësim në BE. Vetëm kjo mund të vret apatinë, mosbesimin dhe pakënaqësinë njerëzve. Njerëzit duan që ta ndjejnë vizionin dhe misionin, ndërsa pa afat të konkretizuar humbet misioni dhe me këtë edhe vizioni. Sikur cdo njeri, të punësuarit, menaxherët, pronarët dhe kapitali dëshirojnë siguri dhe motiv. Në ekonomi thuhet se motiv i vetëm është profiti. Në jetë motiv më i mirë është besimi. Nëse të punësuarit, menaxherët dhe pronarët nuk besojnë në sigurinë dhe në të nesërmen më të mirë (madje edhe për 10 vjet) ato

¹⁰

Јован Мацовски, ЕТТ, 2009.

nuk japin atë gjitha forcat e tyre, ndërsa kur jepet vetëm pjesë e saj nuk ka rezultate.

2. Efekti i dytë është **politik**: me këtë prishet komoditeti i politikanëve, ministrave, administratës. Menjëherë ato do të bëhen pengesë e cila do të pengon aderimin në BE me papunën e tyre, arogancën, korrupsionin, demagogjinë, paditurinë. Menjëherë nuk do të munden të mbajnë fjalime boshe e të rejshe se do të bëjnë dicka. Njerëzit do të maten sipas asja se cka kanë bërë deri më tani dhe atëherë kur kanë pasur shanse të bëjnë dicka. Menjëherë të gjithë politikanët, ministrat dhe administratorët do të kuptojnë se i shkel koha dhe se populli u nuhat në qafë duke kërkuar që të ndodh misioni – Maqedonia të aderon në BE.¹¹

3. Efekti i tretë është **motivimi**: cdo njeri dëshiron të din se është pjesë e dicka më të madheje, se ka kuptim ekzistenca e tij, se ka krijuar dicka. Cdo individ administrator do të bëhet pjesë e mozaikut, i cili paraqet llokomotivë e cila duhet të na drejton kah BE-ja. Një nga objektivat më të mëdha është që tu lihet pasardhësve kushte më të mira nga ato të cilat ne i kemi pasur.

Njerëzit duhet të besojnë se ato janë personat të cilët cdo ditë të kaluar bëjnë dicka me të cilën nesër do të anëtarësohen në BE. Dicka me të cilën do të mburen kur do tu tregojnë fëmijëve të tyre dhe nipave: edhe unë kam marrë pjesë në këtë.

4. Efekti i katërt është menaxherial: papritmas shkolla e vjetër e menaxherëve dhe oligarkëve të cilët e pengojnë reformën për shkak se më mirë punojnë në ekonomik të dirigjuar, të mbrojtur dhe të ngjyrosur politikisht, do të duhet të pranojnë se nuk kanë më mbrojtje dhe do të duhet të modernizohen, trajnohen dhe përgaditen për konkurentësi evropiane. Pikërisht, ose do të fillojnë të mësojnë ose do të lëshojnë menaxherë të rinj dhe të trajnuar që ti kryejnë punët. Pasiqë, klientin nuk e intereson se kush dhe si është menaxheri i ndërmarjes, por kualiteti, shërbimi, garancat dhe standardet.

5. Efekti i pesë është siguria (josiguria edhe pse ajo është komponentë kryesore): potenciam se kapitali kërkon siguri. Ndërsa, siguri më të madhe nga ajo që investorët dëshirojnë ta dijnë se investojnë në shtet në të cilin mbi 75% e popullatës beson dhe punon mundimshëm për të hyrë në BE – fuqinë e dytë ekonomike, dhe se BE është e prirur ndaj këtyre aspiratave?

¹¹ http://www.makedoniko.com/ett/evrointegracija/makedonija_eu2009.shtml

6. Efekti i gjashtë është **multietniciteti**: tanimë nuk është me rëndësi përkatësia nacionale (maqedonas, shqiptarë, gjerman, amerikan, francez, serb, vllah, grek, turk, bullgar, rom etj), por se a i ndihmon Maqedonisë për të hyrë në BE ose jo. Pasiqë Maqedonia ka një strategji andaj kemi edhe objektiva konkrete, programe dhe politika për anëtarësim në BE, hapësira manovruese në bazë të kriterëve etnike dhe fisnore do të bie në minimum.

5. Argumentet “kundër” dhe “pro” anëtarësimit në BE

Argumentet kundër objektivit për aderim në BE ishin se kapaciteti i qeverive të deritanishme dhe administratës nuk japin shpresa për zgjidhjen e rrethanave, si dhe aftësia për të menaxhuar administrata e ngadalshme.

Nuk është çështja se a do të kemi para, pastaj të tentojmë që ti arrijmë afatet, por se a do të kemi kapacitet njerëzor dhe përkushtim të sigurtë të objektivit kryesor, vizionit, misionit, taktikës dhe operacionalizimit të përditshëm.

Lufta kritike do të jetë në aftësinë për të forcuar administratën dhe të mobilizohen kapacitetet e jashtme (jopartiake). Nuk duhet të ndodh dekurajim dhe humbje të shpresave.

Në *argumentet pro*, si objektivi ynë argument kryesor ishte se nën shtypje (të kohës, finacave, politikës dhe publikut), cdoherë arrihen rezultate më të mira dhe se nëse nuk e ngritim skajin e suksesit, mund të mos e qëllojmë as edhe vitin 2012. Dhe në fund, të pranojmë se administrate publike maqedonase ka kapacitete të pashfrytëzuara dhe të fshehura për tu ballafaquar me procesin e integritimit evropian.

Integrimi evropian do të nënkupton mundësi në politikat e shtetit tonë. Vërtetë është koha për të filluar pozitivisht të shihen punët dhe të futet optimizëm në ardhmërinë tonë.

Shanset dhe parashimimet japin sinjale positive për investitorët dhe me këtë kthehem në arsyen kyce për anëtarësim në BE, ndërsa kjo nënkupton edhe zhvillimin ekonomik.

Analizat për anëtarësim të RM-së në BE tregojnë se Maqedonia duhet ti plotëson të gjitha kriteret e mundshme për aderim në BE për tu bërë anëtare e BE-së. Të gjithë e dimë se Maqedonia i plotësoi absolutisht të gjitha kriteret për anëtarësim në NATO, megjithatë nuk mori ftesë për shkak të vetos së Greqisë.

Përfundim

Aneëtarësimi në BE nënkupton jetë më të mirë për qytetarët, ekonomi më të fuqishme, siguri më të madhe. Maqedoninë dëshirojmë ta shohim si shtet me arsim Finlandez, ekonomi Holandeze dhe shendetësi pothuajse Hungareze, ndërsa jo standarde ballkanike. Si shtet nga i cili lehtë do ta mund të udhëtojmë, mirëpo edhe të kthehemi. Edhe përpos kësaj, nuk duhet të na ngjan që që Brenda natës të zgjohemi dhe të shohim se askush nuk na ka definuar prioritetet strategjike.

Tanimë e kemi tekstin e Strategjisë nacionale për integritet evropian të RM-së. Ky tekst paraqet libër të bardhë për nevojat e reformave në Maqedoni për tu arritur vizioni – integritet evropian. Përgjigjet e Pyetësorit të Komisionit Evropian do të paraqesin Libër të bardhë për situatat aktuale në Maqedoni ose me fjalë tjera, kjo do të jetë rezultat i kontrollit sistematik të situatës së përgjithshme në shoqërinë ekonomike dhe politike maqedonase.¹²

Maqedonia ka mundësinë të dëshmon dhe tregon se meriton të jetë shtet evropian dhe ti plotëson tentimet shekullore për siguri, zhvillim ekonomik dhe njohje ndërkombëtare. Pavarësimi i Maqedonisë mbaroi më shpejtë sesa është pritur. Pra, nëse në të vërtetë dëshirojmë edhe do të mundemi.

Në fund, të mos harojmë se Maqedonia dhe populli i saj në të vërtetë dëshiron të anëtarësohet në BE. Ndërsa për BE është me rëndësi të shihet se as që na shpejtohet dhe do të japim gjithëcka nga vetja për të qenë pjesë e BE-së, sa që mundet më shpejtë. Sipas parimit të zgjerimit të optimizmit ndoshta dhe të bindim qytetarët e BE-së dhe anëtarët e BE-së se në të vërtetë vendin e kemi atje.

¹²www.google.com

1. Procesi i anëtarësimit të RM-së në BE dhe realiteti politik pas samitit të Bukureshtit

Procesi i demokratizimit të Republikës së Maqedonisë dhe inkuadrimin e saj në strukturat euro-atlantike, kaloi nëpër një periudhë të gjatë e cila njihet si periudhë e tranzicionit. Konstatimi i tillë vjen nga vonesa e procesit të vënies së kontakteve të para të Republikës së Maqedonisë, me institucionet e Bashkimit Evropian. Republika e Maqedonisë që nga pavarësia e saj e deri tek vënia e kontakteve të para zyrtare me institucionet e Bashkimit Evropian dhe të NATO-s, kaloi në një periudhë shumë të rëndësishme të promovimit të saj ndërkombëtar, respektivisht në antarësimin e saj në strukturat e organizatave ndërkombëtare.

Përkajshime të brendshme politike, juridike, ekonomike dhe problemeve të pranimit si shtet i pamvarur në organizatat ndërkombëtare, respektivisht të politikës së jashtme, Maqedonia arriti që të bëhet anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që iu dha mundësi që ajo të proklamohet si shtet i vlerave demokratike me perspektiva euro-atlantike.

Në krahasim me vendet fqinje, në periudhën pas viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, Maqedonia nuk kishte probleme, ashtu siç kishin shtetet tjera të ish-Jugosllavisë. Maqedonia në këtë drejtim ishte me e favorizuar dhe ishte shtetet i parë i Ballkanit Perëndimor që vendosi marrëdhëniet zyrtare me BE-në.

Maqedonia kontaktet e para me Bashkimin Evropian i vendosi në vitin 1995 së bashku me shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Karakteri i këtyre kontakteve ishte shfrytëzimi i mjeteve financiare të cilat Bashkimi Evropian ua dedikonte këtyre shteteve, për kapërcimin e krizave financiare në vend, për tejkalimin e problemeve të fushave të ndryshme si: të karakterit social, ekonomik, arsimor dhe zgjedhja e problemeve infrastrukturore, e kështu me radhë.²

¹ Nëpunës pranë Ministrisë së drejtësisë; magjistrant pranë FAP-së

² B. Reka & A. Ibrahim: Studime Evropiane, UEJL, Tetovë, 2004 fq. 246-250

Maqedonia në momentin e vërtet u kyç në këto kontakte me institucionet e Bashkimit Evropian, por kjo nuk do të thotë se Maqedonia edhe për së afërmi krijoi kontakte me institucionet e Bashkimit Evropian, për vete faktin se Maqedonia do të vendos marrëdhëniet e para zyrtare me Bashkimin Evropian në vitin 1997. Procesi i anëtarësimit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian vazhdoi në kontinuitet, ku tani Maqedonia ka statusin e kandidat potencial për tu inkuadruar në BE, që Këshilli Evropian ia dha pas rekomandimit të Komisionit Evropian në vitin 2005.

Procesi i anëtarësimit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian ka kaluar nëpër disa faza shumë të rëndësishme deri sa ka arritur të marr statusin e kandidatit potencial që të bëhet pjesë e familjes Evropiane.³

2. Procesi i integrimit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian

Procesi i inkuadrimin të Maqedonisë në BE është proces shumë i gjatë që daton prej vitit 1998, kur Maqedonia vendosi marrëdhëniet e para direkte diplomatike, me qëllim të intensifikimit të procesit të antarësimit. Kusht për vënien e marrëdhënieve bilaterale mes Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian ishte plotësimi i kriteriumeve teknike..

Krijimi i marrëdhënieve diplomatike ishte hap i parë shumë i rëndësishëm ku Maqedonia dhe Bashkimi Evropian krijuan relacione më të afërta, për tu njohur me gjendjen faktike në vend dhe përgaditjen e hapave të mëtejshëm, që i parashihte agjenda e Unionit Evropian për Ballkanit Perendimor dhe eventualisht të kriterëve shtesë të veçanta të dedikuar vendeve të posaçme kandidate për Unionin Evropian. Sikurse vendeve tjera ashtu edhe Maqedonisë i ishin përcaktuar hapat konkrete që duheshin të ndiqte në procesin e integrimit të saj.⁴

Pas ndhivës në rajon, Maqedonia për së afërmi bashkëpunoi me Bashkimin Evropian që solli Maqedonin ta lidh Marrëveshjen e Asocim Stabilizimit, si hap i parë kyq për tu inkuadruar në Bashkimin Evropian, proces që i ishte dedikuar vendeve të Ballkanit Perendimor.⁵

Marreveshja për Asocim dhe Stabilizim është kanali i vetëm që mundëson afrimin e çdo shteti të Ballkanit drejt inkuadrimin në familjen

³ Mr. B. Reka: E Drejta e Unionit Evropian, KIEAI, Prishtinë, 2000, fq. 220-221

⁴ B. Reka & A. Ibrahim: Studime Evropiane, UEJL, Tetovë, 2004 fq. 246-250

⁵ Shih: Marrëveshjen për Asocim dhe Stabilizim, Maqedoni-UE

evropiane. Marreveshja për Asocim dhe Stabilizim është e vetmja rrugë nëpërmes së cilës duhet të ecin vendet e Ballkanit për të arritur synimin e tyre për tu bërë pjesë e Unionit Evropian.

Procesi i Asocim Stabilizimit është lidhja zyrtare mes Bashkimit Evropian dhe vendeve që lidhin këtë marreveshje, që njëherit garanton synimet e që të dyja palëve, të njërës e cila shpreh vullnetin për tu inkuadruar e cila duhet të përgaditet ashtu siç parasheh kriteret organizata dhe pala tjetër organizata e cila duhet të jep asistencë, me qëllim të plotësimit të kriterëve të kërkuara për inkuadrim.

Maqedonia për habi të të gjithëve lidhi Marveshjen për Asocim dhe Stabilizim me Bashkimin Evropian me 9 prill të vitit 2001, në periudhën kur Maqedonia ishte e destabilizuar dhe e pa aftë për të përgjigjur situatës së krijuar në terren. Në qoftë se bëhet një analizë me e thellë, me qëllim që të zbërthej dilemën se pse Bashkimi Evropian nënshkruajti Marreveshjen për Stabilizim dhe Asocim, pikërisht në momentin kur Maqedonia ishte e tronditur nga një konflikt i armatosur brenda dy komuniteteve më të mëdha në vend, mund të arrim këto konkluzione:

- së pari, Bashkimi Evropian mbështeti qëllimin e Republikës së Maqedonise që ta inkuadroj në gjirin e saj evropian, pa marë parasysh rrethanat që ndodheshin brenda shtetit;

- së dyti, Bashkimi Evropian ishte e interesuar që mos të lërë jasht kontrollit të saj një vend me pozitë të rëndësishme gjeostrategjike për rajonin, i cili lehtë mund të destabilizoheshte në qoftë se nuk ndërhyeshte me kohë;

- së treti, Bashkimi Evropian nënshkruajti marreveshjen që të krijoj simpati tek pushteti i atëhershëm, me qëllim që ti ftojn përfaqësuesit nga Bashkimi Evropian dhe organizatat demokratike, që të kyqen në procesin negociues mes palëve në konflikt, me qëllim që të arrihet një kompromis që përgjithësisht do ti kënaqte palët ndërluftuese dhe do të ndërpriste dhunën, me çka do ti jepte mundësi Maqedonisë të vazhdoj në proceset integruese;

- së katërti, që të jetë garantuese e marreveshjes, paqës dhe stabilitetit në vend. Ajo që e pranishme me forcat e saja pas ndërprerjes së konfliktit, me qëllim të kthimit të mirëbesimit në vend dhe fillimin e reformimit dhe harmonizimin e legjislacionit të Maqedonise me atë të Unionit Evropian.

Bashkimi Evropian jo vetëm që i arsyetoj këto teza, por ato gjithashtu u bënë realitet, me vet faktin se u inkuadrua në negociatat mes palëve ndërluftuese si ndërmjetësues, bile në disa momente gjatë

negociimit kishte edhe akte vendimmarëse.⁶ Bashkimi Evropian së bashku me organizatat tjera demokratike, arritën që të bënë një marreveshje në mes dy palëve. Në zgjidhjen konflikt u inkuadruan vetëm institucionet ndërkombëtare demokratike dhe i hapi Maqedonisë rrugën e integritit drejt NATO-s dhe BE-së.

Kjo u bë realitet pas një periudhe katër vjeçare, kur Republika e Maqedonisë në vitin 2005, pas një bashkëpunimi gjatë dhe të vazhdueshëm me Bashkimit Evropian arriti të merr statusine vendit kandidat. RM-ja dhe UE-ja bashkëpunuan në kthimin e mirëbesimit në vend dhe në plotësimin e kushteve teknike të nevojshme për tu inkuadruar në organizatat euro-atlantike. Vendi arriti ti kaloj gjitha barrierat dhe të marrë statusin e kandidatit potencial për tu inkuadruar në UE.

Maqedonia arriti që pjesërisht ti plotësoj kriteret e Kopenhagenit (kriteret politike, ekonomike, juridike dhe ato administrative)⁷ dhe tetë kriteret tjera shtesë për Republikën e Maqedonisë, si implementimi i Marveshjes Kornizë dhe disa kriteret tjera.

Pas aplikimit me 17 Maj të vitit 2004, Këshilli i UE-së i kërkoj Komisionit Evropian për përgaditjen dhe verifikimin e rezultateve të Maqedonisë, për plotësimin e kushteve të nevojshme, për të marrur statusin e kandidatit potencial për tu inkuadruar në Bashkimin Evropian.

Komisioni Evropian pas një numri të madh të takimeve formale në nivel të ekspertëve me institucionet shtetërore, vërtetuan gjendejen faktike në Maqedoni lidhur me plotësimin ose mosplotësimin e kriterëve të nevojshme për procesin e integrujes. Komisioni Evropian me 1 tetor të vitit 2004 ia dorëzoi Maqedonisë Pyetësin, ku kërkohej që kjo e fundit ti përgjigjet me përpikmëri nga ajo çka kërkohej, me qëllim që Komisioni Evropian të marrë vendim për Maqedoninë në procesin e inkuadrimin të saj në Bashkimin Evropian.

Me 14 shkurt të vitit 2005 qeveria e Maqedonisë e kthej përgjigjen e Pyetësit me ç'rast në bazë të përgjigjeve të dhëna Komisioni Evropian me 9 nëntor të vitit 2005, i rekomandoi Këshillit Evropian që Maqedonisë ti jepet status i shtetit kandidat.

Që nga fitimi i statusit kandidat në vitin 2005 Republika e Maqedonisë nuk ka arritur rezultate konkrete në përmbushjen e kriterëve, kusht për hapjen e negociatave për inkuadrimin në UE.

⁶ V. Latifi: Zhvillimi i negociatave I, IOSEMN, 2007, fq. 95

⁷ B. Reka & Y. Sela: Hyrje në të drejtën e UE-së, UEJL, Tetovë, 2007 fq. 45-46

Ndërkohë Komisioni Evropian për çdo vit raporton për Maqedoninë, për të arriturat e saj lidhur me plotësimin e kriterëve që janë vendosur, si kusht për tu bërë anëtare e plotë e Bashkimit Evropian.

3. Plotësimi i kriterëve si kusht për integrimin e Maqedonisë në UE

Plotësimi i kushteve të parapara nga Bashkimi Evropian dhe Marveshja për Asocim dhe Stabilizim, pandërprerë ndiqen nga Komisioni Evropian ose ndryshe quajtur nga Komisioni për zgjerim, i cili është përgjegjës që të mbykëqyr procesin e integritit të Ballkanit Perendimor. Komisioni Evropian për zgjerim nëpërmjet raporteve periodike njofton për situatën në përgjithësi të Ballkanit Perendimor dhe për të arriturat e secilit shtet në veçanti.

Komisioni Evropian pas dhënies së statusit kandidat potencial Republikës së Maqedonisë për tu inkuadruar në Bashkimin Evropian, në vitin 2006 raportoi për shkallën e plotësimit të kriterëve të parashtruara dhe të njohura nga Marveshja për Asocim dhe Stabilizim.

Raportin të cilin e prezentoj Komisioni Evropian kah fundi i vitit 2006, ishte notuar pozitivisht në plotësimin e kushteve teknike, sa i përket marrjes së vendimeve, sjelljen e ligjeve dhe harmonizimin e legjislacionit të Maqedonisë me atë të Bashkimit Evropian. Raporti edhe pse ishte i notuar pozitivisht ai në vete përmban edhe një sërë kërkesash tjera të cilat duhet ti plotësoj Maqedonia për vitet e ardhshme. Raporti për Maqedoninë ishte notuar mjaft pozitiv sa i përket plotësimit të kriterëve të Kopenhagës.⁸

Kriteri politik ishte notuar pozitivisht duke deklaruar se Maqedonia ka arritur rezultate të caktuara në garantimin e demokracisë në vend, sundimin e së drejtës, respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e pakicave, raporte të mira fqinjësore, respektin dhe kooperimin me institucionet ndërkombëtare, respektivisht me Gjykatën Ndrëkombëtare të Drejtësisë.⁹

Në bazë të raportit të Komisionit Evropian, i sugjrohet Republikës së Maqedonisë që të respektoj legjislacionin dhe politikat e Unionit Evropian, respektivisht ato ti harmonizoj dhe implementojnë në legjislacionin e vendit. Repulika e Maqedonisë është e obliguar që ti

⁸ A. Aliu: Proceset e Integritit euroatlantik dhe R.M., CRPA, Tetovë, 2008, fq. 131

⁹ Shih: Raportin e Komisionit Evropian për të arriturat e Maqedonisë për vitin 2006

respektoj dhe përmbushë 33 kapitujt e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Maqedonia në bazë të raportit nuk ka arritur kushte teknike, nuk ka sjellur ligje të posaçme ose ka bërë shumë pak sa i përket qarkullimit të lirë të mallrave, shërbimeve, punëtorëve dhe kapitalit, si parime kyqe për tregtinë e lirë, kushte që rrjedhin që nga BETHÇ-ja¹⁰ që ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Pozitivisht ishte notuar politika e konkurrencës, shërbimet financiare, mirëpo kishte edhe mjaft vërejtje.

Të njejtën gjë thueshte edhe për mjetet e informimit ku kishte disa rezultate, por njëherit kishte edhe mjaft kritika sa i përket informimit të lirë dhe ndikimi i censuruar. Përparim kishte në harmonizimin e legjislacionit me atë të Unionit Evropian në sferën e bujqësis, peshkataris, transportit, energjetikës dhe tatimeve. Kishte edhe shumë për të bërë sa i përket përmbushjes së reformave dhe sjelljeve të ligjeve konkrete, me qëllim që të arrihej harmonizim në mes politikave të Maqedonisë me ato të Unionit Evropian.

Maqedonia mbeti shumë largë reformave ekonomike dhe atyre monetare, në këtë drejtim kishte përparim shumë të vogël, ndërsa në politikën sociale dhe atë të punësimit janë arritur përparime të kënaqëshme. Shumë për tu bërë ka sa i përket mbrojtjes të vendeve të punës dhe mbrojtjes shëndetësore. Reformat në gjyqësi ngelën një nga problemet kyqe që e preokupojnë Republikën e Maqedonisë dhe këtu ishin rekomandimet më të zëshme për ndryshimet në legjislacionin e vendit, reforma më të mëdha në gjyqësi dhe luftë më e madhe ndaj korrupsionit i cili ka hyrë thellë në gjyqësi dhe paraqet faktorin kyq për mosrespektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.¹¹

Një sërë kritikash tjera sa i përket mjedist jetësor, politikës së siguries, politikës së jashtme, azilkërkuesëve dhe reformave tjera, të parapara sipas kapitujve të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2006 përgjithësisht ishte pozitiv edhe pse kishte ngelur shumë për tu bërë sa i përket harmonizimit të legjislacionit tonë me atë të Unionit Evropian. Mungesë kemi në përgaditjen e kapaciteteve administrative, kuadrove dhe mjeteve financiare të nevojshme për përshpejtimin e reformave dhe materializimin e tyre në praktikë.

Pas vitit 2006 Komisioni Evropian vazhdoi bashkëpunimin me Republikën e Maqedonisë në plotësimin e kriterëve që i parashihte Komisioni Evropian, konform Marreveshjes për Asocim dhe Stabilizim.

¹⁰ A. Ibrahim: Institucionet politike të BE-së: Komisioni Evropian, Logos-A, Shkup, 2003

¹¹ J. Shasivari: Proceset e Integritimit euroatlantik dhe R.M., CRPA, Tetovë, 2008, fq. 197-214

Bashkimi Evropian, gjegjësisht Komisioni Evropian ia dërgoi Pyetësorin qeverise së R.M.-së për të vërtetuar të arriturat e vendit gjatë vitit kalendarik 2006/2007. Raporti i komisionit Evropian sikurse i vitit të mëparshëm kishte një numër të madh të vërejtjeve të cekura më lartë, në ato fusha ku Maqedonia kishte ngelur në harmonizimin e legjislacionit të saj me atë të Bashkimit Evropian dhe në plotësimin e kriterëve bazë të Kopenhagës të nevojshme për hapjen e negociatave. Vërejtje kishte të reformat në administratë, nevojën e profesionalizimit të saj, duke dhënë një kritik të madhe rreth politizimit të saj, luftën kundër korrupsionit në organet administrative, një qyjçësi mjaft e kontrolluar dhe e kooruptuar, e cila ka nevojë për tu reformuar. Reforma duhet bërë në ekonomi, në financa dhe organet e pushtetit shtetëror ku decentralizimi duhet vazhduar edhe më tej.¹² Ishin potencuar edhe marredhëniet ndërfaqinjësores ku theks të veçant kishte konflikti diplomatik mes Greqisë dhe Maqedonisë. Emërtimi i aeroportit të Shkupit hapi shumë polemika që do të ndikoj dukshëm në proceset integruuese të Maqedonisë.

Rapoti i Komisionit Evropian i vitit 2007 ishte vlerësuar pozitivisht edhe pse kishin ngelur shumë fusha ku duhet punuar ende, mirëpo kjo ndikonte pozitivisht për vazhdimin e punës së mëtutjeshme të reformimit dhe harmonizimit të legjislacionit të vendit me atë të Bashkimit Evropian.

Republika e Maqedonisë priste rezultate konkrete dhe pozitive nga Bashkimi Evropian në vitin 2008 i cili vit do të ndikonte në perspektivën euro-atlantike të vendit. Për Maqedoninë viti 2008 mund të ishte vit historik për vet faktin se mbahej samiti i Bukureshtit ku Maqedonia duhet të merr ftesë për tu antarësuar në NATO dhe priste caktimin e datës së negociatave për tu inkuadruar në BE. Maqedonia nuk arriti as që të marrë ftesë për tu inkuadruar në NATO,¹³ e as që marrë datën e fillimit të negociatave për tu inkuadruar në Bashkimin Evropian.

Pasi që në samitin e NATO-s në Bukuresht nuk pati konsensus mes anëtarëve të saj, Maqedonia nuk mori ftesë dhe i ishte rekomanduar që të negociojë me Greqinë për gjetjen e zgjedhjes rreth kontestit të emrit. Parregullsitë rreth procesit zgjedhor dhe ditës së mbajtjeve të zgjedhjeve të organizuar në korrik të vitit 2008 u cilësuan si jodemokratike që humbën shpresat se Maqedonisë se mund ti caktohej data e fillimit të negociatave me Bashkimin Evropian. Edhe pse raporti i

¹² A. Azizi: Shteti i së Drejtës dhe Reformat në Administratën Publike: Rasti i Maqedonisë, përmbledhje tekstesh shkencore, UEJL, Tetovë, 2008, fq.63

¹³ Shih: Komunikatën e NATO-s të Samitit të Bukureshtit

Komisionit Evropian në disa fusha ishte pozitiv, ai ishte shumë i ashpër në mosrespektimine e lirive dhe të drejtave të njeriut, si p.sh. gjatë zgjedhjeve të korrikut në vitin 2008. Zgjedhjet ishin të manipuluar dhe kontrolluara jo vetëm nga individë të caktuar, por të inkuadruar dhe projektuar nga institucionet dhe organet e pushtetit shtetëror. Fajtor nga praregullsia e procesit zgjedhor gjatë mbajtjeve të zgjedhjeve parlamentare ishte pushteti shtetëror dhe përgjegjësia duhet të mbajë qeveria e Maqedonisë.¹⁴

Maqedonisë i ishte vënë kusht kryesor organizimi i zgjedhjeve të lira që u mbajtën më 22 mars, sipas normave demokratike. Zgjedhjet e fundit për pushtet lokal dhe Kryetar të shtetit u vlerësuan pozitivisht nga ana e Bashkimit Evropian, që i hap rrugën Maqedonisë për caktimin e datës të fillimit të negociatave për tu antarësuar në Bashkimin Evropian. Mbajtja e zgjedhjeve sipas standardeve demokratike ndërkombëtare ishte parakushti kryesor, por jo edhe garancë se Maqedonia do të marrë datën për fillimin e negociatave. Pra, kjo nënkupton vazhdimin e rrugës drejt plotësimit të kriterëve të përcaktuara nga Bashkimi Evropian, ndërsa plotësimi i tërë kriterëve tjerë që Bashkimi Evropian ia përcaktoi Maqedonisë, do të jenë kusht esencial për liberalizimin e vizave dhe caktimin e datës të fillimit të negociatave.

4. Zgjidhja e kontestit me emrin e RM-së, domosdoshmëri për vazhdimin e proceseve integruese në BE

Republika e Maqedonisë që nga pavarësia e saj ka probleme rreth emrit me Greqinë, që Maqedonia që e detyruar që të hyjë në negociatë me Greqinë për gjetjen e një zgjidhje rreth përdorimit të emrit, me ndërmjetësimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Republika e Maqedonisë me Greqinë ka një marrëveshje të përkohëshme ku Maqedonia është emërtuar si Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, që përdoret në marrëdhëniet ndërkombëtare, marrëveshje kjo e cila do të zgjat derisa Maqedonia dhe Greqia do të gjejnë një zgjidhje përfundimtare.

Duke patur parasysh se Greqia është anëtare e dy organizatave ndërkombëtare UE dhe NATO, ku Maqedonia pretendon të bëhet anëtare

¹⁴ Shih: Raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë, 5 shtator viti 2008

e tyre, çështja e emrit shfaqet pengesë kryesore për antarësimin e Maqedonisë në këto dy organizata.

Konstatimi i tillë vjen pas dështimit të Maqedonisë për të marrur ftesë për tu bërë anëtare e plotë e NATO-s. Në samitin e Bukureshtit u pa realiteti politik dhe diplomatik i polemikës së kontestit të emrit, të cilën gjë Greqia e kishte paralajmëruar që në vitin 2000, kur Maqedonia bënte përpjekje për nënshkrimin e Marveshjes së Asocim Stabilizimit me Bashkimin Evropian.¹⁵

Pas dështimit të Maqedonisë në samitin e Bukureshtit çështja e emrit bëhet lëndë e polemikave politike dhe diplomatike rreth antarësimin dhe bllokimit të Maqedonisë në proceset integruese, ku vendimi për pranimin e shteteve të reja meret me konsenzus. Pas Bukureshtit u pa realiteti politik, se Maqedonia e ka të patjetërsueshme zgjedhjen e kontestit të emrit me Greqin, nga se kjo e fundit mund të përdor mekanizmin e veto-s, mekanizëm i cili bllokoi antarësimin e vendit.

Çështja e emrit pas dështimit të Maqedonisë në samitin e Bukureshtit është keqpërdorur nga politikantët ditore në Maqedoni dhe Greqi për të fituar poena politik. Që të dyja shtetet deklarojnë se në Bukuresht ka patur përdorim të mekanizmit të veto-s. Duke u bazuar në burimet materiale, respektivisht në kumtesën e dalur pas samitit të Bukureshtit, tregohet qartë se për Maqedonin nuk ka patur konsenzus. Për vet faktin se aleanca ka debatuar me dyer të mbyllura nuk mund të thuhet se Greqia ka përdorur mekanizmin e veto-s, sepse nuk ka argumente, e as të paktën ka patur përfaqësues nga Maqedonia brenda ku janë marrur vendimet dhe janë shqyrtuar kandidaturat.

Sido që të jetë Maqedonia gjendet para një sfide të madhe pas dështimit në samitin e Bukureshtit dhe pas paralajmërimeve të udhëheqësve politik në Greqi, se çështja e emrit do të jetë kusht për antarësimin e Maqedonisë edhe në Bashkimin Evropian.

Maqedonia e ka të patjetërsueshëm që në afat sa më të shkurt dhe me përkushtim të gjejë një zgjidhje me Greqin rreth kontestit të emrit, i cili kompromis do të zgjidhte përfundimisht mosmarrveshjet mes dy shteteve. Kompromisi do të arrihej vetëm nëse që të dy palët do të tërhiqeshin nga pozicionet e tyre. Maqedonia disa herë ka ndryshuar qëndrimin e saj, që ndikon dukshëm negativisht në pozicionin e saj negociues.

¹⁵

Mr. B. Reka: E Drejta e Unionit Evropian, KIEAI, Prishtinë, 2000, fq. 221

Kontesti i emrit kërkon një zgjidhje të shpejt me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar, që do ti ndihmonte Maqedonin në procesin e integritit në strukturat euro-atlantike, së bashku me vendet e Ballkanit Perëndimor. Paralajërimet e fundit tregojnë qartë, se Maqedonia po e humbë pozicionin e saj përball BE-së edhe pse e para vendosi marrëdhëniet me BE-në në krahasim me Kroacinë dhe Shqipërinë, vende të cilat tani më janë anetare të plota të NATO-s.

Kontesti rreth emrit të Republikës së Maqedonisë, vështruar nga prizma e ndikimit në marrëdhëniet ndërkombëtare

Ashtu siç është i rëndësishëm prioriteti në marrëdhëniet e përditshme njerëzore dhe në jetën e përditshme, jo më pak i rëndësishëm është edhe prioriteti në marrëdhëniet midis shteteve.

Përmes përparësisë dhe pozicionit të fuqisë, realizohen interesat politike, ekonomike, kulturore, fetare e të tjera të shteteve. Më së shpeshti këto interesa në jetën e përditshme, madje edhe në relacionet midis shteteve imponohen mbi palën më të dobët.

Përmes fuqisë, e cila shprehet si arbitër përfundimtar në marrëdhëniet midis shteteve, më të fuqishmit e shprehin superioritetin e tyre dhe bëjnë atë që munden, ndërsa më të dobët e pranojnë atë që e kanë të patjetërsueshme. Sjellja e shtetit më të fuqishëm, në zbatimin e përparësisë së shprehur përmes fuqisë së ndikimit duhet të jetë e matur dhe relativisht e drejtë, ndërsa shteti më i dobët duhet të përmbahet dhe të jetë indiferent.

Politika ndërkombëtare është më së shumti e preokupuar me prioritetin e shprehur përmes fuqisë. Për këtë arsye, që të mund ta kuptojmë prioritetin në relacionet ndërkombëtare, së pari duhet që ta definojmë rëndësinë e fuqisë.

Fuqia paraqet mundësinë e një shteti në politikën ndërkombëtare që të ndikon në sjelljen e shteteve tjera.³ Me fjalë tjera, fuqia paraqet tërësinë e potencialeve ushtarake, ekonomike, diplomatike, teknologjike dhe potencijaleve tjera të shtetit. Kjo nënkupton se shteti duhet të ketë fuqi politike, me zhvillim ekonomiko-teknologjik dhe fuqi ushtarake që të mund të ndikon në zgjidhjen mosmarrëveshjeve potenciale të natyrave të ndryshme në marrëdhëniet me shtetet tjera.

Fuqia e një shteti mund më së miri të shihet nga interaksionet e saja me shtetet tjera, pasi që shteti fiton apo humb fuqinë krahasuar me

¹ Studente e shkencave politike pranë FAP-së

² Magjistrante për Diplomaci pranë FAP-së

³ Samuel P. Huntington "Why International primacy matters", in International Security 1993, vol.17.

shtetet tjera. Nga kjo, rrjedh edhe formulimi i prioritetit ndërkombëtar si aftësi e shtetit me përdorimin e fuqisë së vetë të ndikon në sjelljen e më tepër shteteve lidhur me më tepër çështje.

Laswell dhe Kaplan e formulojnë ndikimin e prioritetit si funksion që ka të bëjë me:

- peshën: që nënkupton shkallën e participimit në vendimmarje,
- sferën: vlerat ndaj të cilave ndikohet dhe
- shtetin: njerëzit ndaj të cilëve bëhet ndikimi.⁴

Komponenta e parë e formulacionit ka të bëjë me shallën e participimit në vendimmarje, që nënkupton imponimin e ndikimit të prioritetit në vendosjen e shteteve për çështje që janë të interesit të saj autonom, ndaj të cilave shteti i cili e ka prioritetin e reflekton politikën e vetë të jashtme.

Sfera apo domeni si komponentë e dytë shpreh vlerat ndaj të cilave ndikohet. Ato vlera mund të jenë ideologjike, ekonomike, kulturore, fetare etj.

Varësisht nga shkalla e zhvillimit të shtetit dhe struktura e popullatës ndaj të cilës ndikohet, prioriteti mund në mënyra të ndryshme të realizohet. Në më tepër shtete të zhvilluara, ndikimi i prioritetit realizohet në mënyrë të kufizuar, para së gjithash ai ekonomik, ndërsa në shtetet më pak të zhvilluara ndikimi i tillë mund të jetë i plotë.

Prioriteti i shprehur përmes fuqisë e përcakton shkallën e ndikimit ndaj shteteve tjera dhe vendin e prioritetit të atij shteti në marrëdhëniet ndërkombëtare.

- *Prioriteti vështruar në kontestin rreth emrit të Republikës së Maqedonisë*

Duke pasur parasysh se pozicionimi i Greqisë në marrëdhëniet ndërkombëtare është më i volitshëm (në kuptimin e asaj se Greqia është anëtare e NATO-s dhe Bashkimit Evropian, organizata rajonale në të cilat Maqedonia pretendon të bëhet anëtare), Maqedonia ka një pozitë më të pavolitshme ndërkombëtare që të mund ti realizon aspiratat e veta, vecanërisht kjo është e potencuar tani kur Greqia e shfrytëzon këtë pozitë për të penguar pranimin e Maqedonisë në këto struktura. Në rastin e kontestit me emrin e RM-së, thjesht më tepër bëhet fjalë për

⁴ Harold D. Lasswell and Abraham Kaplan, *Power and security: A framework for Political inquiry*, New Haven, Conn, Yale University Press, 1950, p.77

prioritet dhe imponim të vullnetit të shtetit më mirë të pozicionuar në marrëdhëniet ndërkombëtare sesa për plotësimin e standardeve të caktuara për anëtarësim në këto organizata. Madje edhe në rast të plotësimit të standardeve të caktuara të cilat kërkohen për anëtarësim në këto organizata, do të ishte i pamundur pranimi i një kandidati të ri po që se ekziston ndonjëfarë kontesti i pazgjedhur me ndonjërin nga shtetet-anëtare, pa marrë parasysh se një gjë e tillë nuk kërkohet si kusht nga organizata në fjalë, mirëpo praktikisht paraqet pengesë serioze. Rasti me Maqedoninë dëshmon se në njëfarë mënyre imponohet autoriteti dhe vullneti i shtetit Grek në zgjidhjen e kontestit, duke përdorur pozicionin e tij ndërkombëtar, madje edhe preferohet zgjidhje e kontestit në bazë të sugjerimeve të caktuara me një dozë të imponimit të zgjidhjes duke dhënë edhe propozime konkrete. Kjo na bën të besojmë se në të vërtetë koncepti realist i të kuptuarit të marrëdhënieve ndërkombëtare funksionon në praktikë, pa marrë parasysh ekzistimin e së drejtës ndërkombëtare e cila përmban rregulla konkrete rreth zgjidhjes së mosmarrëveshjeve eventuale.

Lidhur me këtë, mundësia e ndikimit të shtetit të caktuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve para së gjithash është reale dhe në praktikë varet nga kapaciteti i shtetit për të diktuar rrjedhojat e procesit duke imponuar autoritetin e vet, si rezultat i pozicionimit më të mirë të shtetit në arenën ndërkombëtare për shkak të fuqisë, inkuadrimit në strukturat ndërkombëtare dhe ndikimit në politikëbërjen e atyre struktura.

Është evidente se Maqedonia fatkeqësisht nuk vlerëson drejtë fuqinë e saj dhe të tjerëve për të ndikuar në marrëdhëniet ndërkombëtare, vecanërisht kur flitet për kapacitetetin, fuqinë dhe etablimin e interesave të shtetit grek në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Mbyllja e syve dhe mospasja e një qasje reale dhe të drejtë nga autoritet maqedonase rreth këtyre përparësive të Greqisë në arenën ndërkombëtare bën që të vonohet zgjidhja e kontestit me emrin, ndërsa rezultati i një politike të këtillë neglizhente është pengimi i proceseve euro-integruese të vendit.

Në mbështetje të kësaj që thamë më lartë, mund të potencojmë se komuniteti ndërkombëtar vazhdimisht u bën thirrje autoriteve në Maqedoni për të gjetur sa më shpejtë një zgjidhje rreth emrit me Greqinë, me cka në mënyrë indirekte organizatat ndërkombëtare në të cilat Maqedonia ka aspiratë të anëtarësohet pranojnë rolin dhe pozicionimin më të mirë të shtetit grek në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Përfundim

Vështruar sferën e ndikimit të shteteve më të fuqishme në marrëdhëniet ndërkombëtare nëpër histori dhe sot, mund të thuhet se sipas përmbajtjes ndikimi mund të jetë pozitiv ose represiv. Shprehja e fuqisë së shtetit ndaj shteteve tjera më pak të zhvilluara përmes bartjes së lëvërdive ekonomike dhe ideologjike mund të ketë ndikim pozitiv, ndërsa përdorimi i fuqisë ushtarake në realizimin e interesave të caktuara mund të ketë ndikim represiv.

Maqedonia si shtet i vogël, ekonomikisht i pazhvilluar, ushtarakisht i pakompletuar, ideologjikisht i padefinuar deri në fund, me probleme në vazhdim rreth emrit dhe me marrëdhënie të tendosura ndëretnike deri në shkallë të konfliktit duhet para së gjithash ti tejkalon problemet aktuale dhe të përgaditet për sfidat me të cilat do të ballafaqohet në të ardhmen, vecanërisht me ndikimin e shteteve të cilat janë më mirë të pozicionuara në arenën ndërkombëtare dhe vazhdimisht bëjnë shtypje të madhe për realizimin e intencave të tyre politike. Vështruar nga aspekti i teorisë realiste mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, Greqia ka përparësi evidente nga vetë fakti se ajo është anëtare e strukturave euro-atlantike dhe nga ky pozicion ushtron ndikim tek partnerët tjerë për të penguar Maqedoninë në realizimin e aspiratave për anëtarësim në NATO dhe në BE, ndërsa shanset për arritjen e një rezultati më të volitshëm në zgjidhjen e kontestit rreth emrit janë në favor të Greqisë.

Rëndësia e zgjidhjes së kontestit rreth emrit të Republikës së Maqedonisë

Vështruar nga aspekti historik, Greqia nuk kishte vërejtje për emrin e fqiu të saj verior në kohën e ish Jugosllavisë. Nga viti 1944 deri në vitin 1991, Republika Popullore e Maqedonisë (ndërsa më vonë "Republika Socialiste e Maqedonisë") ishte një ndër gjashtë republikat konstitutive të ish RFJ-së. Pas shpërbërjes së saj, Greqia bllokoi njohjen ndërkombëtare të shtetit të RM-së edhe përpos faktit se në vitin 1992 i plotësoi të gjitha kushtet e nevojshme.²

Për të demantuar arsyetimin grek se emri i shtetit implikon tendenca territoriale ndaj Greqisë, Maqedonia miratoi dy amandamente kushtetutese me 6 Janar 1992, me të cilat potencohet se "RM nuk ka tendenca territoriale kundër asnjë shteti fqinj dhe se ...në kujdesin për pozitën dhe të drejtat e qytetarëve të saj dhe pakicës nëpër shtetet fqinje nuk do të përzihet në punët e brendshme të shteteve tjera."

Problemet filluan kur Maqedonia duhej të anëtarësohet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Këshilli i sigurimit i OKB-së në këtë drejtim, në vitin 1993 kishte miratuar rezolutat 817 dhe 845, me të cilat i sugjerohet Asamblesë së përgjithshme që ta pranon Maqedoninë në anëtarësi në OKB me referencën e përkohshme "FYROM" përderisa nuk gjendet zgjidhje rreth dallimeve për emrin e këtij vendi me Greqinë. Në këtë drejtim Këshilli i sigurimit përcaktoi letërnjoftimin e vendit tonë në nivel multilateral, përkatësisht personaliteti ndërkombëtar i shtetit të Maqedonisë të njihet si "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" apo shkurt IRJM.

¹ Magjistrante për Diplomaci pranë FAP-së

² Në Raportin e vitit 1992, Komisioni i arbitrazhit i udhëhequr nga R. Badinter shprehu opionionin se Sllovenia dhe Maqedonia i plotësojnë kushtet për pavarësi dhe njohje ndërkombëtare. Përkundrajt kësaj, pranimi i RM-së ishte shtyrë për shkak të kundërshtimit nga Greqia, duke arsyetuar se emri Republika e Maqedonisë paraqet kanosje për integritetin teritorial të saj dhe trashëgiminë kulturore helene.

Rezolutat e Këshillit të sigurimit të OKB-së paraqesin një kornizë të përgjithshme, duke mos hyrë në detaje për ate se çfarë zgjidhje duhet të gjendet.

Preambulla e Rezolutës 817 e Këshillit të Sigurimit me anë të cilës Maqedonia ishte rekomanduar për pranim në OKB, pranon se "parashtuesi i kërkesës i plotëson të gjitha kriteret për anëtarësim në pajtim me nenin 4 nga Karta e Kombeve të Bashkuara".

Sipas Rezolutës 817 përkatësisht 845, Maqedonia dhe Greqia detyrohen që ta zgjedhin kontestin rreth emrit nën ombrellën e Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së. Sipas rezolutës 817 (7 prill 1993) zgjidhja e kontestit duhej të bëhet nën mbikëqyrjen e Komitetit për Konferencë ndërkombëtare për ish Jugosllavinë, ndërsa me Rezolutën 845 (18 qershor 1993) zgjidhja e kontestit vihet nën mbikëqyrjen e Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, fillimisht Sajrus Vens e më pastaj Metju Nimic si përfaqësues special i Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së.

Në bazë të Rezolutës 817, Këshilli i sigurimit i OKB-së duhej të jep rekomandim për hyrje të Maqedonisë në OKB, gjatë së cilës do të përdoret referenca "IRJM" në të gjitha rrethanat. Asambleja e përgjithshme e pranoi rekomandimin dhe me Rezolutën 47/225 në seancën e saj të 48-të (8 prill 1993) e pranoi Maqedoninë në OKB.

Pranimi i Maqedonisë në Kombet e Bashkuara ishte bërë në prill të vitit 1993 me Rezolutën 47/225 të miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm i OKB-së, në të cilën potencohet se "shtetit do mund të komunikojnë për të gjitha qëllimet në kuadër të Kombeve të Bashkuara me referencën IRJM, në pritje të zgjidhjes së dallimeve të cilat dolën rreth emrit të shtetit".

Në atë kohë Qeveria e Maqedonisë fuqishëm ishte kundërshtuar përdorimit të emrit provizor, duke thënë se "sipas asnjë kushti" nuk është e gatshme ta pranojë atë emër provizor për shtetin. Por, teksti i rezolutës mbeti i pandryshuar dhe negociatat zgjatën deri në shkurt 1994 kur Qeveria Greke vendosi embargo tregtare ndaj Maqedonisë. Dy muaj më vonë, Komisioni Evropian kërkoi nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë ta vërtetojë embargon Greke si shkelje serioze e të drejtës së Bashkimit Evropian. Greqia dhe Maqedonia i normalizuan marrëdhëniet bilaterale me nënshkrimin e Marrëveshjes së përkohshme, më 13 shtator të vitit 1995 në Njujork. Në pajtim me marrëveshjen, Athina u pajtua ta ndërpres ndalesën e njëanshme ndaj fqiu verior të saj ndërsa Maqedonia bëri ca lëshime për vullnet të mirë, kështu që hoqi dorë nga dielli me 16 krah, simbol i flamurit të parë të Maqedonisë të pavarur për të cilën Greqia tha se ka të drejta historike; dhe ndryshoi nenin 3 nga Kushtetua

cili thotë se "nuk ka tendenca territoriale ndaj shteteve fqinje". Që të dy shtetet u pajtuan ti vazhdojnë negociatat nën organizim të OKB-së ndërsa Greqia u pajtua mos të pengojë pranimin e Maqedonisë në organizatat ndërkombëtare përderisa ajo pranon ti drejtohet me emrin provizor që përdoret në OKB. Kjo ia çeli derën Maqedonisë të jetë anëtare në organizata ndërkombëtare duke i përfshirë këtu edhe Këshillin e Evropës, OSBE dhe Partneritetin për paqë.

Marrëveshja e përkohshme e nënshkruar me 13 shtator 1995 si akt për përmirësimin e marrëdhënieve midis Greqisë dhe Maqedonisë jep korniza më të kjarta për zgjidhjen e kontestit me emrin, mirëpo paraqet edhe kornizë për zhvillimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimin e ndërsjelltë. Qëllimi i marrëveshjes së përkohshme ishte që kontesti me emrin të mos jetë pengesë për zhvillimin e Maqedonisë, në kuptim të kësaj edhe intergimi i saj në organizatat ndërkombëtare multilaterale dhe rajonale.

Sipas nenit 23(2) të Marrëveshjes, për shuarjen e funksionimit të saj njëra palë duhet me shkrim ta njohton palën tjetër se tërhiqet nga marrëveshja, ndërsa ajo pushon së funksionuari pas 12 muajve nga dita e pranimin të njoftimit.

Madje, edhe sikur të ndërpritet vlefshmëria e Marrëveshjes së përkohshme, mbeten të jenë në fuqi rezolutat 817 dhe 845 të Këshillit të sigurimit, të cilat parashohin nga Maqedonia dhe Greqia të gjejnë zgjidhje për kontestin me emrin nën mbikëqyrjen e Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së. Nëse cila do qoftë palë tërhiqet nga procesi i zgjidhjes së kontestit, kjo do të nënkuptonte shkeljen e Rezolutës së Këshillit të sigurimit.

Viteve të fundit, gjendja e sigurisë në RM dhe rajon është stabilizuar, si rezultat i angazhimit të NATO-s. Faktor i rëndësishëm është formimi i të ashq. grupi i "Kartës së Adriatikut". Bashkëpunimi me NATO-n i ndihmoi RM-së që të konsolidon sigurinë e vendit.

Mirëpo, në Samitin e NATO-s të mbajtur në Bukuresht, liderët refuzuan të dërgojnë ftesë Maqedonisë për anëtarësim, pasi që Greqia e bllokoi vendimin për shkak të emrit të IRJM-së. Sekretari Gjeneral i NATO-s, Jan De Hop Shefer në konferencën për shtypin tha: "Ne u pajtuam që ftesa ti dërgohet IRJM-së menjëherë pasi që të arritet zgjidhje e përbashkët e pranueshme për çështjen e emrit". NATO nuk njeh fjalën veto, pasi që vendoset në bazë të konsenzusit, ndërsa fatkeqësisht nuk kishte konsensus në samitin e Bukureshtit.

Situata momentale rreth marrëdhënieve maqedono-greke është në fazë të mungesës së dialogut dhe një konflikti i ngrirë.

Është brengosëse papërgjegjshmëria politike e subjekteve kompetente të cilat duhet të jenë pjesë e procesit.

Maqedonia edhe pse kishte punuar në plotësimin e kriterëve operative-teknike për anëtarësim në NATO, megjithatë nga shefat e shteteve dhe qeverive, me 3 prill 2008 ishte miratuar Deklarata e Bukureshtit, e cila duke iu referuar RM-së në paragrafin 20 potencon se: "Në suaza të OKB-së një numër i madh i aktorëve kanë punuar në drejtim të zgjidhjes së çështjes së emrit, megjithatë aleanca me keqardhje konstaton se në këto negocijata nuk është arritur zgjidhje e suksesshme, prandaj jemi dakorduar që thirja për IRJM të dorëzohet kur do të arrihet zgjidhje e gjithëpranueshme rreth çështjes së emrit." Pa marrë parasysh se një gje e tillë është bërë nën ndikimin e Greqisë, duhet potencuar se pas kesaj deklarate qëndojnë të gjitha shtetet-anëtarë të NATO-s dhe bartin përgjegjësi politiko-juridike me të.

Qëndrimi zyrtar i Minsitrisë të Punëve Jashtme të Greqisë thotë që është e "pamundur ti lejohet IRJM hyrje në BE dhe NATO me emrin Republika Maqedonisë" dhe se "Slavomacedonasit e IRJM-së insistojnë edhe më tutje qëndrim e tyre këmbëngulës negativ në drejtim të zgjidhjes të çështjes së emrit".

Athina insiston Shkupi të përdorë emër të përbërë si Maqedonia "E epërme" ose "E re".

Politika e jashtme e Greqisë ndaj Maqedonisë është rezultat i ideologjisë të nacionalizmit etnik i cili dominon në shoqërinë greke që nga formimi i saj. Greqia e kundërshton ekzistimin e kombit maqedonas si dhe të pakicës maqedonase në territoret e Greqisë për arsye që pranimi i tillë do të ishte i kundërt me përrallat e homogjenisë-etnike dhe pastërtsisë të cilat e definojnë nacionalizmin etnik grek.³

Me veprimet e saja, Greqia disa herë ka shkelur Marrëveshjen e përkohshme. Në Preambullën e Marrëveshjes ndër të tjerat potencohet se "asnjëra palë nuk ka të drejtë të përzihet në punët e brendshme të shtetit". Nga pala maqedonase kjo është interpretuar asisoj që Greqia nuk ka të drejtë të propozon emër për përdorim intern apo të jashtëm dhe se ajo është çështje e brendshme e Maqedonisë. Duke u thirrur në dispozitat e nenit 3(1), mund të konkludohet se Greqia nuk e ka respektuar

³ QENDRA PËR HULUMTIM DHE KRIJIM TË POLITIKAVE, "Veto Maqedonise, fitore e nacionalizmit grek: si më tutje", Analizë e shkurtër nr.17, prill 2008.

pavarësinë politike të RM-së, dhe të drejtën që vetë të bën zgjidhjen e emrit kushtetues dhe me këtë përzihet në çështjet që janë në sferën e pavarësisë politike të vendit.

Sipas nenit 11(1) në kaptinën ku trajtohen institucionet ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale Greqia pajtohet që të mos bën obstrukcione rreth kërkesës për pranim të RM-së në çfarëdo organizatë në të cilën është anëtare, nëse shkohet me referencën e përkohshme IRJM.

Pas samitit të Bukureshtit, zyrtarët maqedonas kanë lënë anash çështjen e zgjidhjes së kontestit me emrin, duke u arsyetuar përpara qytetarëve se me asnjë kusht nuk do ta ndërojmë emrin kushtetues dhe nuk do të pranojmë kushtëzime në këtë drejtim.

Ishte i saktë vlerësimi i ndërmjetësuesit të OKB-së se zgjidhja e çështjes së emrit do të prolongohet për një kohë të gjatë për shkak të zgjedhjeve presidenciale në SHBA, zgjedhjeve lokale dhe presidenciale në pranverë në Maqedoni, mirëpo edhe zgjedhjet në Greqi në qershor.

Pas samitit në Bukuresht ishin të kjarta mesazhet nga Brukseli se pa zgjidhje të këtij problemi dhe zgjidhjes së pranueshme të ndërsjelltë, nuk mund të deblllokohet integrimi ynë në NATO dhe fillimi i negociatave me BE.

Janë përcaktimet strategjike të vendit tonë nga çka varen të gjithë qytetarët e Maqedonisë, dhe faktori kohë është më i rëndësishëm për IRJM sesa për Greqinë. Prandaj është detyrim i zyrtarëve maqedonas që të bëhet gjithëçka që është e mundur që kjo çështje të zgjidhet, me fjalë tjera të përpiqen që të arrihet deri te kompromisi i drejtë.

Duke pasush parasysh pozicionimin e SHBA-ve dhe përkrahjen e fuqishme për integrimin e vendit në NATO, RM nuk e shfrytëzoi këtë mundësi, përkrahje kjo që në të ardhmen mund të zbehet varësisht nga pozicionimi i presidentit të ri Barak Obama. Prandaj, në rafshin e politikës së jashtme nuk ishte shfrytëzuar kjo mundësi, por përkundrazi vëmendja ishte përkushtuar çështjeve të brendshme veçanërisht shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme në të cilat ishte humbur një periudhë shumë e vlefshme kohore.

Qëndrimi i palës maqedonase rreth çështjes së emrit është me saj vijon:

- gjatë negociatave nuk do të pranohet ndryshimi i emrit kushtetues por ndryshimi i referencës IRJM me formulim tjetër për përdorim ndërkombëtar.

- as vetë formulimi e as çfarëdo tjetër pjesë e vendimit nuk guxon të prek identitetin maqedonas.
- shumica e qytetarëve janë kundër çfarëdo ndryshimeve madje edhe kundër negociatave, megjithatë shumica e dëshirojnë anëtarësimin në NATO dhe BE.

Duke mos u dhënë rëndësi dizpozitave të marrëveshjes së përkohshme, argumentet në të cilat thirret pala maqedonase janë këto:

- kundërshtimi i Greqisë rreth emrit krijon poasojë politike në zhvillimin e organizatave ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare
- pozicioni grek i dërgon kriteret të cilat duhet të vlejné për të gjithë e që janë krijuar nga NATO, dhe me këtë krijohet mundësia e keqpërdorimit nëse çdo shtet parasheh një kriter shtesë për interesat e veta që do të vlen për aspirantët e rinj edhe pse ato i kanë plotësuar kriteret oficiale.
- zhvillimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore nuk realizohet duke vënë embargo (1994-1995) dhe mbyllur kufirin me Maqedoninë, ndërsa tani pengimin e mundësisë për anëtarësim në NATO.
- në samitin e Bukureshtit nuk funksionoi politika e dyerve të hapura të NATO-s sipas nenit 10 të Konventës së Aleancës Veri-atlantike
- ftesa për anëtarësim të kandidatëve potencial bëhet sipas vlerësimit rreth plotësimit të kriterëve të parashikuara në "Planin Aksional për anëtarësim", që bëhet nga Këshilli i Atlantikut verior.

Ky qëndrim i palës maqedonase ndër të tjerat ishte rezultat i asaj që pushteti aktual në vend në vend që në mënyrë objektive dhe të kurtë të parashtron të gjitha beneficionet dhe pasojat nga përcaktimet e mundshme, vendosi që me një politikë populiste këtë çështje ta shfrytëzon për qëllime të politikës së përditshme dhe në plan afatshkurtër të ngrit popullaritetin e vet, mirëpo me pasoja serioze afatgjate për ardhmërinë e shtetit.

Ndër të tjerat ishte shtruar edhe çështja e referendumit, si mënyrë e shprehjes demokratike të qytetarëve rreth kësaj çështje. Megjithatë, kjo njëherit nënkupton edhe ikje nga përgjegjësia politike dhe parashtron një dilemë tjetër: pse atëherë qeveria nuk vendos për një gjë të tillë për çka është e autorizuar nga vetë populli me dhënien e mandatit të qeverisjes me vendin. Një rrezik tjetër që vlen të potencohet nga mbajtja e një referendumi të tillë është se maqedonasit dhe shqiptarët mund të

fajësojnë njëri-tjetrin pasi që kanë qëndrime të kundërta zgjidhjes së kontestit të emrit. Një çështje e tillë madje mund të parashtrohet në referendum vetëm nëse arrihet kompromis rreth emrit me Greqinë.

Moszgjedhja e çështjes në fjalë është kontraproduktive dhe e pengon procesin e anëtarësimit në NATO dhe jep shenjë të keqe Brukselit për mospasjen e gatishmërisë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Në këtë drejtim i jepet argument i fuqishëm Greqisë se ja Maqedonia është pala e cila nuk dëshiron kompromis dhe e bllokun dhe dëmton procesin, gjë kjo që e vë në pozicion të pavolitshëm dhe rrit shtypjen ndërkombëtare ndaj Maqedonisë.

Opinionet e të gjithë atyre të cilët mendojnë se nuk do të jetë fundi i botës në rast të mospranimit në NATO dhe ngadalësimit të procesit të anëtarësimit në BE janë dështuese. Në rast të bllokadës më afatgjate të proceseve integrative dhe izolimit të vendit tonë, ne mund të flasim vetëm për mbijetim, e jo për zhvillim të gjithanshëm ekonomik dhe demokratik. Përveç kësaj, një situatë e këtillë afatgjate *status quo* mund të nxit edhe prishjen e marrëdhënieve ndëretnike në vend, që është me rëndësi kyçe për stabilitetin e brendshëm.

Identiteti nacional maqedonas si anjëherë deri më tani shpesh herë (keq)përdoret viteve të fundit. Megjithatë anjëherë nuk parashtrohet pyetja se a duhet që populli maqedonas të ndërton vlerat civilizuese në identitetin e vet nacional apo duhet të gjurmon lashtësinë e saj arkeologjike dhe ti bind të tjerët për ate se çka është e vërteta rreth identitetit maqedonas. Në fund të fundit pasojat e një politike të këtillë janë të dukshme dhe gjurmimi pas historisë vetëm mund të nxit dilema të tjera. Madje, çështja e emrit aspak nuk e prek identitetin nacional, por vetë emrin e shtetit. Në fakt, bëhet fjalë për emrin e shtetit të përbashkët të maqedonasve, shqiptarëve dhe të gjithë qytetarëve tjerë. Kjo është si pasojë e asaj se maqedonasit që prej pavarësisë së vendit, shtetin maqedonas e llogaritin si shtet ku ato identifikohen si shtet-komb, që as nuk është reale e as e mundshme një konstatim i tillë të jetë i saktë, por vetëm i rrezikshëm për vetë ekzistencën e shtetit në tërësinë e saj. Ndër të tjerat kjo ishte edhe arsyeja kryesore e konfliktit të vitit 2001, pasi që deri atëherë (me kushtetutën e 1991) kjoartë potenciohej se Maqedonia është shtet i maqedonasve në radhë të parë e mandej edhe i të tjerëve, duke i lënë këto të tjerët si qytetarë të kategorisë së dytë. Me Marrëveshjen e Ohrit kjo gjë u kjoartësua dhe të gjithë komunitetet u barazuan me vetë dispozitat e ndryshimeve kushtetuese, mirëpo akoma politikanët maqedonas veprojnë sipas retorikës së vjetër dhe se çështjen

e emrit e shohin si çështje që i tangon vetëm ato e jo të gjithë qytetarët. Absurditeti bëhet më i madh nëse kësaj ia bashkojmë edhe (mos)ineteresimin e subjekteve politike shqiptare në Maqedoni për çështjen e zgjidhjes së emrit, ku këto të fundit asnjëherë nuk kanë qenë të kyçur në procesin e negociatave rreth emrit, që është një gabim i madh politik. Në këtë rast qytetarët shqiptarë lihen në një pozitë të palakmueshme dhe bëhen viktimë e politikës zyrtare maqedonase dhe indiferencës së subjekteve politike shqiptare, rrethana këto që paraqesin pengesë në proceset euro-atlantike të vendit tonë të përbashkët.

Çështja e emrit ka krijuar ndarje etnike. Kësisoj, çështja e emrit tek maqedonasit është e natyrës ekzistenciale, ndërsa për shqiptarët kjo është më tepër e lidhur me zhvillimin e vendit në të gjitha fushat, përfshirë edhe sigurinë dhe ekonominë. Madje shqiptarët nuk janë aq të lidhur për emrin e shtetit, pasi që nuk e shohin veten as në himnën e as në flamurin e shtetit. Fryma e Marrëveshjes së Ohrit duhej të na çon drejt një Maqedonie të përbashkët pa bariere etnike, ku multikultura kuptohet si vlerë e një shoqërie demokratike. Në vend të kësaj, në Maqedoni secili komunitet interesohet për zhvillim të kulturës dhe interesave të veta, duke i anashkaluar ato të të tjerëve. Qytetarët ndahen në dy grupe interesi, maqedonasve u prezantohet e kaluara si interes i tyre themelor, ndërsa shqiptarëve proceset euro-atlantike u prezantohen si interes themelor.⁴ Këto qëndrime paralele u bënë akoma më të ndara, pasi që si qytetarë të RM-se nuk kemi qëndrime të njëjta se si të arrihen objektiva të përbashkëta, ndërsa është më tragjike kjo se bëhet në baza etnike.

Qytetarët e RM-së e lidhin anëtarësimin në NATO me përmirësimin e standardit jetësor dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendit. Çështjet e sigurisë dhe krizat në rajon edhe në RM kishin reflektim negativ në qëndrimet e opinionit publik ndaj NATO-s, mirëpo pas përforcimit të orientimit euro-atlantik të vendit, aleanca gëzon përkrahje të fuqishme në kontinuitet nga opinion publik jo vetëm për shkak të përmirësimit të

⁴ Duke pasur parasysh teorinë e zgjidhjes racionale, është e kurtë se shqiptarët më tepër i intereson anëtarësimi në NATO dhe BE sesa emri i shtetit.

⁵ Opinion publik nga 1995 e këndej: në vitin 1995 -60%, më pastaj kemi ulje të përkrahjes në vitin 2002 – 25% si rezultat i sulmeve të NATO-s ndaj Serbisë dhe konfliktit në Maqedoni, në maj 2004 arrijnë 53%, 2005 – 63%, dhe deri në 2008 – 90%. Sipas burimeve nga: Instituti për demokraci (2000-2004), Ministria e mbrojtjes (2004-2005), Televizioni A1 (2006), të cekura në Informatorin politik "Opinionit publik në RM për NATO-n", i Institutit për demokraci "Societas Civilis", nëntor 2006, Shkup.

sigurisë por edhe përmirësimin e gjendjes ekonomike si rrjedhojë e integritimeve euro-atlantike.⁵

Shumica e qytetarëve maqedonas nuk pajtohen me atë që RM ta ndërton emrin kushtetues të saj për tu bërë anëtare e NATO-s (60%), ndërsa 36% e qytetarëve pohojnë se duhet të ndërrohet emri në llogari të anëtarësimit, ndërsa 4% s'kanë përgjigje. Për sa i përket opinionit shqiptar, vlen të ceket se shqiptarët pranojnë ndërimin e emrit në favor të anëtarësimit në NATO dhe ate 94%. Sipas rezultateve nga anketa shumica e qytetarëve nga të gjitha komunitetet janë për vazhdimin e negociatave (78%), ndërsa 19% janë për ndërprerjen e negociatave, kurse 3% s'kanë përgjigje. Për dallim nga këto, shumica e shqiptarëve janë kundër ndërprerjes së negociatave 91%. Qëndrimet e këtilla të qytetarëve maqedonas arsyetohen me faktin se me vazhdimin e negociatave është vështirë ruajtja e emrit kushtetues të shtetit, ndërsa në anën tjetër politikanët vazhdimisht japin deklaratat e tyre se vazhdimi i negociatave nënkupton ndërimin e emrit.⁶

Maqedonasit nuk pranojnë ndryshim të emrit kushtetues të shtetit në llogari të anëtarësimit në NATO aleancën.⁷ Pjesa më e madhe e të anketuarëve nuk e kanë ndryshuar qëndrimin e tyre për NATO-n pas samitit në Bukuresht.

Të rëndësishme janë edhe rezultatet e anketave rreth opinionit të qytetarëve për besimin në NATO pas samitit në Bukuresht. Rreth 30% e të anketuarëve pohojnë se besimi i tyre është rritur, 23% prej tyre është zvogëluar, 28% i pandryshuar dhe 9% s'kanë dhënë përgjigje. Me rëndësi është që të potencohet se tek komuniteti maqedonas besimi është zvogëluar në 30% nga të anketuarit, ndërsa është rritur vetëm tek 6% e të anketuarëve, tek 37% ka mbetur e njëjtë, dhe 27% s'kanë dhënë përgjigje. Qëndrimi i komunitetit shqiptar është më i harmonizuar, kështu që 96% nga shqiptarët pas samitit të NATO-s kanë rritur besimin.⁸

Ardhmëria e RM-së është lehtë e parashikueshme, pa marrë parasysh atë se një numër i madh i analistëve tentojnë që të zbulojnë dhe

⁶ Center for Research and Policy Making, Ndryshimi i emrit për anëtarësim në NATO-pjesa 2, Komunikatë për publikun, 15.04.2008.

⁷ Anektat e fundit të Institutit për demokraci, e realizuar nga 7 deri 10 shtator 2008 tregojnë se rreth 70% e të anketuarëve janë kundër ndryshimit të emrit, ndërsa 22,5% shprehën për ndryshim të emrit, ndërsa 7,6% nuk kanë qëndrim të vet rreth kësaj çështje.

⁸ Rezultatet e anketës së Qendrës për hulumtime dhe krijim të politikave e realizuar me 12-13 prill 2008 ndaj 1100 qytetarëve duke respektuar kriteret për përkatësi etnike, gjinore dhe religjioze.

parashohin atë. RM do të jetë anëtare e NATO-s dhe BE-së apo nuk do të jetë? E gjithë kjo për shkak të bllokadës diplomatike greke e cila rezultoi nga vlerësimet e gabueshme të qeverisë maqedonase dhe Kryetarit të shtetit. Të dy këto (kryeministri dhe kryetari i shtetit) kanë pasur një kohabitacion të papëlqyeshëm dhe papërgjegjësi në menaxhimin me punët e shtetit në përgjithësi dhe në vecanti rreth çështjes së emrit të shtetit. Duke marrë parasysh divergjencat politike dhe veprimet e tyre në këtë drejtim, do të vijmë në përfundim se prioriteti më kryesor i tyre ka qenë mbajtja e rejtingut sa më të lartë e jo qasje serioze rreth zgjidhjes së kontestit me Greqinë. Dmth edhe çështja me të cilën preken interesat e jashtme të shtetit dhe integrimi në strukturat euro-atlantike është tentuar që të përdoret për qëllime të politikës ditore, në dëm të interesave të përgjithshme shtetërore dhe se një gjë e tillë do të reflektohet në ardhmërinë e këtij shteti.

Retorika e ashpër, provokimet e numërta dhe nxitja e apetiteve nacionaliste Maqedoninë e shëndruan në partner joserioz dhe të pasigurtë për çfarëdo qoftë marrëveshje diplomatike.

Me këtë qeveria maqedonase jep sinjale se nuk është aq me rëndësi anëtarësimi në NATO dhe marrja e datës për negocijatë me BE sesa emri.

Zyrtarët maqedonas në të ardhmen duhet patjetër të distancohen nga populizmi dhe nacionalizmi që e dëmtojnë atë, i kanosen pozitës ndërkombëtare dhe e ngadalësojnë rrugën drejt BE-së.

Qytetarët janë të brengosur për ardhmërinë e shtetit të tyre. Në vend të eksplodimit të ndjenjave nacionaliste, ndarja në patriotë dhe tradhtarë, glorifikimi i historisë antike, riemërimi i aeroporteve dhe komunave, ngritja e busteve, vënia e përmendoreve përpara qeverisë, qytetarët kërkojnë jetë normale dhe ardhmëri evropiane për vetë dhe gjeneratat e ardhshme.

Në këtë drejtim, kishte iniciativë qytetare të ndërmarë menjëherë pas dështimit në samitin e Bukureshtit nga 27 organizata civile, të cilat kanë reaguuar ndaj propagandës së theksuar të qeverisë, e cila implikon dëm serioz dhe e rrezikon integrimin evropian të RM-së. Organizatat civile kërkojnë nga qeveria që të ndërpret me informimin jo të drejtë dhe marrjen e vendimeve të cilat e rrezikojnë integrimin e shtetit në strukturat euro-atlantike. Potencohet se Maqedonia nuk guxon që të viktimizon 77 milion euro të përcaktuara për autostradën Tabanovc-Gjevgjeli për shkak të vendimit të qeverisë që autostradën ta emëron "Aleksandri i Madh". Nga kjo shumë 50 milion euro janë para greke, ndërsa 27 milion euro tjerat janë nga komponenta e tretë e IPA fondeve

për zhvillim rajonal. Emërimi i këtillë i autostradës paraqet shkelje të kritereve politike për bashkëpunim rajonal dhe ndeshet me rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për përparimin e RM-së në vitin 2008, ku qëndron se “duhet të mënjanohen aktivitetet të cilat mund të ndikojnë negativisht në marrëdhëniet fqinjësore.”

Maqedonia është shtet i cili thirret në BE, mirëpo lëviz në drejtim të kundërt përkatësisht vetë-izolim. Shteti ngulfatet në nacionalizëm, korrupsion, varfëri dhe i humb të gjitha pozicionet për kyçe në afat më të shkurtër në BE. Negocijatat për emrin janë plotësuar me manipulimin se lufta për emrin është në fakt luftë për identitetin maqedonas. Në fakt, e vërteta është që kompromisi me Greqinë praqet investim në ardhmërinë. Anëtarësimi në BE dhe NATO jo vetëm që është anëtarësim në shoqëri të organizuara të kombeve të privilegjuar, por paraqet diçka më tepër se pranim i vlerave të civilizuara. Nga këtu, Maqedonia jo vetëm që synon por edhe meriton të bëhet pjesë e asaj bote.

Veprimi i këtillë i palës greke dhe jo gatishmëria e palës maqedonase mund të nxitin pasojat të brendshme në Maqedoni në më tepër rafshe, dhe ate:

- politik dhe ate të sigurisë: për shkak të specifikave të brendshme RM ka klimë të ndjeshme politike dhe marrëdhënie të brishta etnike.
- stabilitetin e vendit: anëtarësimi në NATO dukshëm do të përmirësonte sigurinë dhe stabilitetin e shtetit, që janë parakushtet e para për tërheqjen e investimeve të jashtme, ndërsa anëtarësimi në BE do të kontribonte për kohezion të mëtejshëm politik dhe mbarimin e proceseve reformuese në sektorin publik.
- ekonomik: në një situatë kur standardi i qytetarëve stagnon, ndërsa zhvillimi ekonomik është i palakmueshëm, prosperiteti i shtetit varet nga integrimi i plotë në NATO dhe BE. Keqësimin e marrëdhënieve fqinjësore që do të ndikon edhe në zvogëlimin e bashkëpunimit ekonomik.

Tani parashtrohet pyetja: a duhet të insistojmë akoma në ermin “Republika e Maqedonisë” dhe të vazhdojmë me kontestin e gjatë dekadësh me Greqinë ose të gjejmë gjuhë të përbashkët për të mënjanuar pengesën kryesore për anëtarësim në NATO dhe BE?

Vlen të përfundojmë se Maqedonia në fund të fundit nuk është në pozicion të imponon vullnetin e vet në zgjidhjen e mosmarreveshjes rreth emrit me Greqinë, por duhet të bashkëpunon në mënyrë konstruktive për të kapërcyer pozitën e palakmueshme në të cilën gjendet tani në marrëdhëniet ndërkombëtare, gjë këtë të cilën disa herë

radhazi ia sugjerojnë edhe ekspertët ndërkombëtare dhe vendet tjera që kanë marrëdhënie miqësore me RM.

Është e natyrshme që gjatë negociatave diçka të sakrifikohet, meqenëse për tu arritur një marrëveshje rreth një çështje kontestuese është më se e nevojshme që palët të bëjnë lëshime dhe në asnjë mënyrë nuk mund të flasim për “humbës” apo “fitues”, por për zgjidhje të pranueshme për palët.

Maqedonia mes integritit në strukturat euro-atlantike dhe gjeopolitikës ballkanike

Abstrakt

Ky punim shkencor synon të paraqesë një analizë lidhur me shkaqet e mospranimit të Maqedonisë në organizatën politiko-ushtarake-NATO në Samitin e mbajtur vitin e kaluar në Bukuresht, si edhe pasojat që vijnë si rrjedhojë e këtij mospranimi. Meqenëse NATO kishte për qëllim ta zgjerojë shtrirjen e saj me tre shtete të reja në Ballkan gjë që do të ndikonte në stabilizimin e rajonit, mospranimi i Republikës së Maqedonisë në këtë organizatë në prill të vitit 2008, ka zgjuar shumë kundërshtime dhe ka shtuar mundësinë për jostabilitet rajonal. Punimi në fjalë do të shtjellohet përmes dy shtyllave: shkaqet dhe pasojat për mospranim. Në grupin e shkaqeve do të analizohen detajisht faktorët e brendshëm si politika jo e qartë e Maqedonisë dhe sfidat e saj të brendshme, si edhe ata të jashtëm – vetoja greke si pasojë e kontestit me emrin; ndërsa si pasojë e mundshme do të shtjellohet impakti negativ për Maqedoninë si një shtet tejet i brishtë dhe me tranzicion të tejzgjatur, ashtu edhe për tërë rajonin ballkanik i shquar me një jostabilitet të vazhdueshëm. Përfundimet e sjellura nga ky studim janë: (1) nevoja urgjente e profilizimit të politikës së brendshme të Maqedonisë në të mirë të integritimeve euro-atlantike, (2) praktika negative e shteteve ballkanike për të penguar anëtarësimin e shteteve të reja në strukturat euro-atlantike, sjell nevojën e reformimit të mekanizmit vendimmarrës të këtyre organizatave që kanë synim ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal.

¹ Magjistrante për Diplomaci pranë FAP-së

² Magjistralant për Diplomaci pranë FAP-së

1. NATO dhe gjeopolitika ballkanike

Sigurimi kolektiv është njëri nga parimet më të rëndësishme që u promovua pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Katërbëdhjetë pikat³ e presidentit amerikan Woodrow Willson parashihnin “formimin e një organizate të kombeve nën marrëveshje specifike me qëllim të dhënies së garancive të ndërsjella për pavarësi politike dhe integritet territorial, si shteteve të mëdha ashtu edhe atyre të vogla”.⁴ Parimi i sigurisë kolektive u skicua gjatë ndërtimit të sistemit të Versajës, pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Në traktatin që u nënshkrua në vitin 1919, për herë të parë u krijua një organizatë kolektive që do ruante paqen dhe sigurinë në botë me emrin Lidhja e Kombeve e cila ishte pararendëse e OKB-së. Qëllimet e Kombeve të Bashkuara janë: ruajtja e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, zhvillimi i marrëdhënieve miqësore mes kombeve dhe arritja e bashkëpunimit në zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare të natyrës ekonomike, sociale, kulturore ose humanitare.⁵ Megjithëse pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, ishin krijuar mekanizmat multilateralë të cilët do të garantonin paqen dhe sigurinë kolektive, rrethanat politike të cilat determinuan sistemin ndërkombëtar, diktuan krijimin e një organizate ushtarake e cila do t'i shërbente kryesisht kontinentit evropian për t'u mbrojtur nga Bashkimi Sovjetik i cili në atë kohë përbënte kërcënim për demokracitë perëndimore.

Traktati i Brukselit në vitin 1948 vuri bazat e një sistemi evropian të sigurisë, ndërsa akti themelues i Organizatës së Atlantikut Verior ishte Traktati i Uashingtonit⁶, ku përveç shteteve evropiane, në këtë organizatë u bënë bashkëthemeluese edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanadaja.

NATO me kalimin e kohës, ka pësuar transformime të mëdha, ndërsa siç shprehen studjuesit Jackson dhe Dutkiewicz “ajo ka ecur drejt një procesi të tërë të metamorfozës”.⁷ NATO u krijua në periudhën e parë të Luftës së Ftohtë, ndërsa në përputhje me ndryshimin e rrethanave dhe

³ “Fourteen conditions of peace”, Fjalim i mbajtur nga Woodrow Willson në Kongresin amerikan më 8 Janar 1918. Selected addresses and public papers of Woodrow Wilson, New York: Boni and Liveright, 1918. Fq. 244

⁴ Po aty, fq. 249

⁵ Karta e OKB-së. Neni 1. Marrë nga <http://www.un.org/aboutun/charter/chapter1.shtml> më 19 mars 2009

⁶ The North Atlantic Treaty, Washington D.C. - 4 April 1949. Marrë nga <http://www.nato.int/docu/basic/txt/treaty.htm> më 18 mars 2009

⁷ “NATO looks East”, edited by Robert J. Jackson and Piotr Dutkiewicz, London: 1998. Fq. 1

sistemit ndërkombëtar në tërësi, ajo u konsolidua si organizatë me karakter politiko-ushtarak pas shpërbërjes së ish Bashkimit Sovjetik. Në vitin 1999 anëtarët e NATO-s kishin miratuar të ashtuquajturin Koncepti strategjik⁸, i cili ishte një version i përpunuar dhe i plotësuar i strategjisë së vitit 1991. Me shfaqjen e një Evrope gjithnjë e më të integruar dhe me zhvillimin e strukturës së sigurisë euro-atlantike, lindin edhe sfidat e reja të kësaj organizate.

Qëllimi themelor i kësaj organizate - "ruajtja e lirisë dhe sigurisë"⁹ në zonën euro-atlantike dhe parimi udhëheqës i saj - "angazhimi i përbashkët dhe bashkëpunimi i ndërsjellë mes shteteve sovraane në mbështetje të pandashmërisë së sigurisë"¹⁰, kushtëzojnë krijimin e politikave dhe strategjive të reja brenda fushëveprimit të kësaj organizate. Andaj edhe Koncepti strategjik që u miratua në vitin 1999 përveç aktiviteteve për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, atyre për partneritet bashkëpunim dhe dialog, parashikoi edhe politikën e zgjerimit të organizatës. "Politika e dyerve të hapura" e NATO-s u parapara që në Traktatin e Uashingtonit, në nenin 10¹¹ të tij. Kjo politikë promovon mundësinë e aderimit të shteteve të tjera në këtë organizatë, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit dhe bashkëpunimit, bashkimit të shteteve për mbrojtje kolektive, ndërtimit të një Evrope të bashkuar dhe me vlera të përbashkëta demokratike.

Ballkani gjithmonë ka qenë një zonë shumë e rëndësishme gjeostrategjike, e karakterizuar me një diversitet të theksuar të orientimit gjeopolitik. Kjo gjeopolitikë ka çuar në fragmentarizimin e këtij gadishulli të rëndësishëm për Evropën. Pozicioni i shteteve u determinua nga dy blloqet e kundërta. Prandaj, struktura gjeopolitike e këtij rajoni gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë kushtëzohet nga formula 2+2+2".¹² Greqia e Turqia ishin antarësuar në aleancën veri-atlantike që në vitin 1952, Rumania e Bullgaria bënë pjesë në Paktin e Varshavës, ndërsa Jugosllavia e Shqipëria në atë kohë mbetën jashtë dy blloqeve.

⁸ The Alliance's Strategic Concept, approved by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Washington D.C. on 23rd and 24th April 1999. Marrë nga <http://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-065e.htm> më 19 mars 2009.

⁹ Po aty. Pika 6.

¹⁰ Po aty. Pika 8.

¹¹ Neni 10 është si vijon: "Palët munden, me anë të marrëveshjes unanime, të ftojnë ndonjë shtet tjetër evropian që do t'i ndjekë parimet e këtij traktati dhe do të kontribuojë në sigurinë e zonës veri-atlantike, të aderojë në këtë traktat...". The North Atlantic Treaty, Washington D.C. - 4 April 1949. Marrë nga <http://www.nato.int/docu/basic/txt/treaty.htm> më 19 mars 2009

¹² Lisen Bashkurti, Mbi të drejtën ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, Tiranë: 2006. Fq.168

Me mbarimin e Luftës së Ftohtë dhe shpërbërjen e ish Bashkimit Sovjetik, dolën shumë shtete të cilat ardhmërinë e tyre më të sigurtë e shihnin në integrimin në strukturën euro-atlantike. Kështu, pothuajse të gjitha shtetet ballkanike shprehën interesat e tyre strategjike për anëtarësim në UE dhe NATO, gjë e cila sipas studiuesit Martin Kahl, u shndërrua në “parim kryesor të politikave të tyre të jashtme dhe të sigurisë”.¹³ Çështja e anëtarësimit në këto organizata, është parësore pothuajse për çdo shtet që ka dalë nga sistemi socialist, të cilët ndodhen në fazën e tranzicionit. Këto prioritetë të shteteve në tranzicion, u përputhën me qëllimet e kësaj organizate për të zgjeruar zonën e saj mbrojtëse të sigurisë, gjegjësisht “për të shtuar sigurinë dhe stabilitetin në tërë zonën euro-atlantike”.¹⁴ Andaj dhe aleanca pati përpiluar disa plane veprimi për të arritur këtë qëllim të saj dhe për të lehtësuar procesin integruar të shteteve aspiruese. Në vitin 1994, në Samitin e Brukselit, NATO pati filluar me planin e veprimit për partneritet individual të emërtuar *Partneriteti për paqe*, ndërsa më vonë në samitin e Uashingtonit (1999), edhe me *Planin e veprimit për anëtarësim*. Programi i “Partneritetit për Paqe” kishte për qëllim vendosjen e marrëdhënieve të reja të sigurisë si mekanizëm i largimit të kërcënimeve të paqes në Evropë, duke i ndërtuar urat lidhëse në mes NATO-s dhe vendeve të partneritetit për paqe. Përmes këtij programi, vendeve post-socialiste, e sidomos shteteve të Evropës Qëndrore dhe atyre ballkanike, iu bë e qartë se bashkëpunimi me Paktin Veriatlantik është i domosdoshëm për të tejkaluar vështirësitë e reformave të brendshme. Ndarja e vlerave të përbashkëta në mes Aleancës Veriatlantike dhe shteteve aspirante ka qenë një vizion i qartë rreth zgjerimit të NATO-s, në rajonin që dikur ishte i ndarë përmes perdes së hekurt. Aleanca gjithashtu, përmes partneritetit për paqe ndihmoi integrimin dhe unifikimin e Evropës, duke sjellë stabilitet dhe konsolidim të demokracisë.

Pas konflikteve të shumta në Ballkan, ai u bë pjesë e këtyre planeve të veprimit duke intensifikuar marrëdhëniet miqësore me këtë organizatë dhe duke kontribuar në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit, parandalimin dhe zgjidhjen e krizave në këtë gadishull, si edhe duke qenë pjesë e misionëve të kësaj organizate. Vendet ballkanike filluan kështu procedurën për integrimin e plotë në këtë aleancë të rëndësishme

¹³ NATO looks East, edited by Robert J. Jackson and Piotr Dutkiewitz, London: 1998. Fq.13. Edhe Maqedonia si prioritet strategjik të politikës së jashtme të saj kishte vendosur integrimin në NATO dhe UE. “Годишна национална програма за подготовки за членство на РМ во НАТО 2006-2007”, http://www.vlada.mk/files/doc/programa_clenstvo_NATO.pdf

¹⁴ Study on NATO Enlargement issued by the Heads of State and Government participating in the Meeting of the North Atlantic Council. Kapitulli I, pika 2. Marrë nga <http://www.nato.int/docu/basicxt/enl-9502.htm>, më 20 mars 2009.

politiko-ushtarake. Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia të cilat ishin të përfshira në *Planin e veprimit për anëtarësim*, në vitin 2003 ecën një hap përpara. Ato të tria së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në maj të vitit 2003 nënshkruan Kartën e Adriatikut, në të cilën shprehej qartë “përkushtimi për forcimin e përpjekjeve individuale dhe bashkëpunuese për të intensifikuar dhe nxitur reformat e brendshme, të cilat kontribuojnë në rritjen e sigurisë, prosperitetit dhe stabilitetit në rajon.”¹⁵ Karta e Adriatikut ishte inspiruar nga grupimet e mëhershme siç ishin ato të Vilniusit dhe Vishegradit të cilët patën përdorur mënyrë të ngjashme për t’u integruar në strukturat euro-atlantike. Qëllimi i përbashkët i vendeve nënshkruese dhe SHBA-ve ishte integrimi i këtyre shteteve në organizatat evropiane dhe ato transatlantike dhe rritja e bashkëpunimit mes tyre.

Me transformimin e NATO-s pas Luftës së Ftohtë, ndryshuan edhe qëllimet e saj. Ajo po hyn tash në dekadën e gjashtë të ekzistencës së që nga krijimi i saj. Kjo organizatë u transformua nga një aleancë ushtarake mbrojtëse, në një organizatë që promovon sigurinë dhe stabilitetin edhe jashtë zonës euro-atlantike. Andaj për ta arritur këtë qëllim madhor nevojitet integrimi i plotë i tërë aktorëve evropianë.

Ballkani si një rajon i rëndësishëm gjeostrategjik zë vend shumë të rëndësishëm në prioritetet e NATO-s. Historikisht Ballkani ka qenë rajon ku janë gëshetuar interesat e fuqive të mëdha që nga periudha e Koncertit të Evropës e deri në fundin e Luftës së Ftohtë. Diplomacia Ruse këtë territor tradicionalisht e kishte përjetuar si sferë të ndikimit të saj.¹⁶ Prandaj dhe politika amerikane, pikërisht për shkak të specifikasitetit të këtij rajoni, testoi mundësitë reale politike dhe ushtarake të dimensionit të veprimit rus, jo vetëm në Ballkan, por dhe më gjerë. NATO dëshmoi se ajo është një organizatë që ruan paqen dhe sigurinë në tërë territorin evropian. Me këtë rast, Shtetet e Bashkuara i treguan edhe pjesës tjetër të kontinentit vendin dhe rolin e Federatës Ruse në rendin e ri botëror. Intervenimi i NATO-s i dha fund luftërave dhe gjenocidit në ish Jugosllavi duke vendosur misionë paqeruajtëse si garancë të paqes dhe sigurisë. NATO luajti një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm edhe gjatë konfliktit në Maqedoni, duke u angazhuar politikisht dhe ushtarakisht në

¹⁵ Karta e Adriatikut, e nënshkruar në Tiranë më 2 maj 2003 nga përfaqësues të SHBA-ve, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kroacisë. Pika 2 e kartës. Versioni i saj në anglisht gjendet në <http://www.america.gov/st/washfile-english/2003/May/20030502165618rennefl0.4553644.html> më 20 mars 2009. Ndërsa versionin shqip mund ta gjeni në http://albanian.tirana.usembassy.gov/06pr_0411.html

¹⁶ Vukadinoviq, R., Kosovska kriza i ruska vanjska politika, Europska unija-pravni, gospodarski i politicki aspekti”, Informator, Nr.4780-4782, Zagreb, 29 dhjetor 1999 dhe 1-5 janar 2000 ff, 5-9

menaxhimin dhe zgjidhjen e krizës¹⁷. Strategjia e NATO-s për Ballkanin ka për qëllim zgjerimin e kontrollit të saj mbi këtë rajon. Përmes asistencës që ajo u jep shteteve aspirante, kontribuon në stabilizimin e Ballkanit turbulent.

2. Samiti i Bukureshtit dhe mospranimi i Maqedonisë në NATO

Samiti i Bukureshtit i vitit 2008 shtroi nevojën e draftimit të një "Koncepti të ri strategjik". Në këtë samit u diskutua edhe për çështjen e zgjerimit të kësaj aleance, gjegjësisht anëtarësimin e vendeve të Kartës së Adriatikut. Specialisti i çështjeve evropiane Paul Gallis, në raportin e tij drejtuar Kongresit amerikan lidhur me Samitin e Bukureshtit shpreh qëllimin e organizatës për të ndërmarrë këtë hap:

*"Asnjëra nga këto shtete nuk ka forcë ushtarake të mjaftueshme dhe të aftë që të mund të japë ndonjë kontribut domethënës në operacionet aleate. Megjithatë duke marrë parasysh jostabilitetin e vazhdueshëm në Evropën Juglindore, si pasojë nga kundërshtimi i ashpër i Serbisë ndaj pavarësisë së Kosovës, këto tri candidate mund të kontribuojnë në stabilitetin e rajonit"*¹⁸

Në këtë samit, Shqipëria dhe Kroacia u ftuan që t'i fillojnë bisedimet për t'iu bashkëngjitur Aleancës. Këto dy shtete "kanë treguar përkushtim ndaj sigurisë sonë të përbashkët dhe vlerave të përbashkëta të NATO-s, ndërsa pranimi i tyre do ta forcojë sigurinë për të gjithë në zonën euro-atlantike dhe do të na çojë neve më afër qëllimit tonë – një Evropë e plotë, e lirë dhe në paqe"¹⁹. Ky pranim ka rëndësinë e tij në tre dimensione. Së pari, në dimensionin lokal ky pranim ka ndikuar në zhvillimin e shteteve individualisht. Ai do t'u ndihmojë Kroacisë dhe Shqipërisë të ecin përpara në rrugën e tyre drejt reformave dhe harmonizimit të legjislacioneve të tyre në pajtim me ato të shteteve

¹⁷ Tri mësimet e njohura të mësuara nga konfliktet në ish Jugosllavi janë: aleatët mund të jenë efektivë në qoftë se veprojnë herët, në qoftë se flasin njëzëri dhe në qoftë se janë të përgatitur të përdorin një sasi force për të mbështetur pozicionin e tyre. Lexo më shumë: NATO and European security: alliance politics from the end of the Cold War to the age of terrorism, edited by Alexander Moens, Lenard J. Cohan and Allen G. Sens, London, 2003, fq. xxi

¹⁸ CRS Report for Congress. "The NATO Summit at Bucharest", 2008. Paul Gallis, specialist in European Affairs, Foreign Affairsm Defence and Trade Division. Congressional Research Service, the Library of Congress. <http://digital.library.unt.edu/govdocs/crs/permalink/meta-crs-10731:1>

¹⁹ Bucharest Summit Declaration. Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Bucharest on 3 April 2008. Marrë nga <http://www.nato.int/docu/pr/2008/p08-049e.html> më 23 mars 2009

anëtare në strukturat euro-atlantike. Ky proces ka për qëllim stabilizimin e brendshëm politik duke i shndërruar këto shtete në faktor stabilizues për tërë rajonin. Së dyti, në këndvështrimin rajonal, ky akt është një fillim i ri për tërë Ballkanin Perëndimor. Përderisa në shekujt e mëparshëm po edhe në këtë shekull Ballkani Perëndimor kishte qenë një rajon që kishte prodhuar vetëm kriza e luftëra, përqafimi i koncepteve euro-atlantike përgatit Ballkanin që të jetë një hapësirë që do të reflektojë stabilitet dhe qëndrueshmëri. Së treti, dimensionin ndërkombëtar i pranimin të këtyre dy shteteve ballkanike në NATO, përfshin mundësinë e Shqipërisë dhe Kroacisë si dhe rajonit në tërësi për të kontribuar në mbrojtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Në këtë samit Maqedonisë nuk iu dha ftesë për fillim të bisedimeve për pranim në këtë aleancë. Kjo që një sinjal jo i mirë si për të ardhmen e këtij shteti të brishtë ashtu edhe për tërë rajonin. Korrespondentja e BBC për çështje evropiane raportonte nga Bukureshti se: "Vendimi për të mos ftuar Maqedoninë së bashku me Kroacinë dhe Shqipërinë rrezikon dërgimin e sinjaleve të përziera dhe rritjen e frikës për jostabilitet në rajon i cili edhe ashtu po lëkundet nga Serbia për shkak të deklaramit të pavarësisë së Kosovës."²⁰ Mospranimi i këtij shteti multi-etnik, i cili duke marrë parasysh pozicionin e tij gjeografik, rezulton të jetë shumë i rëndësishëm për gjeopolitikën ballkanike dhe evropiane, zgjoi shqetësime si në strukturat e brendshme të shtetit ashtu edhe te faktori ndërkombëtar. Mospranimi i Maqedonisë në NATO dhe ndarja nga vendet nënshkruese të Kartës së Adriatikut për Maqedoninë do të thotë dështim dhe humbje e madhe.

2.1. Shkaqet për mospranim

Megjithëse deri tek opinioni i gjerë, akti i mospranimit të Maqedonisë në NATO u interpretua se ishte vetëm shkak i vetos greke, lidhur me çështjen e emrit, *de facto* ekzistojnë edhe faktorë të tjerë që kanë ndikuar në këtë vendim. "Maqedonia përballet me të tjera probleme përveç këtij, por çështja e emrit mbulon gjithçka" ishte shprehur Doris Pack gjatë një debati në Shkup menjëherë pas Samitit të Bukureshtit.²¹

Faktorët që kanë ndikuar në mosmarrjen e ftesës për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, përfshijnë dy segmente: të brendshëm dhe të jashtëm.

²⁰ Oana Lungescu, "Nato Macedonia veto seeks tension". BBC News. (04/04/2008). Marrë nga: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/7329963.stm> më 25 mars 2009.

²¹ "Doris Pack: Uncertain EU future for Macedonia without name compromise", Macedonian Information Agency, April 5, 2008.

Faktorët e brendshëm

Organizatat euro-atlantike vazhdimisht promovojnë politikën e dyerve të hapura dhe zgjerimit, por kushtet²² të cilat ato kanë vënë për anëtarësim të shteteve të reja janë shumë të përpikta dhe përfshijnë shumë aspekte. Rruga bëhet edhe më e vështirë kur bëhet fjalë për shtete tejet të brishta, të dala nga sisteme socialiste, të cilat akoma mbeten në rrugën e gjatë të tranzicionit, me probleme të brendshme dhe me sfida të mëdha para vetes. Maqedonia vazhdon të ballafaqohet me këto sfida. Ndryshe nga Sllovenia dhe Kroacia, Maqedonia u pavarësua në mënyrë paqësore, me anë të referendumit në të cilin morrën pjesë vetëm maqedonasit. Kështu, përderisa deri në vitin 2001 Maqedonia përmendej si model paqeje në Ballkan, e tëra kjo ishte një fasadë meqë përbrenda problemet thelloheshin, ndërsa tensioni ndëretnik rritej gjithnjë e më shumë.²³ Në vitin 2001 Maqedonia u lëkund nga një konflikt i armatosur maqedono-shqiptar. Me mbështetjen dhe ndihmën e faktorit ndërkombëtar, u arrit një marrëveshje që u emërtua Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e cila i dha fund krizës dhe prezantoi ndryshime të reja në sistemin kushtetues dhe politik të Maqedonisë.

Përkundër mendimit të Savo Klimovskit, i cili shkruan se intervenimet në Preambulën e Kushtetutës janë bërë në shpirtin e konstitucionalizmit evropian dhe shkëputjes radikale nga koncepti tradicional i shtetit komb,²⁴ përfaqësimi i shqiptarëve nëpër institucionet shtetërore edhe pas tetë vjetësh mbetet vetëm një premtim i parealizuar, i shkruar vetëm në letër. Shqiptarët akoma trajtohen si qytetarë të dorës së dytë megjithëse ata përbëjnë më shumë se 25% të tërë popullsisë që jeton në këtë shtet.²⁵

Kriteret të cilat Maqedonia duhet t'i përmbushë për t'u anëtarësuar në NATO janë pothuajse të ngjashme me ato të Kopenhagës për

²² Kushtet e vendosura nga NATO të cilat shtetet aspirante duhet t'i plotësojnë përfshijnë: funksionimin e sistemit politik demokratik të bazuar në ekonominë e tregut, trajtimi i drejtë i minoriteteve, angazhimi për zgjidhjen paqësore të konflikteve, aftësia dhe vullneti për të kontribuar në operacionet e NATO-s dhe angazhimi për marrëdhëniet demokratike civilo-ushtarake dhe strukturat institucionale. Për më tepër lexo <http://www.nato.int/issues/enlargement/index.html>. Marrë më 25 mars 2009.

²³ Albulena Halili, "Ndryshimet kushtetuese në RM sipas Marrëveshjes së Ohrit", maj 2003.

²⁴ Dorëshkrim. Klimovski, S., Mitkov, V., Treneska, R., Karakamisheva, T., Ustavno ureduvanje na Republika Makedonija, Prosvetno Dello, Skopje, 2003, faq. 36

²⁵ Megjithëse me regjistrimin e fundit të vitit 2002 ishte regjistruar një numër prej 25%, numri i popullatës shqiptare përfaqëson 33% nga tërë numri i popullsisë që jeton në Maqedoni. Rahim Veliu: "Geographical span and the Albanian population movement in Macedonia" Tetovë, 2002. Fq.40

anëtarësim në Unionin Evropian. Raporti i progresit për Maqedoninë i përgatitur nga Komisioni Evropian në fund të vitit 2007 ka vlerësuar jo mirë progresin e bërë nga Maqedonia lidhur me përmbushjen e kriterëve të Kopenhagës, sidomos të atyre politike të cilat përfshijnë: stabilitetin e institucioneve për të garantuar demokraci, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave, bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore, respektimin e obligimeve ndërkombëtare etj.²⁶ Organizimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike janë njëri ndër kriteret bazë politike për anëtarësim në organizatat euro-atlantike. Maqedonia organizoi zgjedhjet parlamentare ku u vunë re parregullsi të shumta dhe përdorje e dhunës. Poashtu, në periudhën para Samitit të Bukureshtit, në Maqedoni pati shumë konflikte politike madje edhe përdorim të dhunës fizike në parlament, të cilat u pasqyruan negativisht në punën e këtij institucioni si një ndër organet më të larta të shtetit. Këto konfrontime politike pengojnë funksionimin e rregullt të institucioneve demokratike në vend, si dhe ngadalësojnë reformat e nevojshme të cilat janë kusht për anëtarësimin e Maqedonisë në strukturat euro-atlantike. Mosrespektimi i pakicave, ka dëmtuar imazhin e Maqedonisë në arenën ndërkombëtare. Gjithnjë sipas raportit të UE-së për Maqedoninë i cili ishte botuar pak muaj para Samitit të Bukureshtit, thuhej se integrimi i pakicave mbetet mjaft i kufizuar. Për vetë ekzistencën e Maqedonisë shqiptarët janë faktori numër një ndërsa kur vjen në pyetje qeverisja e vendit, ata shndërrohen në kategori dytësore. Ata mbeten në dizavantash pothuajse në të gjitha sferat.

Duke marrë parasysh se kushtet dhe procedurat për anëtarësim në të dyja këto organizata, në të cilat Maqedonia ka shprehur prioritetet e saj për t'u integruar, janë pothuajse të njëjta, përfundojmë se Maqedonia ka pasur shumë zbrazëtira në plotësimin e kriterëve për anëtarësim që para Samitit të Bukureshtit. Martin Erdman²⁷ megjithëse kishte lavdëruar politikën e suksesshme rajonale të Maqedonisë dhe tërheqjen e investimeve, ai kishte numëruar kërkesat kryesore të cilat Maqedonia

²⁶ The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2007 Progress Report. SEC (2007) 1432. Commission of the European Communities. Brussels, 2 November 2007. Gjithashtu lexo edhe Raportin e Departamentit të shtetit të SHBA-ve për vitin 2008, në pjesën ku flitet për Maqedoninë thuhet se Maqedonia zvarritet me reformat gjyqësore duke shtuar se presioni politik dhe frikësimet ndikojnë negativisht në efikasitetin e gjyqësisë. Poashtu sipas këtij raporti vlerësohet se tensionimi mes popullatës maqedonase dhe shqiptare vazhdon të ndikojë në sferat si arsimi, punësimi dhe pjesëmarrja politike. Shqipmedia. 26 shkurt 2009

²⁷ Martin Erdman është asistent i sekretarit general të NATO-s për çështje politike dhe politikën e sigurië si dhe udhëheqës i ekipit i cili vlerëson progresin e Maqedonisë për rrugën e saj drejt aleancës.

duhet t'i përmbushë për të siguruar një ftesë për t'iu bashkuar NATO-s. Ato përfshinin: së pari, qëndrueshmërinë e procesit reformues të Maqedonisë dhe zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit; së dyti, përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, dialogun e qëndrueshëm dhe bashkëpunimin mes partive politike dhe stabilitetin politik afatgjatë.²⁸ Procesit reformues është shumë i ngadaltë, reformat në gjyqësi kanë ngecur, ndërsa zbatimi i Marrëveshjes së Ohrit ka kohë që është lënë anash dhe është neglizhuar nga udhëheqësit e Maqedonisë. Marrëdhëniet ndëretnike gjatë kësaj kohe kishin vazhduar të mbeten shumë të brishta duke kulminuar kohë pas kohe përmes fërkimeve dhe përplasjeve të ndryshme sidomos në rajonet multietnike.²⁹

Në fillim të vitit të kaluar, kryeministri i Maqedonisë Nikolla Gruevski kishte vizituar NATO-n për të diskutuar lidhur me raportin e progresit brenda *Planit të veprimt për anëtarësim*. Aleatët ishin shprehur se “ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka bërë progres në zbatimin e reformave politike, ekonomike dhe ushtarake, por akoma duhet të punohet”³⁰, duke vazhduar se “përpjekjet për reforma të qëndrueshme do të mbeten kruciale për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë që ajo të arrijë aspiratat e saj euro-atlantike”.³¹ Sipas këtyre deklaratave të shteteve aleate, shihet që ato kanë paralajmëruar qartë disa nga shkaqet për shkak të së cilave Maqedonia nuk do ta marrë ftesën për anëtarësim në këtë aleancë tre muaj më vonë.

Pra, vetë Maqedonia bart pjesën më të madhe të fajit për mosanëtarësimin e saj në NATO. Ajo më kot kërkon fajtorin për këtë mospranim jashtë kufijve të saj. Përveç zvarritjes së procesit të zgjidhjes së çështjes së emrit me Greqinë, struktura shtetërore maqedonase kishte zvarritur plotësimin e kriterëve të caktuar që më parë nga NATO-zbatimin e reformave të brendshme dhe zhvillimin e konceptit të bashkëjetesës në shtetin multi-etnik siç është Maqedonia.

²⁸ “NATO urges more Macedonia reforms”, November 12, 2007. Macedonian news. Marrë nga <http://www.vmacedoniannews.com/2007/11/nato-urges-more-macedonia-reforms.html> më 26 mars 2009.

²⁹ Vlen të theksohet si shumë tensionues rasti me nxënësit e qytetit të Strugës

³⁰ “Prime Minister of former Yugoslav Republic of Macedonia discusses membership aspirations with NATO Allies”. 23 January 2008. NATO official web page.

³¹ Po aty.

Faktorët e jashtëm

Moszgjidhja e kontestit me Greqinë lidhur me emrin kushtetues të Maqedonisë, ishte ndër shkaqet kryesore që Maqedonia nuk mori ftesë për anëtarësim në organizatën më të madhe për ruajtjen e sigurisë në zonën euro-atlantike. Në deklaratën e dhënë nga kryetarët dhe kryeministrat e shteteve pjesëmarrëse në takimin e Këshillit Veri-Atlantik në prill 2008, u tha që “megjithëse në kornizat e Kombeve të Bashkuara shumë aktorë kishin punuar fort që të zgjidhin çështjen e emrit, kjo gjë s’ishte arrirë, andaj edhe ftesa për Maqedoninë do të zgjatet deri sa të arrihet një marrëveshje e pranueshme për të dyja palët”.³² Kontesti i Maqedonisë me Greqinë ka filluar që nga pavarësimi i saj, ndërsa përpjekjet për zgjidhjen e tij kanë filluar që nga viti 1995, me ndërmjetësimin e Kombeve të Bashkuara. Sipas grekëve emri kushtetues i Maqedonisë vë në pah synime territoriale mbi një rajon verior të Greqisë me të njëjtin emër dhe paraqet keqpërdorim të traditës kulturore helenike.

Ky kontest nuk duhet të shikohet vetëm nga këndi bilateral në mes Greqisë dhe Maqedonisë. Për të pasur një tablo më të qartë është e domosdoshme që të kthehemi në retrospektivë, meqë zanafilla e këtij problemi lind që nga shthurria e Perandorisë Osmane dhe ka një gamë trekëndore. Traktati i Shën Stefanit³³ kishte krijuar Bullgarinë e Madhe e cila brenda saj përfshinte edhe Maqedoninë e Egjeut, që mund të merret si një pikënisje e ftohjes së raporteve në mes Greqisë dhe Bullgarisë për mbizotërim të Maqedonisë së Egjeut. Lufta e Dytë Ballkanike kishte rezultuar me një aleancë në mes të Greqisë dhe Serbisë kundër Bullgarisë, e cila përfundoi me Traktatin e Bukureshtit³⁴ në gusht të vitit 1913. Përmes këtij traktati, Greqia futi nën zotërimin e saj Maqedoninë e Egjeut. Ndërsa me Traktatin e Neit³⁵, Bullgaria humbi Thrakën

³² Bucharest Summit Declaration. Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Bucharest on 3 April 2008. Marrë nga <http://www.nato.int/docu/pr/2008/p08-049e.html> më 23 mars 2009

³³ The Preliminary Treaty of Peace, signed at San Stefano, 1878 <http://www.uoregon.edu/~kimball/1878mr17.SanStef.trt.htm>

³⁴ Peace treaty of Bucharest signed on 28 July/10 august 1913 between Rumania, Greece, Montenegro, Bulgaria and Serbia. R.B. Mowat, Selected Treaties and Documents 1815-1916, Oxford : Clarendon Press, 1916, pp.121-123; Në frëngjisht: Nouveau Recueil, 3me serie, t. viii ; Shih gjithashtu Jean-Arnault Dérens, Balkans: la crise, Editions Gallimard, 2000, ff. 54-58 dhe La République de Macédoine, sous la direction de Christophe Chiclet et Bernard Lory, Paris, 1998, ff. 16-20

³⁵ Treaty of peace between the allied and associated powers and Bulgaria and Protokol, signed at Neuilly-sur-Seine, November 27, 1919. Biblioteka britanike. Koleksioni i Azisë. IOR/L/E/7/1202, Folderi 380(vi)

Perëndimore, e me këtë edhe daljen në Egje, e cila edhe sot është nën sovranitetin e Greqisë. Ky fakt ka rritur frikën e revanshit të Bullgarisë ndaj Greqisë për Maqedoninë e Egjeut dhe Thrakën Perëndimore, i cili mund të merret edhe si arsye e përplasjes së Greqisë me Maqedoninë për çështjen e emrit. Vetë politika e Sofjes vazhdon ta konsiderojë popullsinë sllave të Maqedonisë me etnogjenezë bullgare, duke mos njohur kombin maqedonas dhe as gjuhën maqedonase. Bullgaria deri tani ka ndarë me mijëra pasaporta bullgare³⁶ në Maqedoninë Lindore duke mos përjashtuar as zyrtarë qeveritarë të Maqedonisë. Ky fakt sigurisht që ka trembur Greqinë, e cila kundërshton emrin kushtetues të Maqedonisë. Greqia ka frikë nga mundësia e bashkimit të Maqedonisë me Bullgarinë, pasi që Bullgaria mund të kërkojë në emër të Maqedonisë pjesën e Maqedonisë së Egjeut e cila gjendet nën Greqinë. Nga ana tjetër edhe kontesti me Serbinë për çështje të kishës vazhdon akoma të zvarritet. Prandaj Qeveria e Maqedonisë duhet të zbatojë dokumentet e nënshkruara me Bashkimin Evropian dhe NATO-n, të cilat janë parametra për rregullimin e fqinjësisë së mirë në mes shteteve. Në të kundërtën problemi mund të zgjerohet, nga një Maqedoni të kalohet në tri Maqedoni: atë të Egjeut, të Pirinit dhe të Vardarit.

Megjithatë, Greqia tashmë ka pranuar prezencën e fjalës “maqedoni”, por e ka kushtëzuar atë me shtimin e epiteteve si “veriore”, “e re”, “shkupi” etj. Nga ana tjetër Qeveria e Maqedonisë s’është treguar e gatshme për t’i kontribuar një zgjidhjeje fleksibile e cila do të ishte e pranueshme për të dyja palët. Ajo nuk ka hezituuar të bëjë veprime madje shumë provokuese³⁷ ndaj Greqisë të cilat janë dënuar ashpër nga faktori ndërkombëtar. Maqedonia është këshilluar që të evitojë veprimet të cilat përkeqësojnë marrëdhëniet fqinjësore në rajon. Ngecja në përpjekjet për zgjidhjen e këtij kontesti po i kushton shumë shtrenjtë asaj.

Shqiptarët megjithëse lidhur me këtë çështje kishin qenë mjaft indiferentë, gjërat kanë ndryshuar dukshëm pas Samitit të Strasburgut në vitin 2009. Çështja parësore për shqiptarët mbetet integrimi i vendit në strukturat euro-atlantike. Lidhur me këtë çështje një studiuese maqedonase shkruan: *“Ashtu sikur edhe shihet në kampanjën aktuale*

³⁶ Sipas gazetës maqedonase “Večer” thuhet se që nga viti 1990 e deri në nëntor të 2006, 10 198 maqedonas kanë marrë pasaporta bullgare. 14.11.2006, nr. 13348

³⁷ Riemërtimi i aeroportit të Shkupit me emrin “Aleksandri i Maqedonisë”. Владимир Мирчевски “Македонскиот аеродром му даде нова димензија на спорот со името”, Балкан инсајт, 18 Јануари 2007. BIRN. Maqedonia vazhdoi edhe me emërtimin e magjistrales kryesore që lidh Maqedoninë me Greqinë me po të njëjtin emër, emërtimin e stadiumit me emrin e Filipit II si dhe vendosjen e statujave antike para objektit të qeverisë maqedonase në Shkup.

zgjedhore, politikanët shqiptarë dhe shqiptarët etnikë janë bërë tani mbështetësit më të fuqishëm të integritetit të Maqedonisë në UE dhe NATO, meqenëse ata çështjen e konfliktit të emrit me Greqinë e perceptojnë në mënyrë më pak emocionale dhe janë më shumë të prirë të bëjnë kompromise.”³⁸ Por edhe vetë komuniteti maqedonas, edhe përkundër asaj që çështjen e kontestit të emrit e konsiderojnë si çështje ekskluzivisht të tyre, ende nuk duket qartë se cili është kompromisi i tyre. Meqenëse pas samitit të Strasburgut, mundësia për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO nuk duket gjëkund, ky fakt ka filluar t’i irlitojë shumë shqiptarët që jetojnë në Maqedoni.

Mospërcaktimi i qartë dhe konkret i koncepteve politike të Maqedonisë po reflekton një pasiguri edhe në marrëdhëniet me fqinjët e tjerë. Kontesti i Maqedonisë me Greqinë lidhur me emrin, ka nxjerrë në pah një zinxhir çështjesh të tjera të cilat janë të lidhura me identitetin dhe gjuhën.³⁹ Fqinji lindor Bullgaria kishte pranuar emrin e shtetit si të tillë, por kurrë gjuhën maqedonase dhe kombin maqedonas. Megjithatë Bullgaria me Maqedoninë kishin nënshkruar një deklaratë të përbashkët ku ishin njohur gjuha bullgare dhe ajo maqedonase si dy gjuhë zyrtare, kryeministri Bullgar Ivajlo Kalfin në mars kishte deklaruar se vendi i tij do të mbështesë hyrjen e Maqedonisë në NATO kur Maqedonia t’i zgjidhë të gjitha kontestet me fqinjët.⁴⁰ Për të mos mbaruar me kaq, fqinji verilindor – Serbia, refuzon ta pranojë kishën autoqefale maqedonase duke pretenduar se kisha e vetme autoqefale është ajo ortodokse serbe. Gjithashtu që nga njohja e pavarësisë së Kosovës nga Maqedonia në tetor të 2008, marrëdhëniet mes këtyre dy ish-republikave jugosllave mbeten tejet të brishta.

Maqedonia për momentin po përjeton një krizë të thellë identiteti të kontestuar nga të gjithë fqinjët e saj. Sipas raportit të Grupit Ndërkombëtar të Krizave thuhet se për maqedonasit çështja e identitetit të tyre është e lidhur me vetë ekzistencën e shtetit të tyre.⁴¹ Kjo për shkakun se Maqedonia është një shtet multi-etnik dhe tejet i brishtë, ndërsa tensionet e vazhdueshme mes maqedonasve dhe shqiptarëve janë të pranishme dhe lëkundin dukshëm stabilitetin e vendit. Këto shkaqe në

³⁸ Cvete Koneska, “As elections near, euro-skepticism on the rise in Macedonia”, 10/03/2009. Balkananalysis.com. <http://www.balkananalysis.com/2009/03/10/as-elections-near-euro-skepticism-on-the-rise-in-macedonia/> marrë më 11 mars 2009

³⁹ Albulena Halili, “Viti i brishtë”, Express, Prishtinë, 27 dhjetor 2008, fq.25.

⁴⁰ Iliria News Agency, 18/03/2009.

⁴¹ “Macedonia’s Name: Breaking the Deadlock”, Crisis Group Europe Briefing Nr.52, 12 January 2009

mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi kanë ndikuar në mospranimin e Maqedonisë në superfuqinë politiko-ushtarake. Kontesti me Greqinë pati ndikuar drejtpërdrejt, me përdorimin e vetos nga Greqia për të penguar integrimin e Maqedonisë, ndërsa kontestet me fqinjët e tjerë kanë dhënë impakte të tjera negative. Marrëdhëniet me fqinjët dhe kontribuimi në sigurinë dhe mirëqenien rajonale janë kriteret bazë për anëtarësimin e një vendi si në Unionin Evropian ashtu edhe në NATO.

2.2. Pasojat e mundshme nga mospranimi i Maqedonisë në NATO

Përderisa dy fqinjët e saj në samitin e fundit që u mbajt në Strasburg, u bënë anëtare me të drejta të plota në këtë organizatë, Maqedonia kishte humbur edhe shansin e dytë. Mbetja e Maqedonisë jashtë kësaj strukture domosdo se jep impakte negative në radhë të parë për Maqedoninë, si dhe tërë rajonin e Ballkanit.

Impakti negativ për Maqedoninë

Maqedonia edhe një vit pas Samitit të Bukureshtit nuk arriti të asgjësojë pengesat që i zinin rrugën drejt NATO-s, por bëri pikërisht të kundërtën. Analisti shqiptar Petrit Haliti në një artikull me titull “I munguari me dashje i samitit të NATO-s” shkruan:

“Politika e acarimit dhe e krijimit të provokimeve politike, historike e diplomatike, që qeveria e Gruevskit zgjodhi për të zbatuar gjatë gjithë këtij viti atlantik, që nga samiti i Bukureshtit e deri tek samiti i Strasburgut, nuk mund të mos çojnë tek bindja se qeveria e Shkupit në mënyrë të ndërgjegjshme, jo vetëm nuk iu afrua, por iu largua një kompromisi për emrin me Greqinë.”⁴²

Meqenëse Maqedonia mori në Bukuresht një ftesë të kushtëzuar, moszgjidhja e kontestit me Greqinë, për Maqedoninë do të thotë rrezik për vetë ekzistencën e saj dhe rilindjen e kontesteve me fqinjët e tjerë. Mbase shqiptarët ruajtën indiferencën e tyre lidhur me çështjen e emrit duke u treguar shumë konstruktivë, mospranimi i Maqedonisë në NATO i ka zhgënjyer shumë ata. Në raportin e vitit të kaluar të realizuar nga UNDP, “People centred analyses”, shihet se 14% nga shqiptarët e

⁴² Petrit Haliti, “I munguari me dashje i samitit të NATO-s”, 06/04/2009. <http://balkanweb.com/sitev4/lajme.php?id=36042>

anketuar mendojnë se anëtarësimi në NATO përbën prioritet për zhvillimin e ardhshëm të Maqedonisë, për dallim nga maqedonasit të cilët përfshihen me 7%.⁴³ Për shqiptarët integrimi në NATO dhe UE është çështje parësore dhe për këtë nuk janë të gatshëm të bëjnë kompromise.

Maqedonia vazhdon të mbetet një vend mjaft i dobët ekonomikisht, me papunësi të lartë, ndërsa së fundmi aty ka gjithnjë e më pak investime të huaja. Klima e pavolitshme politike po ndikon fatalisht në zhvillimin ekonomik të saj dhe në marrëdhëniet e saja ekonomike me fqinjët, gjë e cila po e çon Maqedoninë, përveç izolimit politik edhe drejt izolimit ekonomik.

Vetoja greke për Maqedoninë paraqet edhe një paralajmërim për vështirësitë që do të ketë Maqedonia për t'u anëtarësuar edhe në Unionin Evropian, ku Greqia ka një pozitë edhe më të favorshme.⁴⁴ Përderisa deri në vitin 2008 nga Komisioni Evropian janë përdorur termet "maqedonas" dhe "gjuha maqedone", ndikimi i theksuar i greqisë në institucionet e Unionit Evropian ka bërë që kjo të ndryshohet. Në doracakun ndërinstitutional të kontrolluar nga Byroja për publikime zyrtare e unionit Evropian, termi "maqedonas" dhe kodi "MK" është zëvendësuar me "të definohen".⁴⁵

Pengesa për Maqedoninë për t'u integruar në NATO dhe sipas të gjitha gjasave edhe në UE, do të thotë se Maqedonia po mbetet një vend pa orientim strategjik. Edhe pse kontesti me Greqinë është duke i kushtuar shtrenjtë Maqedonisë, udhëheqësia e shtetit maqedonas po keqpërdor si duket pozitën e saj gjeostrategjike në rajon si dhe mbështetjen e faktorit ndërkombëtar, sidomos SHBA-ve. SHBA-të kishin ripohuar mbështetjen e tyre për një Maqedoni unitare, multietnike brenda kufijve të saj ekzistues dhe kishin shprehur vullnetin për të rritur marrëdhëniet e tyre strategjike me Maqedoninë, menjëherë pas Samitit të Bukureshtit në maj të 2008.⁴⁶ Gjatë procesit të integrimit të shteteve,

⁴³ People centred analyses, Raport përgatitur nga UNDP, Misioni Shkup. Mars 2008, fq. 54

⁴⁴ Kjo për faktin se në UE nuk bëjnë pjesë SHBA-të të cilët janë mbështetës dhe aleatë strategjikë të Maqedonisë, ndërsa shtete të fuqishme si Franca dhe Spanja mbështetin Greqinë lidhur me këtë kontest. Ministri i punëve të jashtme të Francës, Bernard Kuchner kishte deklaruar se përderisa nuk zgjidhet çështja e emrit nuk mund të ketë progres të mëtejshëm në anëtarësimin e shtetit në UE. Heather McRobie, "A Macedonian identity crisis", guardian.co.uk. 7 prill 2009.
<http://www.guardian.co.uk/commentisfree/2009/apr/07/balkans-greece>

⁴⁵ Raportuesi në Parlamentin Evropian për Maqedoninë, Erik Mejer kishte kërkuar sqarim nga Komisioni Evropian lidhur me këtë çështje dhe kjo ishte konfirmuar nga ata. Për më tepër lexo "Mejer kërkon shpjegim për termin "maqedonas"", 02/04/09, INA online.net

⁴⁶ Declaration of strategic partnership and cooperation between the United States of America and the Republic of Macedonia, May 7, 2009, Washington DC. Bureau of European and Eurasian Affairs. <http://www.state.gov/p/eur/rls/or/104441.htm>

“vrimat e zeza” mbeten të padëshirueshme për organizatat multilaterale, sidomos për ato që kanë për qëllim ruajtjen e stabilitetit dhe paqes. Meqenëse Maqedonia ndodhet gjeografikisht në mes të gadishullit, e rrethuar me shtete që tashmë janë pjesë e strukturave euro-atlantike, ajo po sillet shumë dinakërisht, duke zvarritur procese të cilat përveç se e dëmtojnë vetë atë, ndikojnë negativisht edhe për tërë rajonin e brishtë ballkanik.

Impakti negativ për tërë rajonin ballkanik

Ruajtja e paqes dhe stabilitetit rajonal si dhe zgjerimi i zonës së sigurisë në Evropë, janë qëllimet kryesore të NATO-s. Këto qëllime përputhen katërcipërisht me interesat strategjike dhe prioritetet e shteteve të Ballkanit. Andaj edhe ngecjet që bëhen në këto procese integruese, jetike, janë shumë të dëmshme madje edhe të rrezikshme për paqen dhe stabilitetin në rajon. Një Maqedoni jashtë strukturës mbrojtëse të sigurisë, përveç se prodhon një pasiguri të brendshme, bart pasoja edhe për fqinjët e saj dhe tërë rajonin. Me të drejtë analisti i revistës së njohur gjermane “Der Spiegel”, Edward P. Joseph, parashikon:

*“Duke mbajtur të hapur çështjen e Maqedonisë, Serbia, Rusia dhe shtete të tjera mund të vazhdojnë që në agjendën e tyre të mbajnë të hapura edhe çështje të tjera, duke përfshirë këtu edhe kufijtë përfundimtarë të Kosovës. Në qoftë se Maqedonia do të hyjë sërish në konflikt, është e sigurt që ajo nuk do të mbetet më brenda kufijve të saj aktualë. (...) Para Bukureshtit shqetësimi i Shkupit ishte që ndarja e Kosovës e nxitur nga serbët do të mund të nxiste lëvizje secesioniste mes shqiptarëve etnikë në Maqedoni. Pas Bukureshtit, e vërtetë është e kundërta: agjenda serbo-ruse mund të avancojë nga trazirat në Maqedoni. Së shpejti, çfarëdo trendi drejt shpërbërjes në Maqedoni, do të ketë pasoja të drejtpërdrejta dhe të paevitueshme për Kosovën.”*⁴⁷ Ky ndryshim është një indikator që Ballkani mund të jetë i qëndrueshëm vetëm në saje të stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së secilit vend veç e veç. Çdo lëkundje dhe jostabilitet në cilindo shtet të tij, jep impakt në tërë sipërfaqen e gadishullit. Prandaj, sekretari gjeneral i NATO-s Jaap de Hoop Scheffer kishte vizituar Athinën në mars të 2008, dhe kishte bërë përpjekje t'i

⁴⁷ Edward P. Joseph, “How to solve the Greek dispute over Macedonia's name”, Der Spiegel. 02/06/2009.

zhbindë grekët dhe t'i paralajmërojë ata lidhur me pasojat për stabilitetin rajonal që mund të shkaktohen në qoftë se nuk arrihet një marrëveshje.⁴⁸

Kontesti midis Greqisë e Maqedonisë mund të sjellë pasoja në zhvillimin dhe bashkëpunimin ekonomik të Ballkanit, destabilizimin e situatës rajonale, madje mund të vijë deri te devijimi i strategjisë kryesore të NATO-s dhe UE-së për stabilizimin e Ballkanit Perëndimor dhe humbjen e besimit në këto organizata.

3. Përfundime dhe rekomandime

Nevoja për profilizim të politikës së brendshme të Maqedonisë

Lëvizja drejt NATO-s ka qenë një lëvizje me parametra të paracaktuar. Programi i Partneritetit për Paqe si një qasje strategjike për vendet aspirante, si dhe Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim si një mekanizëm për Evropën Juglindore, ishin kusht për vendosjen e marrëdhënive ndërajonale dhe krijimin e stabilitetit të brendshëm politik, ekonomik dhe ndëretnik. Kjo ishte një kërkesë reale për bashkëpunim në rajon. Republika e Maqedonisë si nënshkruese e këtyre mekanizmave përcjellëse të integritetit, duhet të jetë më racionale në hartimin e politikave të saj, në mënyrë që vendin ta çojë drejt integritetit në strukturat euroatlantike. Përkundër nënshkrimit të këtyre akteve, Maqedonia ka ngecur në implementimin e dokumenteve që mundësojnë hyrjen në këto struktura. Marrëveshja e Ohrit sot përbën një dokument i cili ndodhet në pikën më të ulët të implementimit. Qeveria e Maqedonisë këtë marrëveshje e sheh më shumë si diktat të ndërkombëtarëve se sa si një dokument të funksionalizimit të shtetit (apo shpëtimit të shtetit). Mosimplementimi i Marrëveshjes së Ohrit, shqiptarëve gjithnjë e më shumë po ua humb shpresat e jetësimit të shtetit multi-etnik dhe të konceptit të bashkëjetesës politike. Për Maqedoninë koncepti multi-etnik i shtetit është një faktor kyç për stabilitetin e vendit. Ky koncept do të bëjë një ambient më të sigurtë dhe një mirëqenie të barabartë të shtetasve të saj, duke krijuar një bazë të besimit dhe tolerancës mes njerëzve që jetojnë në këtë shtet.

⁴⁸ Balkan Insight 3 mars 2008; Gjithashtu lexo: Macedonia's Name: Breaking the Deadlock. Crisis Group Briefing Nr. 52, 12 janar 2009

Nevoja e reformimit të mekanizmave vendimmarrëse në organizatat euro-atlantike

Që nga shpërbërja e BRSS-së, NATO shpeshherë ka qenë në zemër të kritikave në kontekstin e revitalizimit të saj. Kjo na bën të mendojmë se koncepti *Raison d'état* po dominon mbi politikat e integritit, meqë disa shtete vazhdojnë të adaptojnë politika nacionaliste. Integrimi i shteteve në strukturat euro-atlantike është një dëshmi se vetëm përmes këtij procesi paqja në Evropë u mbajt për gjashtëdhjetë vjet stabile, duke i kthyer armiqte në partnerë të bashkëpunimit. NATO nuk duhet të lejojë pengimin e procesit të antarësimit i cili po mbahet peng nga disa shtete të cilat kanë probleme bilaterale. E drejta e vetos në strukturat euro-atlantike për pranimin e antarëve të rinj nga shumë shtete po shikohet si një e drejtë për ta paralizuar tjetrin. Natyrisht, e drejta e vetos do të ishte më e justifikueshme, vetëm atëherë kur të gjitha shtetet anëtare të strukturave euro-atlantike, do të ishin me plotkuptimin e fjalës demokraci të zhvilluara. Ndërsa, nga ana tjetër, kjo e drejtë mund të justifikohet vetëm po qe se shtetet anëtare të euro-atlantizmit nuk kanë ambicie ekspansioniste ndaj fqinjëve të vet.

Në qoftë se kjo praktikë do të vazhdojë edhe për shtetet tjera të gadishullit, që sigurisht do jetë e pranishme për shkak të armiqësive tradicionale, atëherë do të duhet ose të kalojë një kohë shumë e gjatë që armiqësitë të harrohen ose do të jetë e nevojshme një reformë e njëmendët në mekanizmin për anëtarësimin e anëtarëve të rinj në Unionin Evropian dhe NATO. Përndryshe një integrim i plotë i rajonit ballkanik në strukturat euro-atlantike do të jetë pothuajse i pamundshëm.